


12. Plan i Veprimit për Planin e MIMN

12.1 Të Përgjithshme (Zgjedhja e Projekteve Parësore, Hamendësimet dhe Kushtet)

12.1.1 Ndërlidhja e Zërave të Projektit

Planet, programet dhe projektet e përmendura në seksionin e mësipërm janë të lidhura me njëri-tjetrin, siç është ilustruar në Figurën 12.1.1. Për shembull, aktivitetet e planit 3R qëndrojnë në role të qarta po ashtu, edhe përgjegjësitë e prodhuesve të mbetjeve të përcaktuara në planin e zhvillimit të kapaciteteve institucionale. Rikuperimi i materialeve të riciklueshme përmes planit 3R është mbështetur në futjen e grumbullimit të ndarë dhe ndërtimin e impianteve të përshtatshme të trajtimit të ndërmjetëm për lloje të ndryshme të mbetjeve. Për më tepër, të gjitha planet, programet dhe projektet janë zbatuar në bazë të financimit të mjaftueshëm dhe menaxhimit të qëndrueshëm financiar në bazë të planit të fuqizimit financiar. Shkëputja ose ndarja e disa prej zërave të pjesës përbërëse nuk është e frytshme për zbatimin e masterplanit. Pra, planet, projektet dhe programet e ndërlidhura, në shtatë zëra, do të quhen një paketë e projektit, që do të zbatohen së bashku nën përpjesëtim të projektit..



Burimi: Ekipi Studimor i JICA-s

Figura 12.1.1 Ndërlidhja e Zërave të Propozuar në Planin e Menaxhimit të Integruar të Mbetjeve të Ngurta

12.1.2 Mbikëqyrja Paraprake e Planeve të Veprimit

- Mbikëqyrja paraprake e planeve, programeve dhe projekteve parësore është kryer në bazë të këtyre koncepteve:
- Nevojës së ngutshme për largimin e problemeve publike dhe mbajtjen e një mjedisi të pastër dhe të shëndetshëm;
- Fillimi i aktiviteteve nëpërmjet aktiviteteve afatgjata për të përfutur bashkëpunimin e grupeve të interesit në shërbimet e MMN;
- Fillimi i punës përgatitore për projektet, që kërkojnë një kohë të gjatë për proceset e studimit të fizibilitetit, VNM, projektimin inxhinierik, punën ndërtimore etj. deri në nisjen e funksionimit;
- Zbatimi i planeve, programeve dhe projekteve në përputhje me nivelin e synuar të kërkuar dhe afatin kohor të normës së riciklimit, landfillit dhe normën e rikuperimit të energjisë të shpallur në Ligj dhe në Planin Kombëtar të Menaxhimit të Integruar të Mbetjeve;
- Përdorimi i rezultateve të projektit për përmirësime në fazën fillestare të shërbimeve të MMN, pakësimin e problemeve publike dhe përmirësimin e higjienës dhe estetikës publike.

Për të kryer mbikëqyrjen fillestare, faktorët, si i) ngutshmëria, ii) përputhshmëria, dhe iii) efektet janë zgjedhur për vlerësimin e elementëve dhe përgatitjen e listës së gjatë të përparësive paraprake, siç paraqiten në Tabelën 12.1.1

Përcaktimi i përparësive të projekteve me sektorët e tjerë, si rrugët dhe trafiku, furnizimi me ujë, kanalizimet, dhe menaxhimi i mbetjeve të ngurta, do të kryhet më vete sipas përparësive në këtë seksion.

Tabela 12.2.1 Mbikëqyrja Paraprake e Projekteve të Propozuara në Planin e MIMN

Planet, Programet, dhe Projektet e Propozuara		Ngutshmëria	Përputhshmëria	Efektet	Pikët
MMN-1 Plani i Grumbullimit dhe Transportimit të Mbetjeve					
MMN-1-1	Hartimi i Planit të Zbatimit për Grumbullimin dhe Transportimin e Mbetjeve	4	3	4	11
MMN-1-2	Vrojtimi i Venddepozitimeve Ilegale dhe Përgatitja e projektit të Pastrimit	5	1	5	11
MMN-1-3	Zbatimi i Projektit të Pastrimit të Venddepozitimeve të paligjshme përmes Kontraktimit	5	1	5	11
MMN-1-4	Zbatimi i Studimit Pilot për Përmirësimin e Shërbimit të Grumbullimit të Mbetjeve				
MMN-1-4-1	Studimi për Zgjerimin e Zonës së Shërbimit me Sistemin e 3-koshave	4	3	4	11
MMN-1-4-2	Studimi i Grumbullimit të Ndarë të Mbetjeve për Mbetjet e Veçanta	3	3	3	9
MMN-1-4-3	Zbatimi i Grumbullimit të Ndarë në Zonat Pilot të Studimit	4	5	4	13
MMN-1-5	/Funksionimi i Grumbullimit të Ndarë sipas Sistemit me 3-kosha	4	5	4	13
MMN-1-6	Monitorimi/Inspektimi i Aktiviteteve të Grumbullimit të Mbetjeve	3	3	3	9
MMN-1-7	Vlerësimi i Performancës dhe Nivelit/Objektivave të Synuar në Planin e Grumbullimit të Mbetjeve	3	3	3	9
MMN-2 Plani i Pakësimit të Mbetjeve (Plani 3R)					
MMN-2-1	Hartimi i Planit të Zbatimit për Aktivitetet 3R				
MMN-2-1-1	Hartimi i Planit të Zbatimit për Uljen e Mbetjeve	5	4	3	12
MMN-2-1-2	Hartimi i Planit të Zbatimit për Rikuperimin, Ripërdorimin, Riciklimin e Mbetjeve	5	4	3	12
Planet, Programet, dhe Projektet e Propozuara		urgjenca	Përputhshmëria	Efektet	Pikët
MMN-2-2	Zbatimi i Aktiviteteve 3R				

MMN-2-2-1	Nxjtja e Kontrollit të Burimit të Prodhimit të Mbetjeve	4	3	3	10
MMN-2-2-2	Nxjtja e Kontrollit të Shkarkimit të Mbetjeve	4	3	3	10
MMN-2-2-3	Nxjtja e Rikuperimit të Materialeve të Riciklueshme	4	4	4	12
MMN-2-2-4	Nxjtja e Ripërdorimit dhe Riciklimit të Materialeve të Riciklueshme	4	4	4	12
MMN-2-2-5	Ndërtimi i Impiantit Qendror të Rikuperimit të Materialeve në Sharrë	4	4	4	12
MMN-2-2-6	Funksionimi i Impiantit Qendror të Rikuperimit të Materialeve në Sharrë	4	4	4	12
MMN-2-3	Monitorimi i Zbatimit të Aktiviteteve 3R	3	3	3	9
MMN-2-4	Vlerësimi i Performancës dhe Nivelit/Objektivave të Synuar në Planin e Pakësimit të Mbetjeve	3	3	3	9
MMN-3 Plani i Trajtimit të Ndërmjetëm					
MMN-3-1	Hartimi i Planit të Zbatimit për Planin e Trajtimit të Ndërmjetëm				
MMN-3-1-1	Hartimi i Planit të Zbatimit për Trajtimin e Mbetjeve Organike	5	4	4	13
MMN-3-1-2	Hartimi i Planit të Zbatimit për Mbetjet-në-Energji	5	4	4	13
MMN-3-2	Zbatimi i Planit të Trajtimit të Mbetjeve Organike				
MMN-3-2-1	Organizimi i Kompostimit në Shtëpi dhe Grupeve Komunitare të Kompostimit	4	3	4	11
MMN-3-2-2	Zbatimi i Projektit Pilot të Kompostimit në Shtëpi dhe Komunitet	4	3	4	11
MMN-3-2-3	Zgjerimi/Shtrirja e Praktikës së Kompostimit në Shtëpi dhe Komunitet	4	3	3	10
MMN-3-2-4	Përzgjedhja e Burimit të Madh të Prodhimit të Mbetjeve të Biodegradueshme	4	3	3	10
MMN-3-2-5	Ndërtimi i Impiantit të Kompostimit i Shkallës Pilot	5	4	4	13
MMN-3-2-6	Funksionimi dhe Mirëmbajtja e Impiantit të Kompostimit i Shkallës Pilot	5	4	4	13
MMN-3-2-7	Ndërtimi i Impiantit Qendror të Kompostimit/Biogazifikimit	5	4	5	14
MMN-3-2-8	Funksionimi dhe Mirëmbajtja e Impiantit Qendror të Kompostimit / Biogazifikimit	5	4	5	14
MMN-3-3	Vlerësimi i Performancës dhe Nivelit/Objektivave të Synuar në Planin e Trajtimit të Mbetjeve Organike	3	3	3	9
MMN-3-4	Zbatimi i Planit të Mbetjeve në Energji				
MMN-3-4-1	Përzgjedhja e Vendit të Ndërtimit dhe Prokurimi	4	3	4	11
MMN-3-4-2	Ndërtimi i Impiantit të Mbetjeve-në-Energji	5	4	5	14
MMN-3-4-3	Funksionimi dhe Mirëmbajtja e Impiantit të Mbetjeve-në-Energji	5	4	5	14
MMN-3-5	Vlerësimi i Performancës dhe Nivelit/Objektivave të Synuar në Planin e Mbetjeve-në-Energji	3	3	3	9
MMN-4 Plani i Depozitimit të Mbetjeve					
MMN-4-1	Hartimi i Planit të Zbatimit për Depozitimin e Mbetjeve	5	3	4	12
MMN-4-2	Koordinimi me Planin Rajonal të Depozitimit të Mbetjeve	4	2	3	9
MMN-4-3	Përzgjedhja e Vendit të Ndërtimit dhe Prokurimi	5	3	3	11
MMN-4-4	Zbatimi i Projektit të Depozitimit të Mbetjeve				
MMN-4-4-1	Ndërtimi i Landfillit Sanitar	5	3	5	13
MMN-4-4-2	Operimi/Funksionimi dhe Mirëmbajtja e Landfillit Sanitar	5	3	5	13
MMN-4-4-3	Mbyllja e Landfillit Ekzistues	3	3	3	9
Planet, Programet, dhe Projektet e Propozuara		Ngutshmëria	Përputhshmëria	Efektet	Pikët
MMN-4-5	Vlerësimi i Performancës dhe Nivelit/Objektivave të Synuar në Planin e Depozitimit të Mbetjeve	3	3	3	9
MMN-5 Plani i Zhvillimit të Kapaciteteve Institucionale					
MMN-5-1	Ngritja/Krijimi i Ekipi Punues të Projekteve dhe Zbatimin e Projekteve Parësore				

MMN-5-1-1	Rekrutimi i Stafit të Sektorit të Projekteve	5	3	5	13
MMN-5-1-2	Orientimi i Plan-Veprimeve të Planit të MIMN, Modifikimi dhe Finalizimi	5	3	5	13
MMN-5-1-3	Përgatitja e Planit të Zbatimit të Projekteve Parësore	5	3	5	13
MMN-5-1-4	Buxhetimi për Zbatimin e Projekteve Parësore	5	3	5	13
MMN-5-2	Hartimi i Planit të Zbatimit për Zhvillimin e Kapaciteteve Institucionale	4	4	4	12
MMN-5-3	Ngritja e një Sistemi Institucional Shtesë				
MMN-5-3-1	Miratimi i akteve nënligjore në përputhje me Ligjin e MIMN	4	5	3	12
MMN-5-3-2	Përgatitja e rregullave, rregulloreve, kritereve, standardeve, etj	4	5	3	12
MMN-5-3-3	Studimi dhe Ngritja e Kompanisë ALB të Rikuperimit dhe Ricklimit të Burimeve	5	3	4	12
MMN-5-4	Hartimi dhe Miratimi i Planit të MIMN				
MMN-5-4-1	Rishikimi, Modifikimi dhe Inspektimi i Planit të MIMN	5	5	3	13
MMN-5-4-2	Miratimi Zyrtar i Masterplanit të MIMN	5	5	3	13
MMN-5-5	Vrojtimi i të Dhënave Bazë për Indikatorët e Performancës dhe Raportimin				
MMN-5-5-1	Përgatitja e Raportit Mijor dhe Vjetor	3	3	3	9
MMN-5-5-2	Ndërgjegjësimi Publik / Sondazhet e Opinioneve mbi Aktivitetet e MMN	4	4	4	12
MMN-5-5-3	Vrojtimi i Sasisë dhe Përbërjes së Mbetjeve Familjare	3	3	3	9
MMN-5-5-4	Vrojtimi i Sasisë dhe Përbërjes së Mbetjeve Tregtare/Biznesit	3	3	3	9
MMN-5-6	Vlerësimi i Performancës dhe Nivelit/Objektivave të Synuar në Planin e Zhvillimit të Kapaciteteve Institucionale	3	3	3	9
MMN-6 Plani i Fuqizimit Financiar					
MMN-6-1	Hartimi i Planit të Zbatimit për Forcimin Financiar	4	3	4	11
MMN-6-2	Studim i Kostos për Njësi të MMN dhe Rishikimi i Tarifave të Mbetjeve	4	3	4	11
MMN-6-3	Zbatimi i Planit të Forcimit Financiar				
MMN-6-3-1	Hapja e Llogarisë së Veçuar të MMN	5	2	3	10
MMN-6-3-2	Përgatitja dhe Ngritja e Sistemit të Tarifimit të Mbetjeve	5	3	4	12
MMN-6-3-3	Zbatimi dhe Ngritja e Llogarisë së duhur të MMN	5	3	5	13
MMN-6-4	Vlerësimi i Performancës dhe Nivelit/Objektivave të Synuar në Planin e Forcimit Financiar	3	2	3	8
MMN-7 Plani i Rritjes së Ndërgjegjes Publike					
MMN-7-1	Formulimi i Planit të Zbatimit të Rritjes së Ndërgjegjes së Publikut	5	4	4	13
MMN-7-2	Zbatimi i Planit të Rritjes së Ndërgjegjes Publike				
MMN-7-2-1	Zbatimi i Planit të Marrëdhënieve me Publikun	4	3	2	9
MMN-7-2-2	Zbatimi i Planit të Edukimit në Shkollë	4	3	4	11
MMN-7-2-3	Zbatimi i Planit të Zbatimit Joformal	4	3	4	11
MMN-7-2-4	Zbatimi i Planit të Përfshirjes së Komunitetit	5	4	4	13
MMN-7-3	Vlerësimi i Performancës dhe Nivelit/Objektivave të Synuar në Planin e Rritjes së Ndërgjegjes Publike	3	3	3	9

Shënim: Legjenda e Pikëve

E Lartë: 5, Mesatar i Lartë: 4, Mesatare: 3, Mesatar i Ulët: 2, i Ulët: 1

Burimi: Ekipi Studimor i JICA-s

12.1.3 Supozimet dhe Kushtet e Projektit Parësor

Një zbatim i butë i Planit të MIMN është bazuar në materializimin e politikave të planifikimit të cituara më herët, për konceptet kryesore si dhe në disa supozime dhe kushtet konkrete në seksionet përkaktëse për planifikim. Këto kërkime janë pasqyruar përsëri në Tabelën 12.1.2 për secilën kategori të punës, për kushtet e rëndësishme të zbatimit të Projekteve Parësore si dhe të Planit të MIMN.

Tabela 12.2.2 Supozimet dhe Kushtet për Zbatimin e Projekteve Parësore

Kategoria e Punës	Supozimet, Premisat dhe Kushtet
Pastrimi i Venddepozitimeve të Paligjshme	- Pastrimi është kryer për venddepozitimet në tokën publike. - Venddepozitimet e mëdha pastrohen duke përdorur mjete të mëdha dhe të hapura. - Venddepozitimet e vogla pastrohen me karroca dore dhe kamion të vogël.
Grumbullimi i Ndarë i Mbetjeve	- Pjesëmarrja e prodhuesve të mbetjeve përfshirë: banorët dhe subjektet tregtare dhe të biznesit, është rregullu bazë për grumbullimin e ndarë të mbetjeve, dhe për t'i depozituar në mënyrë të ndarë në pikat e caktuara. - Prodhuesit e mbetjeve duhet të ndjekin rregullat e grumbullimit të mbetjeve, të vendosur nga BT. - Kontejnerët e rinj të mbetjeve janë vendosur dhe kryhet rregullisht grumbullimi i mbetjeve në rrethinat e lokalizuara pak larg nga kontejnerët e tanishëm të mbetjeve.
Aktivitetet 3R	- BT merr nismën për krijimin e aktiviteteve të duhura të 3R me pjesëmarrjen prodhuesve të mbetjeve duke përfshirë banorët dhe subjektet tregtare, të biznesit dhe institucionet, grumbulluesit e mbetjeve, tregtarët e të riciklueshmeve dhe industrinë e riciklimit. - Grumbullimi i materialeve të riciklueshme kryhet në burimet e prodhimit të mbetjeve. - Materialet e riciklueshme të rikuperuara shkarkohen në kontejnerët e caktuar për këtë arsye ose të çohen në impiantet e rikuperimit të materialeve në qytet, ose të grumbullohen nga grumbulluesit e materialeve të riciklueshme.
Trajtimi i Mbetjeve Organike	- Prodhuesit e mëdhenj të mbetjeve bashkëpunojnë me BT për ndarjen e duhur të mbetjeve të biodegradueshme për grumbullimin e drejtpërdrejtë. - Mbetjet e biodegradueshme, të ndara, shkarkohen në mënyrën e duhur të kontejnerët e mbetjeve të njoma për grumbullimin e mbetjeve të biodegradueshme, nga sistemi me 3-kontejnerë.
Projekti i Mbetjeve në Energji	- Ndarja e mbetjeve të djegshme kryhet në burim të prodhimit të mbetjeve dhe depozitohen siç duhen në kontejnerët e përcaktuar të mbetjeve të djegshme për grumbullimin e sistemit me 4-kontejnerë, që do të kalohet kur të zbatohet projekti i Mbetjeve në Energji. - Sigurimi i burimit(ve) është çështja e lancimit të projektit përmes subvencioneve të qeverisë qendrore ose investimeve të sektorit publik, si projekt PPP. - Futja e teknologjisë nga BE ose Japonia është çelësi i suksesit.
Depozitimi i Mbetjeve	- Projektet 3R dhe të trajtimit të ndërmjetëm zbatohen siç propozohen për të ulur sasinë e mbetjeve në landfill. - Zona ngjitur vendit të propozuar për landfill është e gjerë mjaftueshëm për vendin e ndërtimit të impianteve të tjera të menaxhimit të mbetjeve, sipas planit të përdorimit të tokës të Planit Rregullator të Bashkisë së Tiranës, dhe të miratohet nga autoritetet përkatëse. - Landfilli sanitar ndërtohet dhe vepron në mënyrën e duhur, sipas manualit të funksionimit dhe mirëmbajtjes.
Fuqizimi Institucionale dhe Organizativ	- BT krijon Ekipin Punues të Projekteve dhe cakton personelin e BT të drejtojnë ekipin dhe/ose punësojë/kontraktojë një person me përvojë nga burime të jashtme. - Personeli i ngarkuar, veçanërisht ai i Ekipit Punues të Projekteve, duhet të kuptoj plotësisht përmbajtjen e Projekteve Parësore dhe Planin e MIMN. - Zhvillimi i burimeve njerëzore ose trajtimi kryhet për të rritur kapacitetin profesional të personelit teknik dhe menaxhues.
Të dhënat e Aktiviteteve të MMN	- Personeli i ngarkuar duhet të kuptoj qartë rëndësinë e grumbullimit dhe analizës së të dhënave për aktivitetet e MMN. - Raportet mujore/vjetore të përgatiten nga analizat e të dhënave për vlerësimin e aktiviteteve të MMN. - BT alokon buxhetin vjetor të mjaftueshëm për të kryer vërtetimet dhe detyrat që lidhen me të.
Fuqizimi Financiar	BT vendos nivelin e mbulimit të koston nga prodhuesit të mbetjeve dhe përcakton tarifën e duhur të mbetjeve dhe taksën.

	- Llogaria e pavarur dhe transparente e MMN krijohet gjatë krijimit të sistemit të drejtë të taksës dhe tarifës së mbetjeve. - BT merr masa të përkohshme për të siguruar buxhetin e mjaftueshëm për koston e përmirësimit të shërbimeve të MMN, në fazën fillestare. - Mbulimi i plotë i koston për shërbimet e MMN parashikohet në të ardhmen.
Rritja e Ndërgjegjes së Publikut	- BT kupton qartë rëndësinë e rritjes së ndërgjegjes së publikut për arritje të suksesshme të Planit të MIMN. - Ministria e Arsimit dhe e Shkencës merr pjesë në hartimin e programeve të edukimit në shkolla. - Grupet komunitare krijohen në zonat pilot të studimit. - BT alokon buxhetin vjetor të mjaftueshëm për aktivitetet.

Burimi: Ekipi Studimor i JICA-s

12.2 Zërat e Projekteve Parësore të Planit të MIMN

Projektet parësore janë zgjedhur ndërmjet planeve, programeve dhe projekteve, të formuluar në Planin MIMN bazuar në studimin e mbikëqyrjes paraprake të përshkruar në seksionin 12.1.2, më parë. Kriteri i analizës përgatitet nga faktorët kryesorë, veçanërisht për "ngutjen", "pajtueshmërinë", dhe "efektet", të cilat i atribuohen çdo projekti, përveç rrethanave të përfshirë në zhvillimin e impianteve moderne të MMN. Në vijim janë dhënë paketat e Projekteve Parësore të propozuara për planet e veprimeve për krijimin e një sistemi të suksesshëm të MMN për kryeqytetin e Shqipërisë.

- Projekti për Pastrimin e Venddepozitimeve të Paligjshme të Mbetjeve
- Shërbimet e Grumbullimit dhe Transportimit të Ndarë të Mbetjeve
- Paraqitja e Programeve të 3R-ve
- Projekti i Trajtimit të Mbetjeve Organike
- Projekti i Mbetjeve në Energji
- Projekti i Zgjerimit të Strukturave të Depozitimit të Mbetjeve
- Fuqizimi Organizativ
- Fuqizimi i Monitorimit dhe Vlerësimit
- Fuqizimi Financiar
- Programet e Rritjes së Ndërgjegjes së Publikut

12.3 Përshkrimet dhe Propozimet Teknike të Projektit

12.3.1. Projekti për Pastrimin e Venddepozitimeve të Paligjshme të Mbetjeve

(1) Objektivat e Projektit

Projekti synon pastrimin e mbetjeve të grumbulluara nga shkarkimet e mbetjeve në vendet publike, veçanërisht në rrethinat e qytetit dhe zonat përgjatë brigjeve të lumit. Gjatë dhe pas punës për pastrimin, kontejnerët e mbetjeve duhet të vendosen për të përfshirë ato zona në shërbimin e rregullt të grumbullimit të mbetjeve. Zbukurimi i kryeqytetit të Shqipërisë duhet të mirëmbahet përmes zbatimit të Projektit. BT po zbaton Projektin e Rehabilitimit të Lumit Tirana së bashku me Projektin e Unazës së Madhe, për të ndërtuar një rrugë të ngushtë rreth 7 km në të dyja anët e brigjeve të lumit. Projekti nuk është përfunduar ende, por kostoja e rehabilitimit të lumit është vlerësuar rreth 2,5 miliardë lekë. Projekti i pastrimit të venddepozitimeve të paligjshme përgjatë Lumit Tirana duhet të zbatohet në linjë me projektin e rehabilitimit të lumit të sipërpërmendur.

(2) Vendndodhja e Projektit ose Zona e Mbulimit

Vrojtimi i kryer nga Ekipi Studimor identifikoi 46 venddepozitime të hapura mbetjesh, në zonën e qytetit dhe disa nga vendet tipike janë treguar në Figurën 12.3.1. Projekti mbulon pastrimin e mbetjeve të shkarkuara në territore publike të BT-së duke përfshirë, por jo duke u kufizuar vetëm te 46 venddepozitimet e përmendura.



Burimi: Ekipi Studimor i JICA-s

Figura 12.3.1 Venddepozitime të hapura, tipike për Projektin e Pastrimit

(3) Zërat e Projektit

Projekti është planifikuar të përfundojë në tri vite. Projekti, që përfshin nënprojektet, përfshin këto aktivitete:

- MMN 1-2: Vrojtimin e Venddepozitimeve të paligjshme dhe Përgatitjen e Projekteve të Pastrimit;
- MMN 1-3: Zbatimin e Projektit të Pastrimit të Venddepozitimeve të Paligjshme, përmes Kontraktimit.

Si shtesë e skicës së aktiviteteve, që përshkruhet në seksionin 5.7: Plani i Grumbullimit dhe Transportimit të Mbetjeve, Projekti do të kryej këto aktivitete:

- Kryerjen e vërtetimit të venddepozitimeve të hapura të paligjshme, përpara fillimit të punës;
- Vlerësimin e kostove bazuar në rezultatet e vërtetimit dhe përcaktimin e objektivave për pastrimin e vendeve, duke marrë parasysh mundësinë e buxhetit për vitin fiskal;
- Përgatitjen e termave të referencës dhe specifikimet për kryerjen e punës, si përmes ofruesve ekzistues të shërbimit të grumbullimit të mbetjeve (si punë shtesë) ose përmes kontraktimit me ofruesit e tjerë të shërbimit;
- Mbikëqyrjen e ofruesit të shërbimit të kontraktuar në kryerjen e pastrimit dhe vendosjes së kontejnerëve të mbetjeve të ofruar nga BT gjatë pastrimit;

- BT duhet të kryej monitorimin dhe inspektimin, për të siguruar performancën e ofruesve të shërbimit;
- BT duhet të caktoj vendin ose kontejnerët e rinj të mbetjeve për shërbimin e rregullt të grumbullimit të mbetjeve,
- Ofruesit e shërbimit përgatisin raportin e përfundimit të punës për miratim; dhe
- Përgatit aktivitetin e pastrimit për vitin e ardhshëm fiskal.

Tabela në vijim 12.3.1 tregon listën e venddepozitimeve të hapura të paligjshme, të vrojtuar nga Ekipi Studimor i JICA nga janari në shkurt 2012. U identifikuan 46 venddepozitime gjithsej me një sasi mbetjesh prej 16 000m³. Puna për pastrimin duhet të përfundojë në tri vite. Prandaj, sasia e mbetjeve për pastrim është vlerësuar rreth 5 000 m³ në vit.

Tabela 12.3.1 Venddepozitimet e Hapura të Identifikuara në Zonën e BT

Nr.	Koordinatat		Sasia e Vlerësuar e Mbetjeve	Mbetjet
1	41°21'29.33"N	19°50'45.30"E	30	Mbetje familjare + Inerte
2	41°21'6.51"N	19°49'50.80"E	5000	Inerte + Mbetje familjare
3	41°21'4.07"N	19°48'30.17"E	3000	Inerte + Mbetje familjare
4	41°21'7.90"N	19°48'39.85"E	5	Mbetje familjare
5	41°21'7.16"N	19°48'35.27"E	50	Inerte + Mbetje familjare
6	41°21'2.28"N	19°48'17.26"E	2000	Inerte + Mbetje familjare
7	41°21'0.72"N	19°48'11.98"E	2500	Inerte + Mbetje familjare
8	41°20'59.96"N	19°48'6.11"E	1400	Inerte + Mbetje familjare
9	41°20'56.83"N	19°47'58.95"E	150	Inerte + Mbetje familjare
10	41°18'45.9"N	19°48'13.7"E	5	Inerte
11	41°18'46.4"N	19°48'11.9"E	50	Inerte
12	41°18'44.1"N	19°48'16.8"E	3	Inerte + Mbetje familjare
13	41°18'46.0"N	19°48'9.6"E	10	Inerte + dru
14	41°18'48.2"N	19°48'4.9"E	5	Inerte
15	41°18'50.6"N	19°48'0.0"E	80	Inerte
16	41°18'51.7"N	19°47'51.7"E	5	Inerte
17	41°18'52.8"N	19°47'57.5"E	60	Inerte + Mbetje familjare
18	41°20'02.6"N	19°51'47.8"E	30	Inerte
19	41°20'04.4"N	19°51'37.2"E	32	Inerte
20	41°19'08.3"N	19°49'54.4"E	4	Inerte + Mbetje familjare
21	41°18'48.6"N	19°48'44.5"E	600	Inerte + Mbetje familjare
22	41°18'50.6"N	19°48'44.2"E	2	Inerte + Mbetje familjare
23	41°18'52.4"N	19°48'47.0"E	1	Inerte + Mbetje familjare
24	41°19'00.9"N	19°50'00.1"E	4	Inerte
25	41°19'48.2"N	19°50'16.2"E	4	Inerte
26	41°19'55.4"N	19°52'24.8"E	2	Mbetje familjare
27	41°18'58.9"N	19°50'20.7"E	80	Inerte
28	41°19'00.8"N	19°50'38.7"E	4	Inerte + Mbetje familjare
29	41°19'05.2"N	19°50'00.1"E	4	Inerte
30	41°19'39.04"N	19°48'42.42"E	8	Inerte
31	41°20'41.88"N	19°46'49.83"E	25	Inerte
32	41°21'23.76"N	19°46'9.73"E	55	Inerte + Mbetje familjare
33	41°21'31.92"N	19°45'50.67"E	150	Inerte + Mbetje familjare
34	41°21'36.65"N	19°45'44.92"E	300	Inerte + Mbetje familjare

35	41°20'57.44"N	19°46'51.73"E	110	Inerte + Mbetje familjare
36	41°20'20.98"N	19°50'19.04"E	2	Inerte + Mbetje familjare
37	41°20'38.73"N	19°50'47.76"E	1	Mbetje familjare
38	41°21'2.44"N	19°50'38.50"E	4	Mbetje familjare
39	41°20'48.23"N	19°49'19.50"E	150	Mbetje familjare
40	41°20'38.14"N	19°50'45.18"E	5	Inerte
41	41°20'37.49"N	19°50'50.75"E	10	Inerte + Mbetje familjare
42	41°20'34.35"N	19°48'37.12"E	150	Inerte + Mbetje familjare
43	41°20'31.95"N	19°48'51.88"E	40	Inerte + Mbetje familjare
44	41°21'13.20"N	19°51'3.23"E	20	Inerte + Mbetje familjare
45	41°20'2.57"N	19°50'45.85"E	25	Inerte + Mbetje familjare
46	41°21'27.02"N	19°45'54.19"E	120	Inerte + Mbetje familjare
Gjithsej			16295 m ³	

Burimi: Ekipi Studimor i JICA-s

(4) Programi Kohor i Zbatimit të Projektit

Sipas programit të zbatimit në Tabelën 12.3.2 më poshtë, Projekti pritet të përfundoj gjatë një periudhe trevjeçare në Periudhën e Ngutshme dhe Afatshkurtër.

Tabela 12.3.2 Afati kohor i Zbatimit të Projektit të Pastrimit

Plan Veprimet		Periudha Emergjente dhe Afat-Shkurtër					Periudha Afat-Mesme					Periudha Afat-Gjatë				
		2013	2014	2015	2016	2017	2018	2019	2020	2021	2022	2023	2024	2025	2026	2027
MMN-1	Plani i Grumbullimit dhe Transportimit të Mbetjeve															
MMN-1-2	Vrojimi i Vendepozitimeve ilegale dhe Përgatitja e projektit të Pastrimit															
MMN-1-3	Zbatimi i Projektit të Pastrimit të Vendepozitimeve ilegale përmes Kontraktimit															

Burimi: Ekipi Studimor i JICA-s

12.3.2. Shërbimet e Grumbullimit dhe Transportimit të Ndarë të Mbetjeve

(1) Objektivat e Projektit

Objektivi i përgjithshëm i projektit është të ruajë pastërtinë e qytetit përmes përmirësimit të grumbullimit të mbetjeve, zgjerimit të zonës së shërbimit, si dhe futjen e sistemit të grumbullimit të ndarë të mbetjeve. Futja e grumbullimit të ndarë, synon rritjen e sasisë të rimëkëmbjes së materialeve të riciklueshme për ripërdorimin dhe riciklimin duke kursyer burimet dhe ulur sasinë e mbetjeve të fundme për depozitim përfundimtar.

(2) Vendndodhja e Projektit ose Zona e Mbulimit

Zona e projektit përfshin të gjithë zonën e BT. Projekti do të fillojë në të njëjtat zonat pilot kandidate të programeve 3R, si dhe praktikatat e mira të nxjerra nga zonat pilot të studimit do të zgjerohen në zonat fqinje dhe në të gjithë zonën e BT.

(3) Komponentët dhe Përbërja e Projektit

1) Komponentët e Projektit

Ky projekt është mbështetur nga shumë nënprojekte dhe programe të tjera. Grumbullimi i ndarë, përfshin disa aktivitete, që lidhen me pjesëmarrjen e prodhuesve të mbetjeve në ndarjen e materialeve të riciklueshme në burim, metodës së shkarkimit të mbetjeve, përfshirjen e grumbulluesve të mbetjeve dhe industrive ricikluese, etj. Këto aktivitete


sfiduese janë për t'u praktikuar në nënprojektet në vijim dhe do të shpërndahen në zonat fqinje.

- MMN. 1-4: Zbatimi i Studimit Pilot për Përmirësimin e Shërbimit të Grumbullimit të Mbetjeve
- MMN. 1-4-1: Studimi për Zgjerimin e Zonës së Shërbimit për Grumbullim të Ndarë
- MMN. 1-4-2: Studimi i Grumbullimit të Ndarë të Mbetjeve për Mbetjet e veçanta
- MMN. 1-4-3: Zbatimi i Grumbullimit të Ndarë në Zonën Pilot të Studimit.

Si shtesë e nënprojekteve të listuara më sipër, përmbajtjet e programeve janë të përshkruara si në seksionin 5.7, Plani i Grumbullimit dhe Transportimit të Mbetjeve. Përshkrime shtesë janë dhënë në vijim.

2) Zonat Kandidate të Studimit Pilot

Projekti është ndërmarr fillimisht në zonat e studimit pilot, për të studiuar metodën praktike dhe të frytshme për grumbullimin e ndarë duke përdorur sistemin me 3 kontejnerë. Zonat e studimit pilot do të zgjidhen nga tri lloje përfaqësuesish, 1) zona e vilave/ shtëpive private, 2) zona e apartamenteve/pallateve, 3) zona tregtare. Metodat ose rasti model, që duhet zhvillohet në zonën pilot të studimit do të përdoren në gjithë zonën e shërbimit të grumbullimit, për futjen e sistemit më të mirë të grumbullimit të mbetjeve në BT. Figura 12.3.2 tregon vendet kandidatë të propozuara, të zonës së studimit pilot.



Burimi: Ekipi Studimor i JICA-s

Figura 12.3.2 Zonat Kandidatë për Studimin Pilot


3) Zbatimi i Programeve dhe Parakushtet

Projekti zbatohet në bashkëpunim me programet 3R për këto aktivitetet: i) zgjerimin e zonës së grumbullimit të mbetjeve, ii) ndarjen në burim të materialeve të riciklueshme, iii) vendosjen e sistemit të 3-kontejnerëve (kontejnerët e të riciklueshmeve të thata, kontejnerët e të riciklueshmeve të njoma dhe të fundmet), iv) shkarkimin e mbetjeve dhe materialeve të riciklueshme në kontejnerët e caktuar, v) rritjen e ndërgjegjes së publikut për aktivitetet 3R. Për zbatimin e suksesshëm të aktiviteteve, çështjet në vijim bëhen parakusht. Ekipi i Punës së Projekteve, në bashkëpunim me sektorët përkatës dhe palët e interesuara duhet të organizojnë pjesëmarrjen e grupit në aktivitete dhe të japin udhëzime për ecuritë e programeve, të cilat janë:

- Pjesëmarrja e prodhuesve të mbetjeve, përfshirë banorët, subjektet tregtare dhe të biznesit për ndarjen dhe shkarkimin e mbetjeve, vendosjen e materialeve të riciklueshme, siç duhet në kontejnerët e caktuar të mbetjeve dhe/ose qendrat e rikuperimit të materialeve,
- Pjesëmarrja e grumbulluesve të mbetjeve në qytet, tregtarët e materialeve të riciklueshme, industrinë e riciklimit për rikuperim dhe riciklim,
- Ndarja e materialeve të riciklueshme në burim dhe hedhja e tyre në kontejnerët e caktuar të mbetjeve, të sistemit me 3-kontejnerë dhe/ose t'i sjellë ato në FRM të qytetit ose në qendra të tjera të rikuperimit të materialeve.

4) Zonat e Shtrirjes së Grumbullimit të Mbetjeve

Grumbullimi i ndarë duhet zbatuar në tërë zonën e BT, përfshirë rrethinat e BT, ku shërbimi i grumbullimit të mbetjeve nuk arrin dhe ka venddepozitime të hapura, siç tregohet në Figurën 12.3.3.



Burimi: Ekipi Studimor i JICA-s

Figura 12.3.3 Zonat e Pambuluara me Shërbimin e Grumbullimit

(4) Programi Kohor i Zbatimit të Projektit

Tabela 12.3.3 tregon programin kohor të zbatimit të Shërbimeve të Grumbullimit dhe Transportimit të Ndarë të Mbetjeve. Projekti është programuar për 2013, duke i dhënë kohë BT të përgatisë programet, që do të ndërmarrë në zonën pilot të studimit. Projekti duhet ndërmarrë në vijimësi, në mënyrë që modeli(et) praktike të mira mund të shpërndahen gradualisht në zonat fqinje dhe në tërë zonën e BT, përmes periudhës së masterplanit.

Tabela 12.3.3 Programi Kohor i Projektit të Grumbullimit të Ndarë të Mbetjeve

Plan Veprimet		Periudha Emergjente dhe Afat-Shkurtër					Periudha Afat-Mesme					Periudha Afat-Gjatë				
		2013	2014	2015	2016	2017	2018	2019	2020	2021	2022	2023	2024	2025	2026	2027
MMN-1	Plani i Grumbullimit dhe Transportimit të Mbetjeve															
MMN-1-4	Zbatimi i Studimit Pilot për Përmirësimin e Shërbimit të Grumbullimit të Mbetjeve															
MMN-1-4-1	Studimi për zgjerimin e zonës së shërbimit me sistemin e 3-koshave															
MMN-1-4-2	Studimi i Grumbullimit të Ndarë të Mbetjeve për Mbetjet Speciale															
MMN-1-4-3	Zbatimi i Grumbullimit të Ndarë në Zonat Pilot të Studimit															
MMN-1-5	Operimi/Funksionimi i Grumbullimit të Ndarë sipas Sistemit me 3-kosha															

Burimi: Ekipi Studimor i JICA-s

12.3.3. Paraqitja e Programeve “3R”

(1) Objektivat e Projektit

Objekti i Projektit është të zbatojë aktivitetet 3R dhe kështu të ndihmojë në ruajtjen e burimeve natyrore të fundme, pakësimin e mbetjeve të shkarkuara në mjedis dhe uljen e barrës fiskale të BT për menaxhimin e mbetjeve të ngurta.

(2) Vendndodhja e Projektit ose Zona e Mbulimit

Zona e projektit mbulon tërë zonën e BT. Projekti duhet të fillojë në të njëjtat zona të studimit pilot, për të zbatuar grumbullimin e ndarë të mbetjeve siç tregohet në Figurën 12.3.2 dhe praktikatat e mira nga zonat pilot të studimit duhet të shtrihen në zonat fqinje dhe në tërë zonën e BT.

(3) Përbërësit e Projektit

1) Përbërësit e Projektit

Ky Projekt mbështetet në shumë nënprojekte dhe programe të tjera, që përmenden më poshtë.


- MMN 2-2: Zbatimi i Aktiviteteve 3R
- MMN 2-2-1: Nxitja e Kontrollit të Burimit të Prodhimit të Mbetjeve
- MMN 2-2-2: Nxitja e Kontrollit të Shkarkimit të Mbetjeve
- MMN 2-2-3: Nxitja e Rikuperimit të Materialeve të Riciklueshme
- MMN 2-2-4: Nxitja e Ripërdorimit dhe Riciklimit të Materialeve të Riciklueshme
- MMN 2-2-5: Ndërtimi i Impiantit Qendror të Rikuperimit të Materialeve në Sharrë
- MMN 2-2-6: Funksionimi i Impiantit Qendror të Rikuperimit të Materialeve në Sharrë

Veç nënprojekteve të listuara më poshtë, aktivitetet e studimit pilot përfshijnë aktivitetet

sfiduese për grumbullimin e ndarë të mbetjeve, kompostimin në familje dhe në komunitet, që duhet kryer paralel me aktivitetet 3R. Përbërësit e programeve janë siç përshkruhen nën seksionin 5.8, Plani i Pakësimit të Mbetjeve (3R) me përshkrime shtesë të siguruara më poshtë.

2) Zërat e programeve 3R


Programet e aktiviteteve 3R përfshijnë: i) kontrollin e burimit të prodhimit të mbetjeve, ii) kontrollin e shkarkimit të mbetjeve, iii) rikuperimin e materialeve të riciklueshme, dhe iv) ripërdorimi dhe riciklimi, të cilat tregohen në Figurën 12.3.4.



Burimi: Ekipi Studimor i JICA-s

Figura 12.3.4 Përbërësit e Programeve 3R

Secili program, që kompozon aktivitetet 3R është ndarë më tej në nënprograme për tu ndërmarrë me përfshirjen e të gjitha palëve të interesuara për t'i zhvilluar në aktivitete sociale. Qëllimi i çdo programi dhe roli i BT/Qeverisë dhe palëve të interesuara janë përmbledhur dhe treguar në Figurën 12.3.5 për aktivitetet kyç, që do të zbatojnë programet 3R.



Burimi Ekipi Studimor i JICA-s

Figura 12.3.5 Qëllimi i Secilit Program dhe Roli i Palëve të Interesuara për Zbatimin e Programeve 3R

3) Rikuperimi i Materialeve të Riciklueshme

Rikuperimi i burimeve dhe riciklimi mund të shmangin sasi të ndjeshme të materialeve të riciklueshme, që mund të jenë dorëzuar në depozitimin përfundimtar. Mënyra më e mirë për të rimarrë një sasi të madhe të mbetjeve të riciklueshme është në burim krahasuar me sasinë e përfutueshme në mbetjet e përziera. Rikuperimi në burim do të përmirësojë cilësinë e materialeve të gjetura dhe të përmirësojë frytshmërinë e programit. Kjo metodë përfshin praktikën e ndarjes së mbetjeve nga prodhuesit individualë të mbetjeve dhe vendosjen e tyre në kontejnerët e mbetjeve të sistemit me 3-kontejnerë, e që më pas do të mblidhen veças, ose prodhuesi individual i mbetjeve do të sjellë materialet e riciklueshme në stacionet e grumbullimit, të tilla si FRM në Qytet. Shndërrimi i mbetjeve është një tjetër lloj i rikuperimit të burimeve dhe riciklimit, dhe ky proces ka nevojë për impiantet e trajtimit të ndërmjetëm, si një impiant kompostimi dhe biogazifikimi, dhe impiantet e mbetjeve në energji, të cilat do të shndërrojnë të biodegradueshmet, mbetjet organike, dhe të djegshme në kompost, biogas, dhe në energji elektrike, respektivisht. Shndërrimi i mbetjeve mund të fillojë pas përfundimit të ndërtimit të impianteve të ndërmjetme. Në përmbledhje, sistemi për rikuperimin e materialeve të riciklueshme përfshin:

- Rikuperimi i letrës, plastikës, qelqit dhe metalet nga kontejnerët e mbetjeve të riciklueshme të thata të sistemit me 3-kontejnerë;
- Rikuperimi i mbetjeve të biodegradueshme/organike nga kontejnerët e mbetjeve të riciklueshme të njoma nga sistemi me 3-kontejnerë;
- Rikuperimi i mbetjeve të djegshme nga kontejnerët e mbetjeve të djegshme, kur të ndërrohet me sistemin me 4 kontejnerë në të ardhmen;
- Rikuperimi i letrës, plastikës, qelqit dhe metaleve në qendrat e shlyerjes si FRM në Qytet në këmbim të parave ose të mallrave;
- Rikuperimi i letrës dhe plastikës nga prodhuesit të mëdhenj të mbetjeve nga ofruesit e rikuperimit dhe/ose Sipërmarrjes ALB të Rikuperimit dhe Riciklimit.

4) Programet e Ripërdorimit dhe Riciklimit

Programi i ripërdorimit do të përbëhet nga:

- Ripërdorimi i pajisjeve, që funksionojnë mirë, veglave dhe pajisjeve elektrike pas riparimit;
- Tregu i hapur për shkëmbimin/shitjen e komoditeteve të rikuperuara;
- Nxitja e fjalës dhe praktikës së “*Mendimi Mottainai*” (japonisht përkthehet “do të jetë një mbetje për të ardhur keq...”) për të ruajtur të gjitha materialet që janë të përdorshme.

Programi i riciklimit duhet të kryhet nga riciklimi dhe rikuperimi i materialeve burimore dhe shndërrimi i mbetjeve organike dhe të djegshme nga trajtimi i ndërmjetëm, që përmbledhet në këto aktivitete bashkë me aktorët:

- Riciklimi i letrës, plastikës, qelqit dhe metaleve nga industritë e riciklimit përfaqësuar nga organizata(t) ekzistuese si Shoqata Shqiptare e Riciklimit (ARA) dhe/ose Sipërmarrja ALB e Rikuperimit dhe Riciklimit;
- Kompostimi i mbetjeve të biodegradueshme nga rolet e BT dhe/ose kontraktorit;

- Biogazifikimi i mbetjeve të biodegradueshme nga rolet e BT dhe/ose kontraktorit;
- Shndërrimi i mbetjeve të djegshme në energji nga rolet e BT dhe/ose kontraktorit.

5) Funksionet e Impiantit të Materialeve të Riciklueshme


Plani bazë për rikuperimin e materialeve burimore është propozuar me dy opsione. Të dyja opsionet kanë nevojë për ndarjen e materialeve të riciklueshme në burimin e prodhimit të mbetjeve. Opsioni i parë është rikuperimi i letrës, plastikës, qelqit dhe metaleve të ndara në qendrën e grumbullimit përfaqësuar nga FRM në Qytet në shkëmbim të parave ose mallrave. Opsioni i dytë është rikuperimi i materialeve të riciklueshme të ndara shkarkuar në kontejnerët e mbetjeve të materialeve të riciklueshme të thata nën skemën e sistemit me 3 kontejnerë. FRM Qendror ndërtohet për të patur funksionin e ndarjes dytësore vetëm për materialet e riciklueshme të thata të sistemit me 3-kontejnerë dhe kundërshtimi i materialeve të papërshtatshme për depozitim përfundimtar. FRM Qendror i projektuar në thelb për procesin manual të ndarjes mund të ofrojë një masë lehtësuese për rreth 50-100 mbledhës mbetjesh, të cilët do të humbasin burimin e të ardhurave pas ndalimit të grumbullimit të mbetjeve në zonën e landfillit. Në përfundim, FRM Qendror duhet të kryejë funksionet e mëtejshme.

- FRM Qendror duhet të kryejë funksionet kryesore për marrjen e materialeve të thata të riciklueshme të sistemit me 3-kontejnerë për ndarjen dytësore, procesin dhe transportimin të ricikluesit/industrisë përmes hapjes së një faqeje elektronike të informacionit të magazinuar.
- FRM Qendror është propozuar si një qendër shpërndarjeje e materialeve të riciklueshme për t'u kryer dhe mirëmbajtur nga grupe të organizuara të mbledhësve të mbetjeve, tregtarët, ricikluesit/industrinë dhe/ose kontraktorët PPP në lidhje me BT nëpërmjet Ndërmarrjes së Menaxhimit të Mbetjeve të Tiranës..
- FRM Qendror është propozuar të jetë në zonën ngjitur venddepozitimit ekzistues të Sharrës, siç tregohet në planin e Figurës 12.3.6.

6) Ndërtimi i FRM

Funksionimi i FRM duhet të regjistrojë:

- Sasinë e materialeve të riciklueshme të hyra dhe të shitura, si letrën, plastikën, qelqin dhe metalet;
- Sasinë e shitur të materialeve të riciklueshme;
- Të dhënat ditore të forcës punëtore;
- Llogaritjen e funksionimit dhe mirëmbajtjes së FRM Qendror.



Burimi: Ekipi Studimor i JICA-s

Figura 12.3.6 Plani i Propozuar i FRM Qendror dhe Ndërtimi i Godinave të Zyrave

(4) Programi kohor i Zbatimit të Projektit

Tabela 12.3.4 tregon programin kohor të zbatimit të programeve 3R. Në tabelë tregohet viti i fillimit të Projektit, që është 2014 në Periudhën e Ngutshme dhe Afatshkurtër dhe vazhdon deri në fund të periudhës së Masterplanit.

Tabela 12.3.4 Programi kohor i Zbatimit të Programeve 3R

Plan Veprimet		Periudha Emergjente dhe Afat-Shkurtër					Periudha Afat-Mesme					Periudha Afat-Gjatë				
		2013	2014	2015	2016	2017	2018	2019	2020	2021	2022	2023	2024	2025	2026	2027
MMN-2	Plani i Minimimit të Mbejeve (Plani 3R)															
MMN-2-2	Zbatimi i Aktiviteteve 3R															
MMN-2-2-1	Promovimi i Kontrollit të Burimit të Prodimit të Mbejeve															
MMN-2-2-2	Promovimi i Kontrollit të Shkarkimit të Mbejeve															
MMN-2-2-3	Promovimi i Rekuperimit të Materialeve të Rickueshme															
MMN-2-2-4	Promovimi i Ripërdorimit dhe Rickimit të Materialeve të Rickueshme															
MMN-2-2-5	Ndërtimi i Implantit Qendror të Rekuperimit të Materialeve në Sharë															
	Puna Civile															
	Puna e Ndërtimit															
	Punimet Mekanike&Elektrike															
	Punimet Inxhinierike (Projekim 5% : Supervizim 5%)															
MMN-2-2-6	Operimi/Funksionimi i Implantit Qendror të Rekuperimit të Materialeve në Sharë															

Burimi: Ekipi Studimor i JICA-s


12.3.4. Projekti i Trajtimit të Mbetjeve Organike

(1) Objektivat e Projektit

Projekti synon trajtimin e mbetjeve të biodegradueshme përmes përdorimit të burimeve të mundshme për biomasë. Ndërkohë, me zbatimin e Projektit, niveli i synuar nga Direktiva e BE-së për të pakësuar sasinë e mbetjeve organike të sjella në landfill me më pak se 35% në 2016, që duhet arritur.

(2) Vendndodhja e Projektit ose Zona e Mbulimit

Kompostimi në familje dhe në komunitet do të kryhet fillimisht në zonat e studimit pilot, së bashku me programet pilot për grumbullimin e ndarë të mbetjeve, aktiviteteve 3R, dhe aktiviteteve të rritjes së ndërgjegjes. Modelet e praktikave më të mira duhet të shpërndahen shkallë-shkallë në zonat fqinje dhe në tërë zonën e BT. Vendi i ndërtimit të impianteve të trajtimit të mbetjeve organike përfshirë impiantin pilot të kompostimit, impiantin qendror të kompostimit, dhe/ose impiantin e biogazifikimit janë propozuar të alokohen në zonën ngjitur impianit të mbetjeve në energji dhe vendit për impiantet e venddepozitimit të Sharrës Faza 1, siç tregohet në Figurën 12.3.7.



Burimi: Ekipi Studimor i JICA-s

Figura 12.3.7 Vendi i Propozuar i Ndërtimit të Impianteve të Kompostimit dhe/ose Biogazifikimit

(3) Përbërësit e Projektit

1) Përbërësit e Projektit

Projekti përmban këto nënprojekte:

- MMN 3-2-1: Organizimin e Kompostimit në Shtëpi dhe Grupeve Komunitare të Kompostimi
- MMN 3-2-2: Zbatimin e Projektit Pilot të Kompostimit në Shtëpi dhe Komunitet
- MMN 3-2-3: Zgjerimin/Shtrirjen e Praktikës së Kompostimit në Shtëpi dhe Komunitet
- MMN 3-2-4: Përzgjedhjen e Burimit të Madh të Prodhimit të Mbetjeve të Biodegradueshme
- MMN 3-2-5: Ndërtimin e Impiantit të Kompostimit i Shkallës Pilot
- MMN 3-2-6: Funksionimin dhe Mirëmbajtjen e Impiantit të Kompostimit të Shkallës Pilot
- MMN 3-2-7: Ndërtimin e Impiantit Qendror të Kompostimit/Biogazifikimit
- MMN 3-2-8: Funksionimin dhe Mirëmbajtjen e Impiantit Qendror të Kompostimit / Biogazifikimit

Përbërësit e programeve janë skicuar në seksionin 5.9, Planit të Trajtimit të Ndërmjetëm, dhe përshkrimet shtesë janë dhënë në vijim.

2) Metoda e Grumbullimit të Mbetjeve të Biodegradueshme

Materialet e para për kompostimin dhe biogazifikimin e mbetjeve të biodegradueshme, janë grumbulluar në dy rrugë: grumbullimit të drejtpërdrejtë nga burimet e prodhuesve të mbetjeve dhe grumbullimit nga kontejnerët e mbetjeve të riciklueshme të njoma të sistemit me 3 kontejnerë. Ecuria për grumbullimin e tyre tregohet në Figurën 12.3.8.




Figura 12.3.8 Rrjedha e Grumbullimit të Materialeve të Para për Kompostim dhe/ose Biogazifikim

3) Metoda e Kompostimit në Shtëpi dhe Kompostimi në Komunitet

Ka disa alternativa për kompostimin në shkallë të vogël, si kompostimi në shtëpi dhe në komunitet. Siç propozohet më herët, metodat në vijim janë vlerësuar si metodat alternative të praktikimit në zonat e studimit pilot.

Alternativat e Kompostimit në Shtëpi

- Kompostimi në Kontejnerë Plastikë
- Kompostimi me shtresa toke

Alternativat e Kompostimit në Komunitet

- Duke kombinuar/shtuar kontejnerët plastikë me llojin e kompostimit “Windrow” (shtesa në tokë)
- Kompostimi i Llojit “Windrow”

Këto alternativa duhet të praktikohen dhe përmirësohen gjatë studimit pilot për të gjetur metodën e parapëlqyeshme për kompostimin në shtëpi dhe komunitet. Pas përmirësimit, nëse është e nevojshme, procedurat e kompostimit do të shpërndahen në zonat fqinje.

4) Qëllimi dhe Funksionet e Impiantit të Kompostimit dhe/ose Biogazifikimit në Shkallë Pilot

Kompostimi dhe/ose biogazifikimi në shkallë pilot, si trajtimi i mbetjeve një ton në ditë duhet të ndërtohet për qëllime dhe funksione të cituara më sipër. Rezultatet e impianteve në shkallë pilot duhet të reflektohen për projektimin e impianteve qendrore të kompostimit dhe/ose biogazifikimit.

- Impiantet duhet të kenë funksionet për testimin e proceseve për kompostimin dhe/ose metanizimin, për të studiuar suksesin e procesit të projektimit dhe funksionimit.
- Mbetjet e biodegradueshme nga kontejneri i të riciklueshmeve të njoma, janë pranuar në impiantin pilot të kompostimit, ose mbetjet e biodegradueshme të ndara nga prodhuesit e mëdhenj të mbetjeve mund të përdoren për lëndë të para
- Mbetjet e ndara të biodegradueshme nga prodhuesit e mëdhenj të mbetjeve pranohen/futen në impiantin pilot të biogazifikimit.
- Impianti pilot i kompostimit do të projektohet kryesisht për kompostimin e llojit “Windrow” me/ose ajrim dhe një seri procesesh për marrjen, para-trajtimin, largimin e mbetjeve të papërshtatshme, para-tharmimin, pas-tharmimin, maturimin, magazinimin, transportimin dhe testimin e kompostit në kopsht.
- Impianti pilot i kompostimit duhet të projektohet për proces me dorë sa më shumë të jetë e mundur, për të patur mundësinë e punësimit të mbledhësve të mbetjeve si forcë punëtore për kompostimin.
- Impianti pilot i biogazifikimit do të projektohet me sisteme të llojit të njomë ose llojit të thatë, me një seri procesesh për marrjen, metanizimin, ngrohjen, desulfurimin, magazinimin, furnizimin me ujë të ngrohtë ose djegien e gazit, dhe/ose impiante të tjera shtesë.


5) Regjistrimet e Funksionimit të Punës së Impianteve të Kompostimit dhe/ose Biogazifikimit në Shkallën Pilot

Gjatë funksionimit të impiantit të kompostimit dhe/ose biogazifikimit në shkallën pilot, të paktën veprimet në vijim duhet të regjistrohen dhe analizohen për të verifikuar suksesin e procesit të projektimit, si referencë për të projektuar impiantet e qendrore të kompostimit dhe/ose biogazifikimit.

- Sasia ditore e hyrjes dhe daljes për secilin impiant;
- Temperatura, përmbajtja e lagështisë, përqendrimi i oksigjenit, oksigjeni i tretur, etj., në proceset e kompostimit dhe biogazifikimi;
- Cilësia e kompostit përfshirë përqendrimin NPK, Ph, EC, C/N, përmbajtjen e lagështirës, dendësisë, metaleve të rënda, etj.;
- Përqendrimi i metanit, dioksidit të karbonit dhe i sulfidit të hidrogjenit;
- Të dhëna për testimin e kompostit në ferma përfshirë sasinë e përdorur të kompostit, regjistrimin e rritjes së bimës me dhe pa kompost, etj.;
- Regjistrime mujore për konsumin e energjisë elektrike, ujit dhe forcës punëtore të përdorur;
- Regjistrimi ditor dhe mujor i mirëmbajtjes së pajisjeve dhe sistemeve;
- Përgatitja e raporteve 4 mujore për gjendjen e funksionimit të secilit impiant.

6) Rrjedha e Procesit të Impiantit Qendror të Kompostimit

Rrjedha tipike e procesit të trajtimit, të llojit “Windrow” të kompostimit tregohet në Figurën 12.3.9. Rrjedha e procesit është bazuar në kapacitetin e trajtimit prej 50t/ditë të mbetjeve të biodegradueshme. Rrjedha e trajtimit mund të modifikohet sipas rezultateve të funksionimit të eksperimentimit të kompostimit në shkallë pilot.



Burimi: Ekipi Studimor i JICA-s


Figure 12.3.9 Skema e Procesit të Impiantit të Kompostimit Qendror të Propozuar (50 tonë/ditë)

7) Rrjedha e Procesit të Impiantit Qendror të Biogazifikimit

Rrjedha tipike e procesit të trajtimit, të llojit të biogazifikimit të njomë tregohet në Figurën 12.3.10. Rrjedha e procesit është bazuar në kapacitetin e trajtimit prej 50t/ditë të mbetjeve të biodegradueshme, të ndara. Rrjedha e trajtimit mund të korrigjohet sipas rezultateve të funksionimit të eksperimentimit të biogazifikimit në shkallë pilot.

8) Afati Kohor i Zbatimit të Projektit

Tabela 12.3.5 tregon zbatimin e programit kohor të Projekteve të Trajtimit të Mbetjeve Organike. Siç duket nga tabela, kompostimi në shkallë pilot është planifikuar të fillojë punën në 2013. Faza e parë e funksionimit të impianteve qendrore për kompostimin dhe biogazifikimin është programuar në 2017 dhe impiantet e fazave të dyta janë planifikuar të fillojnë në 2022.



Burimi: Ekipi Studimor i JICA-s

Figura 12.3.10 Skema e Procesit të Impiantit të Biogazifikimit Qendror të Propozuar (50 tonë/ditë)

Tabela 12.3.5 Programi kohor i zbatimit të Projektit të Trajtimit të Mbetjeve Organike

Plan Veprimet		Periodha Emergjente dhe Afat-Shkurtër					Periodha Afat-Mesme					Periodha Afat-Gatë				
		2013	2014	2015	2016	2017	2018	2019	2020	2021	2022	2023	2024	2025	2026	2027
MMN-3	Plan i Trajtimit të Ndërmjetëm															
MMN-3-2	Zbatimi i Planit të Trajtimit të Mbetjeve Organike															
MMN-3-2-1	Organizimi i Kompostimit në Shëpi dhe Grupeve Komunitare të Kompostimit															
MMN-3-2-2	Zbatimi i Projektit Pilot të Kompostimit në Shëpi dhe Komunitet															
MMN-3-2-3	Zgjerimi/Shitja e Praktikës së Kompostimit në Shëpi dhe Komunitet															
MMN-3-2-4	Përzgjedhja e Burimit të Madh të Prodhimit të Mbetjeve të Biodegradueshme															
MMN-3-2-5	Ndërtimi i Impiantit të Kompostimit i Shkalës Pilot															
	Puna Civile															
	Puna e Ndërtimit															
	Punimet Mekanike&Elektrike															
	Punimet Inxhinierike (Projekim 5% : Supervizim 5%)															
MMN-3-2-6	Operimi/Funksionimi dhe Mirëmbajtja e Impiantit të Kompostimit i Shkalës Pilot															
	Kosto Operative (Kosto e Personelit)															
	Kosto Operative (Energjia Elektrike & Shpërdorime)															
	Kostoja e Mirëmbajtjes															
MMN-3-2-7	Ndërtimi i Impiantit Qendror të Kompostimit/Biogazifikimit															
	Puna Civile															
	Puna e Ndërtimit															
	Punimet Mekanike&Elektrike															
	Punimet Inxhinierike (Projekim 5% : Supervizim 5%)															
MMN-3-2-8	Operimi/Funksionimi dhe Mirëmbajtja e Impiantit Qendror të Kompostimit / Biogazifikimit															

Burimi: Ekipi Studimor i JICA-s

12.3.5. Projekti i Mbetjeve në Energji

(1) Objektivat e Projektit

Projekti synon të ulë vëllimin në landfill, stabilizimin e mbetjeve dhe rritjen e normës së riciklimit për të qenë në përputhje me nivelin përfundimtar të synuar % të normës së rikuperimit dhe riciklimit, të përcaktuar në Planin Kombëtar të Menaxhimit të Mbetjeve. Shkalla e impiantit të mbetjeve në energji duhet të projektohet mjaft e madhe për të rikuperuar energji në formë elektriciteti për ta përdorur në impiant dhe sasisë shtesë së elektricitetit për ta shitur te kompania energjetike. Ndërkohë, shkalla e impiantit duhet të ulët për të ulur koston e investimit të Projektit. Shkalla e impiantit të 360 t/ditë do të jetë shkalla e duhur për zhvillimin e impiantit të mbetjeve në energji, në përputhje me normën e rikuperimit dhe riciklimit, sasinë së rikuperuar të energjisë, marrëdhënien me shkallën e impiantit të kompostimit dhe biogazifikimit, dhe sasinë e cilësinë e mbetjeve të BT.

(2) Vendndodhja e Projektit ose Zona e Mbulimit

Vendi i impiantit të mbetjeve në energji është propozuar të lokalizohet midis venddepozitimit të Sharrës Faza 1, dhe vendit të impiantit qendror të kompostimit dhe/ose biogazifikimit siç tregohet në Figurën 12.3.11.

(3) Përbërësit e Projektit

1) Përbërësit e Projektit

Projekti është i përbërë nga nënprojektet e mëposhtme:

- MMN 3-4-1: Përzgjedhja e Vendit të Ndërtimit dhe Prokurimi
- MMN 3-4-2: Ndërtimi i Impiantit të kthimit të Mbetjeve-në-Energji
- MMN 3-4-3: Funkionimi dhe Mirëmbajtja e Impiantit të Mbetjeve-në-Energji

Përbërësit e Programeve përshkruhen në seksionin 5.9; Plani i Trajtimit të Ndërmjetëm

2) Zgjedhja e Vendit dhe Prokurimi


Vendi i ndërtimit të impiantit të trajtimit të ndërmjetëm është propozuar në zonën ngjitur të venddepozitimit të mbetjeve Sharrë. Vendi për impiantin e mbetjeve në energji duhet të alokohet në lidhje me vendin e ndërtimit të impiantit të kompostimit, biogazifikimit dhe impianteve të tjera. Alokimi i vendit përfundimtar duhet të fillojë menjëherë për të verifikuar përshtatshmërinë e vendit të propozuar, në konsultim me Komunën Vaqarr dhe agjencitë përkatëse. Dhe në vijim po japim hapat, që duhen ndërmarrë, por që nuk janë të limituara.

- Zbatimi i studimit të zgjedhjes së vendit, përgatitja e raportit, dhe vendimi i BT-së;
- Konsultimi me Komunën Vaqarr për përdorim të zonës ngjitur me venddepozitimin e Sharrës;
- Shënimi i minutave të marrëveshjes midis BT dhe Komunës Vaqarr për përdorimin e vendit të propozuar për zhvillimin e impianteve gjithëpërfshirëse të MMN
- Projektimi i vendit të propozuar për vendin e impianteve të MMN sipas planit të përdorimit të tokës të planit të zhvillimit urban të BT;
- Përgatitja e studimit të VNM-së, zbatimi dhe miratimi nga MMPAU

Të gjitha proceset e zgjedhjes së vendit, të përmendura më sipër duhet të kompletëhet në fund të 2014 përpara fillimit të ndërtimit që nga fillimi i 2015.

3) Rrjedha e Impiantit të Mbetjeve në Energji (360 t/ditë)

Rrjedha tipike e procesit të implantit të mbetjeve në energji është ilustruar në Figurën 12.3.11. Rrjedha e procesit është bazuar në kapacitetin e futjes së mbetjeve të para prej 360 t/ditë.



Burimi: Ekipi Studimor i JICA-s

Figure 12.3.11 Rrjedha e Procesit të Implantit të Mbetjeve në Energji (360 t/ditë)

4) Regjistrimi i Informacionit dhe të Dhënave të Funksionimit

Në funksionimin e implantit të mbetjeve në energji, operatorët duhet të regjistrojnë së paku të dhënat dhe informacionet e punës dhe të aktiviteteve në vijim për të matur rezultatin e funksionimit të implantit dhe vlerësimit të kostos së trajtimit për ton.

- Sasia ditore e mbetjeve të hyra dhe sasi të daljes së hirit;
- Sasia ditore e prodhimit të energjisë elektrike;
- Sasia ditore e konsumit të energjisë, kimikateve dhe ujit;
- Numri ditor i punonjësve për funksionim dhe mirëmbajtje;
- Të dhënat ditore dhe/ose mujore të mirëmbajtjes së pajisjeve dhe sistemeve;
- Libri i llogarisë mujore për implantin e mbetjeve në energji;
- Përgatitja e raportit 4 mujor për gjendjen e funksionimit të implantit.

5) Programi Kohor i Zbatimit të Projektit

Tabela 12.3.6 tregon programin kohor të zbatimit të Projektit të Kthimit të Mbetjeve në Energji. Projekti, sipas tabelës, duhet të fillojë në 2014 në Periudhën e Ngutshme dhe Afatshkurtër, dhe ndërtimi duhet të përfundojë në fund të 2018 për të filluar punën në fillim të 2019.

Tabela 12.3.6 Programi kohor i Zbatimit të Projektit të Mbetjeve në Energji

Plan Veprimet		Periudha Emergjente dhe Afat-Shkurtër					Periudha Afat-Mesme					Periudha Afat-Gjatë				
		2013	2014	2015	2016	2017	2018	2019	2020	2021	2022	2023	2024	2025	2026	2027
MMN-3	Plani i Trajtimit të Ndërmjetëm															
MMN-3-4	Zbatimi i Planit të Mbetjeve-në-Energji															
MMN-3-4-1	Përzgjedhja e Vendit të Ndërtimit dhe Prokurimi															
MMN-3-4-2	Ndërtimi i Mbetjeve-në-Energji															
	Puna Civile															
	Puna e Ndërtimit															
	Punimet Mekanike&Elektrike															
	Punimet Inxhinierike (Projekim 5% : Supervizim 5%)															
MMN-3-4-3	Operimi/Funksionimi dhe Mirëmbajtja e Impianit të Mbetjeve-në-Energji															

Burimi: Ekipi Studimor i JICA-s

12.3.6. Projekti i Zgjerimit të Impianteve të Depozitimit të Mbetjeve

(1) Objektivat e Projektit

Projekti synon sigurimin e landfillit sanitar pas fundit të jetës së venddepozitimit ekzistues të Sharrës. Impiantet e depozitimit të mbetjeve duhet të kenë vëllim magazinimi të mjaftueshëm për të marrë mbetjet e fundme të grumbulluara nga BT dhe komunat, të cilat sot i depozitojnë mbetjet në impiantet ekzistuese të depozitimit të mbetjeve, Sharrë.

(2) Vendndodhja e Projektit ose Zona e Mbulimit

Vendi i ndërtimit të propozuar lokalizohet në zonën ngjitur venddepozitimit ekzistues të Sharrës dhe vendit të propozuar të ndërtimit të impianteve të trajtimit të ndërmjetëm. Zona e luginës, ngjitur është rezervuar për ngritjen e impianteve të depozitimit të mbetjeve, Sharrë Faza 2, siç tregohet në Figurën 12.3.12.


(3) Përbërësit e Projektit

1) Përbërësit e Projektit

Projekti përfshin këto nënprojekte:

- MMN 4-2: Koordinimi me Planin Rajonal të Depozitimit të Mbetjeve
- MMN 4-3: Përzgjedhja e Vendit të Ndërtimit dhe Prokurimi
- MMN 4-4-1: Ndërtimi i Landfillit Sanitar
- MMN 4-4-2: Operimi/Funksionimi dhe Mirëmbajtja e Landfillit Sanitar
- MMN 4-4-3: Mbyllja e Landfillit Ekzistues

Përbërësit e Programeve janë përshkruar në seksionin 5.10; Plani i Zhvillimit të Impiantit të Depozitimit Përfundimtar.



Burimi: Ekipi Studimor i JICA-s

Figura 12.3.12 Alokimi i Vendeve për Zhvillimin e Impianteve të MMN në Sharrë

2) Ecuritë e Projektit të Zgjerimit të Impianteve të Depozitimit të Mbetjeve

Agjencia e zbatimit duhet të ndërmarrë Projektin në bazë të hapave në vijim:


- Përcaktimi i metodës së kontratës për ndërtimin dhe funksionimin;
- Zgjedhja, kontraktimi dhe bashkëveprimi me kompaninë inxhinierike;
- Projektimi inxhinierik i impianteve të landfillit sanitar;
- Përgatitja e dokumenteve të tenderit
- Përgatitja e tenderit;
- Vlerësimi i tenderit, miratimi, deklarimi i fituesit dhe firmosja e kontratës;
- Ndërtimi;
- Mbikëqyrja e Punimeve të Ndërtimit
- Inspektimi i punimeve të ndërtimit dhe mjeshtëria;
- Dorëzimi i impianteve dhe përfundimi i punimeve të ndërtimit;
- Fillimi i funksionimit dhe mirëmbajtjes së landfillit sanitar.

3) Plani i Përgjithshëm i Impianteve të Depozitimit të Mbetjeve në Sharrë, Faza 1

Landfilli duhet të ndërtohet për të patur një vëllim landfilli në 2 milionë m³ ose më shumë, për t'i shërbyer landfillit më tepër se viti 2027. Objektet kryesore, që përbëjnë impiantet e depozitimit të mbetjeve janë treguar në Figurën 12.3.13 dhe listuar më poshtë.

- Diga kryesore dhe Muri i diafragmës mbledhëse

- Rruga e Mirëmbajtjes dhe Qasjes
- Impiantet e Grumbullimit dhe Trajtimit të Shllamit
- Impiantet e Drenazhimit të Ujërave të Shiut
- Rrethimi i Rrethinave
- OXHaku/Pishtari i Gazit të Landfillit
- Të tjera



Burimi: Ekipi Studimor i JICA-s

Figura 12.3.13 Plani i Përgjithshëm i Impianteve të Depozitimit të Mbetjeve në Sharrë (Faza, 1)

4) Funksionimi dhe Mirëmbajtja e Landfillit

Funksionimi i Landfillit dhe mirëmbajtja duhet të kryhet në bazë të manualeve, të cilat duhet të standardizohen nga të paktën këto aktivitete:

Kushtet Bazë për Funksionimin dhe Mirëmbajtjen

- Llojin e mbetjeve të pranueshme
- Orët e marrjes së mbetjeve
- Orët e punës të landfillit
- Personeli teknik dhe administrativ i landfillit
- Pajisjet e landfillit dhe mjetet
- Burimi i materialit të mbulimit dhe magazinimi i përkohshëm në vendin e depozitimit të mbetjeve

Peshimi i Sasisë së Mbetjeve të Hyra

Mbetjet duhet të maten dhe të regjistrohen:

- Sasia e mbetjeve të ardhura nga zona e grumbullimit, burimet e prodhimit të mbetjeve, lloji i mbetjeve, mbetjet e veçanta ose mbetjet e rrezikshme familjare nga secili mjet;
- Sasia e materialit të mbulimit i shpërndarë në vend dhe ai i magazinuar në oborr.

Tërë sasia e mbetjeve dhe materialet e grumbullimit duhet të vendosen në rend, si një bazë të dhënash, për të analizuar performancën e aktiviteteve të depozitimit të mbetjeve dhe/ose aktiviteteve të grumbullimit dhe transportimit.

Menaxhimi në vija të Përgjithshme i Punës në Landfill

- Përfundimi i punimeve në landfill brenda orarit të punës, për aktivitetet e shpërndarjes, kompaktimit, nivelimit dhe mbulimit me dhë;
- Punimet në Landfill duhet të kryhen si rregull, ditën;
- Zona e Landfillit duhet të ketë të instaluar tabela shënjuese për të treguar thellësinë e mbushjes të mbetjeve dhe tokën mbuluese, siç kërkohet;
- Zona e Landfillit nuk duhet të gërmohet ose mbushet me mbetje duke tejkaluar lartësitë e paracaktuar në landfill, nëse nuk është planifikuar më parë;
- Përparimi i punimeve në landfill duhet të regjistrohet rregullisht nga plane, projekte, dhe vërtetime topografike dhe/ose fotografi. Bërja e fotove çdo tre muaj nga të njëjtat pika monitorimi, do jetë e rëndësishme për regjistrimin e ecurisë së mirë të punës në landfill dhe normën e landfilli, për të vlerësuar vëllimin e mbetur në landfill si dhe jetëgjatësinë.

Funksionimi i Landfillit

Landfilli ekzistues i Sharrës formon një mur luge dhe punimi në landfill kryhet nga pjesa e sipërme e zonës së landfillit. Mund të vijojë të ndjekë të njëjtën sekuencë të punimeve në landfill, por sekuenca e punimeve në zonën e landfillit të ri mund të sugjerohet të fillojë nga pjesa e ulët ose në anën e drejtimit të rrymës së zonës së landfillit. Sipërfaqja e ekspozuar e impianteve të grumbullimit të shllamit brenda zonës së caktuar të landfillit, duhet të mbulohet me përafërsisht një (1) m shtresë të lartë mbetjesh, për të shmangur dëmtimin nga trafiku i mjeteve të landfillit.

Zonat e shkarkimit të mbetjeve të ngurta duhet të kufizohet në një sipërfaqe të vogël, por me hapësirë të mjaftueshme për të akomoduar trafik tjetër mbetjesh. Zona e shkarkimit për atë ditë duhet të përcaktohet dhe drejtohet nga një mbikëqyrës. Shkarkimi i mbetjeve duhet të bëhet normalisht në gishtin/majën e mbushjes, në përputhje të lëvizjeve dhe frytshmërisë së punës së mjeteve të landfillit.

Mbetjet e shkarkuara për ditë pune duhet të shpërndahen, nivelohen dhe ngjeshen brenda zonës së landfillit, në përputhje me planin e landfillit.

Në mënyrë që të shmangen lirshmëritë e shtresave, duhen ulur zbrazëtitat dhe të rritet ngjeshja, thellësia e mbetjeve prej 30cm për shtresë të shpërndarë/niveluar duhet të jetë efektive. Shtresa e lirshme nuk duhet të tejkaloj një thellësi të përafërt me 0,60m përpara kompaktimit. Shpërndarja dhe ngjeshja e mbetjeve duhet të kryhet sa më shpejt të jetë e mundur për të përfunduar punën në landfill brenda orarit të punës.

Regjistrimet e Funksionimit në Landfill dhe Raportet

Puna në landfill përfshin regjistrimin dhe raportimin e këtyre informacioneve :

- Peshat ditore ose vëllimi dhe lloji i mbetjeve të fundme të ardhura, mbetjet e veçanta dhe mbetjet e pranueshme të sjella nga grumbullime individuale dhe operator privatë;
- Regjistri i udhëtimeve javore dhe mujore ose dosjet për lëvizjen e mjeteve të landfillit dhe pajisjeve dhe sasisë së mbetjeve, vëllimit dhe sipërfaqes së landfillit dhe dheut mbulues;
- Regjistri i udhëtimeve ditore ose dosja e kushteve të vendit përfshirë dëmtimet nga zjarri, shpërthimi, rrëshqitjet e tokës, tërmetet, përmbytjet dhe fatkeqësi të tjera.

Në landfill të dhënat e punës duhet të përmbledhen dhe përfshihen si pjesë e Raportit Vjetor të MMN dhe për raportet e kërkuara nga autoritetet e interesuara.

Plani i Inspektimit

Të gjitha objektet dhe pajisjet e impianteve të depozitimit të mbetjeve duhet të kontrollohen rregullisht për të siguruar informacion për masat parandaluese dhe/ose punës riparuese për mirëmbajtjen e funksionimit të secilit implant dhe/ose pajisjeje. Inspektimet javore dhe mujore duhet të kryhen në rregull sipas listës standarde të kontrollit. Impiantet kryesore dhe pajisjet për inspektimin e rregullt duhet të përfshijnë:

- Impiantet mbajtëse të mbetjeve të ngurta (digë dhe shtresë PE);
- Impiantet e kullimit të ujit të shiut;
- Impiantet e grumbullimit të shllamit;
- Pellgu i shllamit dhe impiantet e trajtimit;
- Rrugët hyrëse dhe Rruga e qasjes;
- Peshorja e Mjeteve (ura e peshës);
- OXHAKU i gazit të landfillit dhe / ose tubacionet e mbledhjes;
- Impiante të tjera .

Veç inspektimit të rregullt, ngutshmëria e inspektimit duhet të kryhet pas ndodhjes së reshjeve të rënda, përmbytjeve, stuhive, zjarreve, shpërthimit, rrëshqitjeve të tokës, tërmeteve dhe fatkeqësive të tjera.

Monitorimi i Cilësisë së Ujit

Cilësia e ujit të shllamit, monitorimi i pusit dhe ujit në sipërfaqe do të monitorohet periodikisht për të analizuar ndikimin e mundshëm mjedisor të ujit të pranuar. Të dhënat e cilësisë së ujit të monitoruar duhet të vlerësohen në pajtim me standardin e zbatueshëm të rrjedhës dhe / ose standardit të cilësisë mjedisore të ujit. Të dhënat e cilësisë së ujit të rrjedhave mund të përdoren edhe për të vlerësuar gjendjen e stabilizimit të landfillit. Monitorimi i cilësisë së ujit do të kryhet në pikat e rregullta të monitorimit dhe në përputhje me parametrat e cilësisë së ujit, të pranueshme për autoritetet e interesuara.

Monitorimi i Elementeve të tjera për Sigurinë në Punë dhe Cilësinë e Mjedisit

Gazet e landfillit duhet të monitorohen në zonën e punës në landfill, zonat e rrethinave të venddepozitimit të mbetjeve, daljes së oxhakut të gazit të landfillit, dhe në vendet e tjera të kërkuara. Monitorimi i gazeve të landfillit do të kryhet çdo muaj për gazet e djegshme, të përfaqësuar nga gazi metan (CH₄). Është gjithashtu i detyrueshëm edhe monitorimi i veçantë në një ditë të qetë pas shiut. Nëse përqendrimi i gazit metan arrin 1,5% operatorët dhe punimet duhet të evakohen nga vendi dhe të shuhet zjarret e mundshëm. Puna mund të rifillojë pasi të arrihet niveli i sigurisë të përqendrimit të gazit metan. Veç kësaj, observimi ditor i erërave të këqija nëpërmjet nuhatjes është i rëndësishëm për operatorët, për t'i kushtuar vëmendje zbatimit të punimeve në landfill. Monitorimi i llojeve të tjera të gazrave, si hidrosulfidit (H₂S) dhe amoniakut (NH₃) duhet të kryhet sipas kërkesës.

(4) Programi kohor i zbatimit të Projektit

Tabela 12.3.7 tregon programin kohor të zbatimit të Projektit për Zgjerimin e Impianteve të Depozitimit të Mbetjeve. Projekti duhet të fillojë në 2013, të përfundojë punimet në fund të 2016 dhe puna në landfillin e ri të fillojë në 2017. Vendi ekzistues depozitimit të mbetjeve, Sharrë, duhet të mbyllet në 2017, me fillimin e punës në landfillin e ri.

Tabela 12.3.7 Afati i Zbatimit të Projektit për Zgjerimin e Impianteve të Depozitimit të Mbetjeve

Plan Veprimet		Periodha Emergjente dhe Afat-Shkurtër					Periodha Afat-Mesme					Periodha Afat-Gjatë				
		2013	2014	2015	2016	2017	2018	2019	2020	2021	2022	2023	2024	2025	2026	2027
MMN-4	Plani i Depozitimit të Mbetjeve															
MMN-4-2	Koordinim me Planin Rajonal të Depozitimit të Mbetjeve															
MMN-4-3	Përzgjedhja e Vendi të Ndërtimit dhe Prokurimi															
MMN-4-4	Zbatimi i Projektit të Depozitimit të Mbetjeve															
MMN-4-4-1	Ndërtimi i Landfillit Sanitar															
	Puna Civile															
	Puna e Ndërtimit															
	Punimet Mekanike/Elektrike															
	Punimet Inxhinierike (Projektim 5%: Supervizim 5%)															
MMN-4-4-2	Operimi/Funksionimi dhe Mirëmbajtja e Landfillit Sanitar															
	Kostb Operative (Kostb e Personelit)															
	Kostb Operative (Kostbja e Karburantit)															
	Kostb Operative (Ujë dhe Lëndë Kimike)															
	Kostbja e Mirëmbajtjes															
MMN-4-4-3	Mbyllja e Landfillit Ekzistues															

Burimi: Ekipi Studimor i JICA-s

12.3.7. Fuqizimi Organizativ dhe Institucional

(1) Objektivat e Projektit

Projekti ka për synim organizimin e një njësie menaxhimi të projektit të quajtur “Ekipi Punues i Projekteve”, i cili duhet të marrë nisma për zbatimin e planeve dhe projekteve të formuluar në Planin e MIMN të Bashkisë së Tiranës. Ky Ekip, duhet të ketë rolin dhe përgjegjësitë kryesor e për formulimin dhe përditësimin e Planit të MIMN, zbatimin e projekteve parësore, përshtatjen e kostos së projektit, prokurimin e burimeve të kërkuara, të koordinojë me autoritetet përkatëse /

palët, dhe funksione të tjera të nevojshme për arritjen e Planit të MIMN të Bashkisë së Tiranë, siç është qëllimi dhe planifikimi.

(2) Vendndodhja e Projektit ose Zona e Mbulimit

Anëtarët e Ekipit Punues të Projekteve emërohen nga personeli i BT dhe specialistët mund të rekrutohen nga burimet e jashtme. Ekipi Punues i Projekteve përqendrohet në planet e menaxhimit të mbetjeve të ngurta dhe të projektit në zonën BT si edhe në projektet rajonale dhe kombëtare, ku merr pjesë BT.

(3) Përbërësit e Projektit

1) Përbërësit e Projektit

Projekti përbëhet nga këto nënprojekte:

- MMN 5-1-1: Rekrutimi i Personelit të Sektorit të Projekteve
- MMN 5-1-2: Orientimi i Plan-Veprimeve të Planit të MIMN, Modifikimi dhe Përfundimi
- MMN 5-1-3: Përgatitja e Planit të Zbatimit të Projekteve Parësore
- MMN 5-1-4: Buxhetimi për Zbatimin e Projekteve Parësore

Përmbajtjet e Programeve janë përshkruar nën seksionin 5.11, Plani i Zhvillimit të Kapaciteteve Institucionale, përshkrimet shtesë janë ofruar si më poshtë :

2) Detyrat Kryesore të Ekipit Punues të Projekteve

Ekipi Punues i Projekteve duhet të ndërmarrë këto detyra:

- Formulimin, përditësimin dhe rishikimin e Planit të MIMN të Bashkisë së Tiranës;
- Përgatitjen e planeve të zbatimit, planeve të veprimit dhe programeve të propozuara;
- Vlerësimin e kostos së planeve të veprimit e programeve dhe kërkesave për buxhetimin;
- Dokumentacionin për marrjen e miratimit zyrtar për zbatimin e planeve të veprimit dhe programeve;
- Organizimin dhe propozimin për njësinë e menaxhimit të projektit/ve për secilin projekt/program;
- Mbikëqyrjen e aktiviteteve të planeve të veprimit dhe programeve;
- Vlerësimin e performancës dhe nivelit të synuar të çdo plani të veprimit dhe programit; dhe
- Përgatitjen e raportit vjetor të aktiviteteve të MMN.

3) Buxhetimi i Projekteve Parësore

Ekipi Punues i Projekteve duhet të fillojë planifikimin/kërkimin e burimeve financiare gjatë përgatitjes së planit të zbatimit, të projekteve parësore dhe të zbatojë financimin menjëherë pas përfundimit të dokumentit, duke përfshirë planin e zbatimit, raportin studimor të VNM, raportin e studimit të fizibilitetit dhe formularin e zbatimit për projektin e caktuar. Burimi financiar i projekteve parësore mund të përzgjidhet nga këto mundësi:

- Subvencionimi nga Qeveria Qendrore
- Buxheti vjetor i BT
- Projekt-kredi nga agjencia e ndihmës ndërkombëtare ose agjenci të tjera
- Sektori privat nëpërmjet skemës PPP
- Kombinimi i burimeve të mësipërme financiare

4) Programi Kohor i Projektit

Tabela 12.3.8 tregon programin kohor të zbatimit të Fuqizimit Organizativ në fushën e aktiviteteve të menaxhimit të mbetjeve në BT. Ekipi Punues i Projekteve në fillim të 2013 duhet të organizojë e të promovojë zbatimin e projekteve parësore në përputhje me programin kohor të zbatimit. Fuqizimi institucional duhet të ndërmerret në vijimësi përmes periudhës së masterplanit.

Tabela 12.3.8 Programi Kohor i Fuqizimit Organizativ

Plan Veprimet		Periudha Emergjente dhe Afat-Shkurtër					Periudha Afat-Mesme					Periudha Afat-Gjatë				
		2013	2014	2015	2016	2017	2018	2019	2020	2021	2022	2023	2024	2025	2026	2027
MMN-5	Plani i Zhvillimit të Kapaciteteve Institucionale															
MMN-5-1	Ngrija/Krijimi i Ekipit të ngarkuar me Projektet dhe Zbatimin e Projekteve Prioritare															
MMN-5-1-1	Rekrutimi i Stafit të Sektorit të Projekteve															
MMN-5-1-2	Orientimi i Plan-Veprimeve të Planit të MIMN, Modifikimi dhe Finalizimi															
MMN-5-1-3	Pregatitja e Planit të Zbatimit të Projekteve Prioritare															
MMN-5-1-4	Buxhetimi për Zbatimin e Projekteve Prioritare															

Burimi: Ekipi Studimor i JICA-s

12.3.8. Fuqizimi i Monitorimit dhe Vlerësimit

(1) Objektivat e Projektit

Projekti synon forcimin e rolit të aktiviteteve dhe aftësive për raportimin, monitorimin dhe vlerësimin e saktë e të vijueshëm të aktiviteteve të MMN përmes grumbullimit dhe analizimit të të dhënave bazë, që lidhen me aktivitetet e MMN. Këtu përfshihen të dhënat për ndërgjegjësimin publik si dhe informacione të tilla, si niveli i të ardhurave, gatishmëria për të paguar, mendimet, ankesat dhe/ose kërkesat e prodhuesve të mbetjeve për BT. Sasia e prodhimit të mbetjeve dhe përbërja e tyre janë të rëndësishme për të mbledhur dhe analizuar karakteristikat e mbetjeve shtëpiake dhe tregtare, biznesit dhe mbetjet institucionale. Përveç kësaj, edhe sistemi i raportimit duhet të rregullohet për përgatitjen e raportit mujor dhe vjetor, që përshkruan rezultatet e aktiviteteve në muaj/vit së bashku me analizën e nivelit të arritjeve të aktiviteteve.

(2) Vendndodhja e Projektit ose Zona e Mbulimit

Projekti duhet të kryhet nga personeli i BT në ngarkim të shërbimeve të MMN, veçanërisht të anëtarëve të Ekipit Punues të Projekteve.

(3) Përbërësit e Projektit

1) Përbërësit e Projektit

Projekti përbëhet nga nënprojektet në vijim:

- MMN 5-5-1: Përgatitja e Raportit Mujor dhe Vjetor
- MMN 5-5-2: Ndërgjegjësimi Publik/Anketimet e Opinioneve për Aktivitetet e MMN
- MMN 5-5-3: Vrojtimi i Sasisë dhe Përbërjes së Mbetjeve Familjare
- MMN 5-5-4: Vrojtimi i Sasisë dhe Përbërjes së Mbetjeve Tregtare/Biznesit

Përmbajtjet e Programeve janë përshkruar nën seksionin 5.11, Plani i Zhvillimit të Kapaciteteve Institucionale, kurse përshkrimet shtesë janë në vijim:

2) Vrojtimi i Ndërgjegjësimi/Opinionit Publik

Task-Team i projektit në bashkëpunim me agjencitë përkatëse kryen anketimin e ndërgjegjësimit publik për prodhuesit e mbetjeve: familjare, tregtare, të biznesit dhe

institucionale. Pikat e anketës për prodhuesit e mbetjeve familjare nuk duhet të kufizohen. Anketa për prodhuesit e mbetjeve tregtare, biznesit dhe institucioneve do të kryhet me të njëjtat kërkesa si në anketën e prodhuesve të mbetjeve familjare. Vrojtimi i rritjes së vetëdijes/opinionit publik do të kryhet në bashkëpunim me vrojtimin e sasisë dhe përbërjes së mbetjeve të ngurta.

- Emri i pronarit të shtëpisë, emri i të intervistuarit, adresa dhe nr. i telefonit,
- Numri i anëtarëve të familjes dhe banorët,
- Lloji i shtëpisë dhe sipërfaqja e ndërtimit,
- Të ardhurat mujore e shpenzimet,
- Ankesat / Komentet për shërbimet e grumbullimit të mbetjeve, etj.
- Vullneti për të Paguar,

3) Rezultati i Vrojtimit të Sasisë dhe Përbërjes së Mbetjeve

Rezultati i vrojtimit duhet të përmbledhet sipas pikave të njëjta në analizën e përshkruar në Raportin e Vrojtimit të VSPMN, siç tregohet në vijim.

- Sasia e mbetjeve të prodhuara për familje, për frymë për grup të ardhurash dhe/ose për zonë të shërbimit të pastrimit për mbetjet familjare;
- Përbërja e mbetjeve për grup banorësh dhe/ose zonë të shërbimit të grumbullimit për mbetjet familjare;
- Sasia e prodhimit të mbetjeve për vend, për subjekt dhe/ose për m2 për mbetjet tregtare, biznesit dhe institucionale;
- Përqindja e materialit të ricikluar për grup të ardhurash, për zonë grumbullimi dhe për lloj subjekti;
- Përmbajtja e lagështirës, dendësia dhe llogaritja e vlerës së ulët kalorifike të mbetjeve për grup të ardhurash, për zonë grumbullimi dhe për lloj subjekti;
- Ndryshimet historike të karakteristikave të mbetjeve.

4) Programi kohor i Zbatimit të Projektit

Tabela 12.3.9 tregon programin kohor të zbatimit të Planit të Fuqizimit të Monitorimit dhe Vlerësimit. Detyrat, sipas programit, duhet të fillojnë menjëherë në 2013. Raportet mujore dhe ditore duhet të përgatiten vazhdimisht prej 2013. Gjithashtu, vrojtimet e para duhet të kryhen në gjysmën e dytë të 2013 dhe të paktën një herë në 5 vjet edhe sipas qëllimit të kërkuar.

Tabela 12.3.9 Programi kohor i Zbatimit të Fuqizimit të Monitorimit dhe Vlerësimit

Plan Veprimet		Periodha Emergjente dhe Afat-Shkurtër					Periodha Afat-Mesme					Periodha Afat-Gjatë				
		2013	2014	2015	2016	2017	2018	2019	2020	2021	2022	2023	2024	2025	2026	2027
MMN-5	Plani i Zhvillimit të Kapaciteteve Institucionale															
MMN-5-5	Vrojtimi i të Dhënave Bazë për Indikatorët e Performancës dhe Raportimin															
MMN-5-5-1	Përgatitja e Raportit Muor dhe Vjetor															
MMN-5-5-2	Ndërgjegjësimi Publik / Sondazhet e Opinioneve mbi Aktivitetet e MMN															
MMN-5-5-3	Vrojtimi i Sasisë dhe Përbërjes së Mbetjeve Familjare															
MMN-5-5-4	Vrojtimi i Sasisë dhe Përbërjes së Mbetjeve Tregtare/Biznesit															

Burimi: Ekipi Studimor i JICA-s

12.3.9. Fuqizimi Financiar

(1) Objektivat e Projektit

Projekti synon krijimin e një kapacitet financiar jetik të MMN përmes një sërë detyrash për uljen e kostos, alokimin e buxheti të mjaftueshëm, rritjen e mbulimit të tarifës së mbetjeve, vendosjen e një tarife mbetjesh të drejtë, praktikimin e një sistemi llogaritës transparent dhe të pavarur.

(2) Vendndodhja e Projektit dhe Zona e Mbulimit

Projekti duhet të zbatohet nga personeli që merret me menaxhimin financiar, Ekipin Punues të Projekteve, dhe personelin menaxherial të BT-së.

(3) Përbërësit e Projektit

1) Përbërësit e Projektit

Projekti përbëhet nga këto veprimtari kryesore:

- MMN 6-3-1: Hapja e Llogarisë Qëllimore të MMN
- MMN 6-3-2: Përgatitja dhe Ngritja e Sistemit të Tarifimit të drejtë të Mbetjeve
- MMN 6-3-3: Zbatimi dhe Hapja e Llogarisë Qëllimore të MMN

Përmbajtjet e programeve janë përshkruar në seksionin 5.12, Plani i Fuqizimit Financiar, kurse përshkrimet shtesë janë ofruar si në vijim.

2) Llogaria e Menaxhimit të Mbetjeve të Ngurta

Në mënyrë që të krijojë një sistem jetik dhe të përgjegjshëm financiar, llogaria e menaxhimit të mbetjeve të ngurta duhet të bëhet në bazë të veprimeve, duke përfshirë (por jo kufizuar), si vijon:

- Llogaritjen e kostos dhe analizës për grumbullimin e mbetjeve, trajtimin e ndërmjetëm, dhe aktivitetet e depozitimit të mbetjeve;
- Krijimin e një sistemi të njëjtë të llogarisë së biznesit duke përfshirë përgatitjen e bilancit, pasqyrën e rrjedhjes së parave, pasqyrën e fitimeve dhe humbjeve
- Bërjen publike të gjendjes financiare.

3) Programi kohor i Zbatimit të Projektit

Tabela 12.3.10 tregon programin kohor për zbatimin e Programit të Fuqizimit Financiar. Sipas programit kohor, Programet duhet të fillojnë menjëherë në 2013 dhe të zbatohen në vijimësi gjatë periudhës së masterplanit.

Tabela 12.3.10 Programi kohor i Zbatimit të Fuqizimit Financiar

Plan Veprimet		Periudha Emergjente dhe Afat-Shkurtër					Periudha Afat-Mesme					Periudha Afat-Gjatë				
		2013	2014	2015	2016	2017	2018	2019	2020	2021	2022	2023	2024	2025	2026	2027
MMN-6	Plani i Forcimit Financiar															
MMN-6-3	Zbatimi i Planit të Forcimit Financiar															
MMN-6-3-1	Përgatitja e Llogarisë së Veçantë të MMN															
MMN-6-3-2	Përgatitja dhe Ngritja e Sistemit të Tarifimit të duhur të Mbetjeve															
MMN-6-3-3	Zbatimi dhe Ngritja e Llogarisë së duhur të MMN															

Burimi: Ekipi Studimor i JICA-s

12.3.10. Programi i Rritjes së Ndërgjegjes së Publikut

(1) Objektivat e Projektit

Projekti synon rritjen e ndërgjegjësimit të publikut dhe të gjitha grupeve të interesit për të zbatuar aktivitete të frytshme të MMN, ruajtjen e mjedisit, krijimin e një shoqërie të shëndoshë orientuar te riciklimi i burimeve etj., që mund të arrihen me përmbushjen e përgjegjësi të çdo prodhuesi mbetjesh ose grupi interesi.

(2) Vendndodhja e Projektit dhe Zona e Mbulimit

Programet janë synuar të përpilohen nga prodhuesit e mbetjeve dhe palët e interesuar në zonën e BT, dhe informacioni për to do të shpërndahet në gjithë vendin.

(3) Përbërja e Projektit

1) Përbërja e Projektit

Projekti është i përbërë nga këto veprimtari:

- MMN 7-2-1: Zbatimi i Planit të Marrëdhënieve me Publikun
- MMN 7-2-2: Zbatimi i Planit të Edukimit në Shkolla
- MMN 7-2-3: Zbatimi i Planit të Zbatimit Joformal
- MMN 7-2-4: Zbatimi i Planit të Përfshirjes së Komunitetit

Përmbajtjet e Programeve janë përshkruar nën seksionin 5.13, Plan i Rritjes së Ndërgjegjes Publike, kurse përshkrimet shtesë janë ofruar si në vijim.

2) Përmbajtjet e Marrëdhënieve me Publikun

Përmbajtja e programit të marrëdhënieve me publikun do të përfshijë: (por nuk kufizohen)

- Përmbledhjen e Planit të MIMN të Bashkisë së Tiranës paraqit katër qasjet teknike dhe tri qasjet institucionale dhe financiare për të përballuar rritjen e mbetjeve bashkiake.
- Të kryejë si duhet menaxhimin e mbetjeve, uljen e tyre, ndarjen e tyre në burime shkarkimi e mbetjeve në kontejnerët e caktuar të mbetjeve, Kompostimit në shtëpi, në komunitet etj, nuk janë vetëm përgjegjësi e qeverive vendore dhe qeverisë qendrore, por edhe përgjegjësi e banorëve, dyqaneve tregtare, qendrave tregtare, restoranteve, hoteleve, kafeneve dhe bareve, shkollave, zyrave, dhe aktorëve të tjerë për të përmbushur rolin e tyre.
- Fushata e Informimit-Edukimit-Komunikimit (IEK) kryhet për pakësimin e prodhimit të mbetjeve, ndarjen në burim të materialeve të riciklueshme, metodën e shkarkimit të materialeve të riciklueshme dhe mbetjeve të fundme në sistemin me 3 kontejnerë, përdorimin e FRM në Qytet për materialet e riciklueshme, grumbullimin e ndarë, kompostimin në familje dhe komunitet, ripërdorimin, riparimin, riciklimin etj., për të përftuar planveprimet e Planit të MIMN të Bashkisë së Tiranës, me shpjegim të kuptimit të aktiviteteve si një shërbim publik.
- Menaxhimi i duhur i mbetjeve të ngurta përmes planveprimeve të propozuara mund të ulë sasinë e mbetjeve të grumbulluara dhe sasinë e mbetjeve në depozitimin përfundimtar.

- Prodhimi i mbetjeve është pasojë e jetës së përditshme të njerëzve dhe konsumit të burimeve natyrore të fundme. Popullarizimi i fjalës shpirtërore “Mendimi *Mottainai*” për të ruajtur gjithçka që përdoret do të sjellë një normë të re shoqërore, duke ndihmuar kështu në shëndoshjen e shoqërisë dhe të orientuar te riciklimi i burimeve (ShShOR) në Shqipëri, përmes aktiviteteve të MMN.
- Depozitimi i paligjshëm i mbetjeve shkakton kushte johigjienike në zonat përreth. Hedhja e mbetjeve shkakton ndotje të ujit dhe tokës në seksionet e poshtme të rrjedhës së lumenjve. Depozitimi i paligjshëm i mbetjeve në hapësirat e hapura dhe në rrjedhat e lumenjve, jo vetëm shkakton dëmtim të thellë mjedisor dhe kushte jo-higjienike, por gjithashtu nuk i nderon qytetarët dhe kryeqytetin e Shqipërisë.

3) Përmbajtja e Edukimit në Shkollë

Kurrikula për edukimin në shkollë ose edukimi formal kryesisht duhet të përfshijë këto çështje:

- Ndikimin e mbetjeve të hedhura në mjedis, shëndetin & higjienën publike;
- Statusin e aktiviteteve aktuale të MMN;
- Përshkrimin e planeve të veprimit dhe programet e Planit të MIMN të Bashkisë së Tiranës;
- Rolet dhe përgjegjësitë e banorëve dhe palëve të interesuara për zbatimin e Planit të MIMN të Bashkisë së Tiranës
- Diskutimet e shumta për bashkëpunimin e prodhuesve të mbetjeve në aktivitetet e MMN.
- Demonstrimet për pakësimin e mbetjeve dhe ndarjes së materialeve të riciklueshme në shkollë;
- Vizitat në terren për grumbullimin e mbetjeve, trajtimin e ndërmjetëm dhe depozitimin e tyre;
- Hartimin dhe shkrimin për MMN dhe përfshirjen e fëmijëve.

4) Elementët e Edukimit Publik

Për të filluar zbatimin e planit të edukimit publik ose edukimit jo-formal në vitin 2015, materialet e mëposhtme arsimore dhe programet, që lidhen me aktivitetet 3R do të përgatiten nga Ekipi Punues i Projekteve të mbështetur nga Ministria e linjës për institucionet e vartësisë. Edukimi i publikut do të përfshijë:

- Statusin e aktiviteteve të MMN;
- Përshkrimin e planveprimeve dhe programeve të Planit të MIMN të Bashkisë së Tiranës;
- Rolet dhe përgjegjësitë e secilit grup të prodhuesve të mbetjeve për të zbatuar kërkesat e përcaktuara në ligje, rregulla dhe rregullore;
- Vizitat në terren për grumbullimin e mbetjeve, trajtimin e ndërmjetëm dhe depozitimin e tyre;
- Projekti(et) pilot për demonstrimin e pakësimit të sasisë së mbetjeve, ndarjen e materialeve të riciklueshme në vendet e punës, dhe riciklimin;
- Vlerësimin e aktiviteteve të 3R nga çdo prodhues mbetjesh.

5) Përfshirja e Komunitetit

Plani i përfshirjes së komunitetit përfshin programe për t'u përshtatur me problemin e tanishëm të grumbullimit të mbetjeve, dhe gjykimin për aktivitete të reja, që kanë të bëjnë me mbledhjen e veçantë të mbetjeve dhe aktivitetet 3R që do të përfshijë, (por nuk kufizohet), për veprimtaritë e mëposhtme:

- Statusi i aktiviteteve të MMN;
- Përshkrimi i planveprimeve dhe programeve të Planit të MIMN të Bashkisë së Tiranës;
- Rolet dhe Përgjegjësitë e banorëve për të bashkëpunuar për planveprimet dhe programet që, do të zbatohen nga BT;
- Vizitat në terren për grumbullimin e mbetjeve, trajtimin e ndërmjetëm dhe depozitimin e mbetjeve;
- Projekte pilot për demonstrimin e pakësimit të sasisë së mbetjeve, ndarjen në burim të materialeve të riciklueshme dhe rikuperimin e materialeve të riciklueshme përmes sistemit me 3-kontejnerë dhe FRM në Qytet;
- Projekt pilot për demonstrimin e kompostimit në familje dhe komunitet;
- Takime periodike komunitare për të përballuar problemet e dala dhe përmirësimin e projekteve pilot.

(4) Programi kohor i Zbatimit të Projektit

Tabela 12.3.11 tregon programin kohor të zbatimit të Programeve të Rritjes së Ndërgjegjes së Publikut. Siç tregohet në tabelë, Programet për planin e marrëdhënieve me publikun duhet të fillojnë në 2013, ndërsa Programet e edukimit dhe përfshirjes së komunitetit duhet të fillojnë në fillimvitin 2014. Të gjitha programet duhet të fillojnë gjatë periudhës së zbatimit të masterplanit deri në vitin 2017.

Tabela 12.3.11 Programi kohor i Zbatimit të Programeve të Rritjes së Ndërgjegjes së Publikut

Plan Veprimet		Periudha Emergjente dhe Afat-Shkurtër					Periudha Afat-Mesme					Periudha Afat-Gjatë				
		2013	2014	2015	2016	2017	2018	2019	2020	2021	2022	2023	2024	2025	2026	2027
MMN-7	Plani i Rritjes së Ndërgjegjes Publike															
MMN-7-2	Zbatimi i Planit të Rritjes së Ndërgjegjes Publike															
MMN-7-2-1	Zbatimi i Planit të Marrëdhënieve me Publikun															
MMN-7-2-2	Zbatimi i Planit të Edukimit në Shkollë															
MMN-7-2-3	Zbatimi i Planit të Zbatimit Jo-Formal															
MMN-7-2-4	Zbatimi i Planit të Përfshirjes së Komunitetit															

Burimi: Ekipi Studimor i JICA-s

12.3.11. Kostoja e Projekteve Parësore

(1) Kostoja Vjetore


Figura 12.3.12 tregon koston vjetore të parashikuar për investimet, kostot e funksionimit dhe mirëmbajtjes të projekteve parësore përkatëse.

Tabela 12.3.12 Investimi Vjetor dhe Kostot F&M të Projekteve Parësore

Action Plans		Funding sources		Primary Implementing Body	Urgent and Short-term Period					Mid-term Period					Long-term Period				
		MOT	External/ Loan		2013	2014	2015	2016	2017	2018	2019	2020	2021	2022	2023	2024	2025	2026	2027
SWM-1	Waste Collection and Transportation Plan																		
SWM-1-3	Implementation of Illegal Dump Site Clean-up Project through Contract	150.0		Contract		50.0	50.0	50.0											
SWM-1-5	Operation of Separate Collection by 3-bins System	21,764.4		Contract	1,100.0	1,257.1	1,257.1	1,257.1	1,257.1	1,492.9	1,492.9	1,492.9	1,492.9	1,492.9	1,492.9	1,728.6	1,728.6	1,728.6	1,728.6
	Procurement of Waste Containers	995.0			110.0				242.0					291.5					291.5
SWM-2	Waste Minimization Plan (3R Plan)																		
SWM-2-2-5	Construction of Central Material Recovery Facilities at Sharra																		
	Civil Work		20.0	Contract			10.0	10.0											
	Building Work		34.6	Contract			17.3	17.3											
	Mechanical & Electrical Works		20.0	Contract				20.0											
	Engineering (Design 5% Supervision 5%)		7.5	Contract		2.5	2.5	2.5											
SWM-2-2-6	Operation of Central Material Recovery Facilities at Sharra																		
	Operation Cost (Personnel Cost)	112.2		Contract					10.2	10.2	10.2	10.2	10.2	10.2	10.2	10.2	10.2	10.2	10.2
	Operation Cost (Electricity & Water)	3.3		Contract					0.3	0.3	0.3	0.3	0.3	0.3	0.3	0.3	0.3	0.3	0.3
	Maintenance Cost	7.8		Contract					0.7	0.7	0.7	0.7	0.7	0.7	0.7	0.7	0.7	0.7	0.7
SWM-3	Intermediate Treatment Plan																		
SWM-3-2	Implementation of Organic Waste Treatment Plan																		
SWM-3-2-1	Organizing Home Composting and Community Composting Groups	MOT																	
SWM-3-2-2	Implementation of Pilot Project of Home and Community Composting	7.2		DWM/MOT	2.4	2.4	2.4												
SWM-3-2-3	Expansion of Home Composting and Community Composting	156.0		DWM/MOT			12.0	12.0	12.0	12.0	12.0	12.0	12.0	12.0	12.0	12.0	12.0	12.0	12.0
SWM-3-2-5	Construction of Pilot Scale Composting Facilities																		
	Civil Work		10.0	Contract	5.0	5.0													
	Building Work		2.8	Contract	1.4	1.4													
	Mechanical & Electrical Works		20.0	Contract		20.0													
	Engineering (Design 5% Supervision 5%)		3.2	Contract	1.6	1.6													
SWM-3-2-6	Operation and Maintenance of Pilot Scale Composting Facilities																		
	Operation Cost (Personnel Cost)	48.6		Contract	1.8	3.6	3.6	3.6	3.6	3.6	3.6	3.6	3.6	3.6	3.6	3.6	3.6	3.6	3.6
	Operation Cost (Water & Chemicals)	7.0		Contract	0.5	0.5	0.5	0.5	0.5	0.5	0.5	0.5	0.5	0.5	0.5	0.5	0.5	0.5	0.5
	Maintenance Cost	9.8		Contract	0.4	0.7	0.7	0.7	0.7	0.7	0.7	0.7	0.7	0.7	0.7	0.7	0.7	0.7	0.7
SWM-3-2-7	Construction of Central Biogasification and Composting Facilities																		
	Civil Work		400.0	Contract			100.0	100.0				100.0	100.0						
	Building Work		11.6	Contract			5.8	5.8				0.0	0.0						
	Mechanical & Electrical Works		6,000.0	Contract			1,000.0	2,000.0				1,000.0	2,000.0						
	Engineering (Design 5% Supervision 5%)		641.2	Contract			106.9	106.9				106.9	106.9						
SWM-3-2-8	Operation and Maintenance of Central Biogasification and Compost Plant																		
	Operation Cost (Personnel Cost)	144		Contract					10.3	10.3	10.3	10.3	10.3	15.4	15.4	15.4	15.4	15.4	15.4
	Operation Cost (Water & Chemicals)	658		Contract					38.7	38.7	38.7	38.7	38.7	77.4	77.4	77.4	77.4	77.4	77.4
	Maintenance Cost	1,565		Contract					92.1	92.1	92.1	92.1	92.1	184.1	184.1	184.1	184.1	184.1	184.1
SWM-3-4-2	Construction of Waste to Energy Plant																		
	Civil Work		2,500.0	Contract			1,000.0	1,000.0	500.0										
	Building Work		480.0	Contract				240.0	240.0										
	Mechanical & Electrical Works		12,600.0	Contract				6,300.0	6,300.0										
	Engineering (Design 5% Supervision 5%)		1,558.0	Contract			389.5	389.5	389.5										
SWM-3-4-3	Operation and Maintenance of Waste to Energy Plant																		
	Operation Cost (Personnel Cost)	149.4		Contract						16.6	16.6	16.6	16.6	16.6	16.6	16.6	16.6	16.6	16.6
	Operation Cost (Chemical)	36.4		Contract						39.6	39.6	39.6	39.6	39.6	39.6	39.6	39.6	39.6	39.6
	Operation Cost (Fuel)	270.0								30.0	30.0	30.0	30.0	30.0	30.0	30.0	30.0	30.0	30.0
	Operation Cost (Water)	7.2								0.8	0.8	0.8	0.8	0.8	0.8	0.8	0.8	0.8	0.8
	Maintenance Cost	3,670.2		Contract						407.8	407.8	407.8	407.8	407.8	407.8	407.8	407.8	407.8	407.8
SWM-4	Waste Disposal Plan																		
SWM-4-4	Implementation of Waste Disposal Project																		
SWM-4-4-1	Construction of Sanitary Landfill																		
	Civil Work		820.0	Contract			410.0	410.0											
	Building Work		0.0	Contract			0.0	0.0											
	Mechanical & Electrical Works		170.0	Contract				85.0											85.0
	Engineering (Design 5% Supervision 5%)		90.5	Contract		30.2	30.2	30.2											
SWM-4-4-2	Operation and Maintenance of Sanitary Landfill																		
	Operation Cost (Personnel Cost)	81.4		Contract					7.4	7.4	7.4	7.4	7.4	7.4	7.4	7.4	7.4	7.4	7.4
	Operation Cost (Fuel Cost)	253.0		Contract					23.0	23.0	23.0	23.0	23.0	23.0	23.0	23.0	23.0	23.0	23.0
	Operation Cost (Cover Soil)	39.8		Contract					4.9	4.6	4.4	4.1	3.8	3.6	3.3	3.0	2.8	2.8	2.5
	Maintenance Cost	146.3		Contract					13.3	13.3	13.3	13.3	13.3	13.3	13.3	13.3	13.3	13.3	13.3
SWM-4-4-3	Closure of Existing Landfill																		
	Civil Work		50.0	DWM/MOT					50.0										
	Total Cost	30,591.8	25,389.3		1,220.4	1,479.7	3,396.4	5,501.0	9,696.3	8,904.0	2,311.8	3,411.5	4,411.2	2,631.5	2,339.7	2,575.1	2,574.9	2,574.9	2,951.1
Summary-1	Summary of Priority Project Cost																		
SWM 1-3	Illegal Dump Site Clean-up Project	150.0	0.0	150.0	0.0	50.0	50.0	50.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0
SWM 1-5	Waste Collection and Transportation Service	22,699.4	0.0	22,699.4	1,210.0	1,257.1	1,257.1	1,257.1	1,499.1	1,257.1	1,492.9	1,492.9	1,492.9	1,784.4	1,492.9	1,728.6	1,728.6	1,728.6	2,020.1
SWM 2-2	Material Recovery Facilities at Sharra	123.3	82.1	205.4	0.0	2.5	29.8	49.8	11.2	11.2	11.2	11.2	11.2	11.2	11.2	11.2	11.2	11.2	11.2
SWM 3-2	Composting and Biogasification Project	2,595.4	7,088.8	9,684.2	10.4	139.9	1,231.9	2,229.5	157.9	157.9	264.7	1,364.7	2,364.7	293.7	293.7	293.7	293.7	293.7	293.7
SWM 3-4	Waste to Energy Project	4,453.2	17,136.0	21,591.2	0.0	0.0	389.5	1,389.5	7,929.5	7,429.5	494.8	494.8	494.8	494.8	494.8	494.8	494.8	494.8	494.8
SWM 4-4	Waste Disposal Facilities Expansion Project	570.5	1,080.5	1,651.0	0.0	30.2	440.2	525.2	98.6	48.3	48.1	47.8	47.5	47.3	47.0	46.7	46.5	46.5	131.2
Summary-2	Summary of Investment, Operation and Maintenance Cost																		
	Investment Cost	23,062.6	23,179.5	46,242.1	1,218.8	1,335.9	2,864.6	4,967.2	9,101.1	8,309.1	1,504.9	2,604.9	3,604.9	1,796.4	1,504.9	1,740.6	1,740.6	1,740.6	2,117.1
	Engineering Cost	0.0	2,209.8	2,209.8	1.6	110.9	498.8	498.8	389.5	389.5	106.9	106.9	106.9	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0
	Operation Cost	2,130.1	0.0	2,130.1	0.0	2.3	4.1	4.1	98.9	98.6	185.4	184.8	228.4	228.1	227.8	227.8	227.8	227.8	227.3
	Maintenance Cost	5,399.1	0.0	5,399.1	0.0	0.4	0.7	0.7	106.8	106.8	514.6	514.6	514.6	606.7	606.7	606.7	606.7	606.7	606.7
	Total	30,591.8	25,389.3	55,981.1	1,220.4	1,479.7	3,396.4	5,501.0	9,696.3	8,904.0	2,311.8	3,411.5	4,411.2	2,631.5	2,339.7	2,575.1	2,574.9	2,574.9	2,951.1
Summary-3	Summary of Waste Collection, Intermediate Treatment and Waste Disposal Cost																		
	Waste Collection and Transportation Cost	22,849.4	0.0	22,849.4	1,210.0	1,307.1	1,307.1	1,307.1	1,499.1	1,257.1	1,492.9	1,492.9	1,492.9	1,784.4	1,492.9	1,728.6	1,728.6	1,728.6	2,020.1
	3R & Intermediate Treatment Cost	7,171.9	24,309.8	31,480.7	10.4	142.4	1,651.2	3,668.8	8,098.6	7,598.6	770.8	1,870.8	2,870.8	799.9	799.9	799.9	799.9	799.9	799.9
	Waste Disposal Cost	570.5	1,080.5	1,651.0	0.0	30.2	440.2	525.2	98.6	48.3	48.1	47.8	47.5	47.3	47.0	46.7	46.5	46.5	131.2
	Total	30,591.8	25,389.3	55,981.1	1,220.4	1,479.7	3,396.4	5,501.0	9,696.3	8,904.0	2,311.8	3,411.5	4,411.2	2,631.5	2,339.7	2,575.1	2,574.9	2,574.9	2,951.1

Burimi: Ekipi Studimor i JICA-s

Kostoja gjithsej e Projekteve Parësore është vlerësuar për periudhën 2013-2017 në 55,981 milionë lekë. Burimet e financimit të treguara në tabelë janë përcaktuar nga Ekipi Studimor i JICA-s për referencë. Kostoja e tokës dhe kostoja e administrimit të BT nuk janë të përfshira në vlerësimet e koston. Kostot vjetore për shkak të periudhës së pikut të punës ndërtimore luhaten nga 1,220 milionë lekë në vitin 2013, në 9,700 milionë lekë në 2017. Në mesatare, kostoja është vlerësuar në 3,730 milionë lekë në vit. Figura 12.3.14 tregon prirjen e Kostos Vjetore për Planin e MIMN.



Burimi: Ekipi Studimor i JICA-s

Figure 12.3.14 Pirja e Kostos Vjetore për Zbatimin e Planit të MIMN

(2) Përmbledhje e Kostos së Projekteve Parësore

Tabela 12.3.13 tregon koston gjithsej të Projekteve Parësore të derivuara nga Përmbledhja-1 Tabela 12.3.12. Kostoja gjithsej e shërbimit të grumbullimit dhe transportimit të mbetjeve është vlerësuar si kostoja më e lartë në 22,700 milionë lekë, pra 41%, e ndjekur nga kostoja e projektit të mbetjeve për energji me 21,600 milionë lekë, pra 39%, të koston së përgjithshme të menaxhimit të mbetjeve. Shuma e këtyre kostove të projekteve zënë 80% të koston së përgjithshme. Kostoja e kompostimit dhe biogazifikimit është vlerësuar në 9,700 milionë lekë, pra rreth 17% të koston së përgjithshme. Kostoja e depozitimit të mbetjeve është vlerësuar në 1,700 milionë lekë dhe zë vetëm 3% të koston së përgjithshme.

Tabela 12.3.13 Përmbledhje e Kostove të Projekteve Parësore

Përmbledhje-1 : Përmbledhje e Koston së Projekteve Parësore (M. lekë)		BT	Burime të Jashtme	Shuma	Përqindja (%)
MMN 1-3	Projekti për pastrimin e venddepozitimeve të paligjshme të mbetjeve	150,0	0,0	150,0	0,3
MMN 1-5	Shërbimet e grumbullimit dhe transportimit të ndarë të mbetjeve	22 699,4	0,0	22 699,4	40,5
MMN 2-2	Implantet e rikuperimit të materialeve	123,3	82,1	205,4	0,4
MMN 3-2	Implantet e kompostimit dhe biogazifikimit	2 595,4	7 088,8	9 684,2	17,3
MMN 3-4	Implantet e mbetjeve për energji	4 453,2	17 138,0	21 591,2	38,6
MMN 4-4	Zgjerimi i impianteve të depozitimit	570,5	1 080,5	1 651,0	2,9
Gjithsej		30,591,8	25 389,3	55 981,1	100,0

Burimi: Ekipi Studimor i JICA-s

(3) Investimet, Kostot e Funkcionimit dhe Mirëmbajtjes

Tabela 12.3.14 tregon koston gjithsej të investimeve, punimeve inxhinierike, funksionimin dhe mirëmbajtjen për Projektet parësore, derivuar nga Përmbledhje-2 në Tabelën 12.3.12. Kostoja e investimit të përgjithshëm arrin 46 240 milionë lekë për periudhën 2013-2027 dhe zë 83% të koston gjithsej, ndjekur nga kostoja e mirëmbajtjes e vlerësuar në 5 400 milionë lekë dhe zë më pak se 10%. Kostoja e funksionimit dhe inxhinierike janë pothuajse në të njëjtën sasi, që do të thotë në nivelin e 2 130-2 210 milionë lekë, duke llogaritur përafërsisht 4%.

Tabela 12.3.14 Investimet, Kostot e Funkcionimit dhe të Mirëmbajtjes

Përmbledhje-2: Përmbledhje e investimeve, koston e Operimit dhe Mirëmbajtjes: (M. Lek)	BT	Burime të Jashtme	Shuma	Përqindja (%)
Kostoja e Investimit	23 062,6	23 179,5	46 242,1	82,6
Kostoja Inxhinierike	0,0	2 209,8	2 209,8	3,9
Kostoja Operative	2 130,1	0,0	2 130,1	3,9
Kostoja e Mirëmbajtjes	5 399,1	0,0	5 399,1	9,6
Gjithsej	30 591,8	25 389,3	55 981,1	100,0

Burimi: Ekipi Studimor i JICA-s

(4) Kostot e Grumbullimit të Mbetjeve, Trajtimit të Ndërmjetëm dhe Depozitimit të Mbetjeve

Tabela 12.3.15 tregon ndarjen e koston për shërbimet e grumbullimit dhe transportimit, trajtimit të ndërmjetëm përfshirë aktivitetet 3R, dhe depozitimin e mbetjeve të derivuara nga Përmbledhja-3 në Tabelën 12.3.12. Kostoja e përgjithshme e trajtimit të ndërmjetëm dhe aktiviteteve 3R është vlerësuar 31 480 milion Lek për periudhën 2013-2027 dhe llogaritet 56% e koston gjithsej, ndjekur nga kostoja e grumbullimit dhe transportimit të mbetjeve vlerësuar 22 850 milionë lekë dhe llogaritet 41%. Kostoja gjithsej e depozitimit të mbetjeve është vlerësuar 1 700 milionë lekë dhe llogaritet përafërsisht 4%, siç përmendet më herët në nënseksionet e mëparshme.

Tabela 12.3.15 Kostot për Njësi të Shërbimeve Përkatese

Përmbledhje -3: Përmbledhje e Koston së Grumbullimit të Mbetjeve, Trajtimit të Ndërmjetëm dhe Depozitimit të Mbetjeve (M. Lek)	BT	Burime të Jashtme	Totali	Përqindja (%)
Kostoja e grumbullimit dhe transportimit të mbetjeve	22,849.4	0.0	22,849.4	40.8
Kostoja e trajtimit të ndërmjetëm & aktiviteteve 3R	7,171.9	24,308.8	31,480.7	56.3
Kostoja e depozitimit të mbetjeve	570.5	1,080.5	1,651.0	2.9
Gjithsej	30,591.8	25,389.3	55,981.1	100.0

Burimi: Ekipi Studimor i JICA-s

(5) Kostoja Njësi e Menaxhimit të Integruar të Mbetjeve

Tabela 12.3.16 tregon koston njësi të vlerësuar për aktivitetet e ndryshme të grumbullimit dhe transportimit të mbetjeve, trajtimit të ndërmjetëm, aktivitetet 3R dhe depozitimin e mbetjeve. Kostot për njësi janë përfutur nga ndarja e koston totale nga sasia e akumuluar e mbetjeve të marrë nga secili aktivitet. Siç tregohet në tabelë, kostot për njësi të grumbullimit të mbetjeve, trajtimit të ndërmjetëm dhe depozitimit të mbetjeve janë vlerësuar respektivisht në 4 300 lekë/ton, 17,500 lekë/ton dhe 800 lekë/ton. Dhe kostoja për njësi mesatare për të gjithë

aktivitetet është vlerësuar në 10 600 lekë/ton. Kostoja për njësi e trajtimit të ndërmjetëm është e lartë, edhe pse kostoja është vlerësuar në nivel të moderuar në krahasim me koston e praktikuar në vendet e zhvilluara.

Tabela 12.3.16 Kostot për Njësi për Shërbimet Përkatëse

Emërtimi	Kostoja gjithsej (M. lekë)	Sasia vjetore e mbetjeve (M. ton)	Kostoja për Njësi (lekë/ton)
Kostoja e grumbullimit dhe transportimit të mbetjeve	22 849	5,3	4 300
Kostoja e trajtimit të ndërmjetëm & aktiviteteve 3R	31 481	1,8	17 500
Kostoja e depozitimit të mbetjeve	1 651	2,1	800
Gjithsej/Mesatare	55 981	5,3	10 600

Burimi: Ekipi Studimor i JICA-s

12.3.12. Agjencia e Zbatimit

Agjencia e zbatimit dhe organizmat e tjera janë propozuar për projektin përkatës ose programin, siç tregohet në Tabelën 12.3.17. Ekipi i Punës për Projektet i propozuar për t'u organizuar në Drejtorinë e Menaxhimit të Mbetjeve, duhet të marrë nismën për zbatimin e të gjitha Projekteve Parësore. Puna për projektet e ndërtimit mund të kryhet nga njësia e menaxhimit të projektit ad hoc (s) për t'u organizuar sapo projekti i ndërtimit të fillojë. Organizatat e listuar në shtyllën e Organizatave Përkatëse janë për organizatat, që kërkohen të marrin miratimin, lejen apo koordinimin, funksionimin dhe mirëmbajtjen e sistemit/impianitit.

Tabela 12.3.17 Agjencia e Zbatimit dhe Organizatat Përkatëse

Kodi	Titulli i Projektit	Agjencia e Zbatimit	Organizatave Përkatëse
MMN 1-3	Projekti për Pastrimin e Venddepozitimeve të paligjshme të Mbetjeve	Drejtoria e Menaxhimit të Mbetjeve, BT	Ofrues(it) e Shërbimit të Grumbullimit të Mbetjeve ose Ndërmarrja e Menaxhimit të Mbetjeve e BT ose Kontraktori i Punës së Pastrimit.
MMN 1-5	Shërbimet e Grumbullimit dhe Transportimit të Ndarë të Mbetjeve	Drejtoria e Menaxhimit të Mbetjeve, BT	Ofrues(it) e Shërbimit të Grumbullimit të Mbetjeve ose Ndërmarrja e Menaxhimit të Mbetjeve e BT, Industria e Riciklimit, Minibashkitë
MMN 2-2	Paraqitja e Programeve të 3R-ve	Drejtoria e Menaxhimit të Mbetjeve, BT	Ofrues(it) e Shërbimit të Grumbullimit të Mbetjeve ose Ndërmarrja e Menaxhimit të Mbetjeve e BT, Industria e Riciklimit, Grupet e Komunitetit, Minibashkitë, Ministria e Mjedisit Pyjeve dhe Administrimit të Ujrave - MMPAU (VNM), Komuna Vaqarr (Leja e Ndërtimit)
MMN 3-2	Projekti i Trajtimit të Mbetjeve Organike	Drejtoria e Menaxhimit të Mbetjeve, BT	Kontraktorët e Punimeve të Ndërtimit dhe për Funksionimin& Mirëmbajtjen, Ndërmarrja e Menaxhimit të Mbetjeve e BT, MMPAU (VNM), Komuna Vaqarr (Leja e Ndërtimit)
MMN 3-4	Projekti i kthimit të Mbetjeve në Energji	Drejtoria e Menaxhimit të Mbetjeve, BT	Kontraktorët e Punimeve të Ndërtimit dhe për Funksionimin& Mirëmbajtjen, MMPAU (VNM), Komuna Vaqarr (Leja e Ndërtimit)
MMN 4-4	Projekti i Zgjerimit të Strukturave të Depozitimit të Mbetjeve	Drejtoria e Menaxhimit të Mbetjeve, BT	Kontraktorët e Punimeve të Ndërtimit dhe për Funksionimin& Mirëmbajtjen, MMPAU (VNM), Komuna Vaqarr (Leja e Ndërtimit)
MMN 5-1	Fuqizimi Organizativ	Drejtoria e Menaxhimit të Mbetjeve, BT	Këshilli i BT, Ministria e Brendshme – Drejtoria e Pushtetit Vendor
MMN 5-5	Fuqizimi i Monitorimit dhe Vlerësimit	Drejtoria e Menaxhimit të Mbetjeve, BT	Minibashkitë, BT
MMN 6-3	Fuqizimi Financiar	Drejtoria e Planifikimit Strategjik, Drejtoria e Menaxhimit të Mbetjeve, BT	Ministria e Financës, Ministria e Punëve Publike dhe Transportit
MMN 7-2	Programet e Rritjes së Ndërgjegjes së Publikut	Drejtoria e Menaxhimit të Mbetjeve, BT	Minibashkitë, MMPAU, Ministria e Arsimit dhe Shkencës(MASH)

Burimi: Ekipi Studimor i JICA-s

12.4 Analiza Financiare dhe Ekonomike

12.4.1. Analiza Financiare

Në këtë seksion është kryer një analizë financiare për landfillin sanitar të ri, me impiantet e kompostimit/djegësit të mbetjeve/impiantit të prodhimit të energjisë duke krahasuar kostot financiare dhe të ardhurat e projektit. Është përgatitur një përshkrim i rrjedhës së parave (cashflow) bazuar në supozimet e mëposhtme dhe është llogaritur për vlerësim Norma e Brendshme e Kthimit Financiar (NBKF) të Projektit.

(1) Supozimet Bazë

Supozimet themelore në vijim janë përdorur për analizën financiare, e cila gjithashtu zbatohet për analizat ekonomike, vetëm nëse përcaktohet ndryshe.

1) Rasti i Projektit

Landfilli i ri sanitar do të ndërtohet në 2016 për të filluar funksionimin në 2017. Impiantet e landfillit do të zgjerohen në 2026.

Do të ndërtohen impiantet e kompostimit dhe të djegies së mbetjeve si dhe impianti i prodhimit të energjisë, shitja e kompostit e energjisë do të nisnin respektivisht në 2017 dhe 2019.

2) Periudha e Vlerësimit të Projektit

Jetëgjatësia e projektit është 34 vite nga 2013 në 2046, duke përfshirë periudhën e ndërtimit nga 2013-2018 dhe periudhën e vlerësimit të 2017-2046.

3) Baza e Çmimit dhe Kursi i Ndërrimit

Viti bazë i projektit është 2012. Të gjitha kostot dhe të ardhurat janë shprehur në nivelin e çmimit të 2012. Studimi parashikon 3,0% normën vjetore të inflacionit gjatë jetës së projektit, e cila është shkalla e inflacionit objektiv përcaktuar nga Banka e Shqipërisë për vitin 2012.

Kurset e ndërrimit janë $1 \text{ lek} = \text{JPY} = 0,788 \text{ Euro}$ $0,007 = 0,009 \text{ USD}$, të cilat janë normat mbizotëruese në kohën e anketimit.

4) Të paparashikuarat

Të paparashikuarat fizike prej 10% janë përfshirë në analizën financiare. Paparashikimi në çmim nuk është i pritshëm.

5) Taksat

Për analizën financiare, janë përfshirë Taksa mbi Vlerën e Shtuar (TVSH) prej 20% dhe tarifatat doganore përkatëse, ndërkohë taksa e korporatave është përjashtuar.

6) Norma e Brendshme e Kthimit Financiar të Synuar (NBKF)

NBKF e synuar luhet në varësi të ndarjes së investimit midis investitorëve të ndryshëm, me norma kthimi të pritshme, të ndryshme për projekt.

Supozohet se investitorët privatë, vendor ose të huaj, do të kenë nevojë për kredi bankare për të financuar projektin. Normat e kreditimit afatgjatë të korporatave që mbizotërojnë në bankat e Shqipërisë janë rreth 13,0%, në kohën e studimit. Norma e vërtetë e interesit është llogaritur 3,0% për 2012 ($1,13/1,03(\text{norma e inflacionit}) - 1 = 0,097$). NBKF e synuar e

investitorëve privatë vendor është caktuar në 13,5% në varësi të kostos së kredisë administrative, fitimeve dhe rreziqeve.

Ndërkohë, norma e synuar e investitorëve të huaj duhet të jetë më e ulët. Investitorët japonezë, për shembull, mund të kenë akses në kredi me një normë interesi prej 1,55% apo më shumë. Kështu, norma e synuar e investitorëve të huaj është supozuar në 7% në varësi me kostot e kredisë administrative, fitimeve dhe rreziqeve.

Meqë për BT, NBKF e synuar është caktuar në 0%. Kjo do të thotë se, BT do të marrë të ardhura, të cilat janë vetëm, sa për të mbuluar kostot e investimit.

Studimi supozon pjesën e investimit të BT në një shifër më të ulët se 10% përse kohë është për tu kompensuar tarifa e pambledhur. Ndarja midis investitorëve privatë të huaj dhe vendor është vendosur në 80% dhe 20%, bazuar në ndarjen e sasisë së investimit të huaj dhe atij vendor të projektit. Bazuar në këtë ndarje investimi, pesha mesatare e NBKF së synuar do të jetë 7,5%.

Tabela 12.3.18 NBKF e synuar sipas Investitorëve

Investitorët privatë vendorë	13,5%
Investitorët privatë të Huaj	7,0%
BT	0,0%
Bashkëinvestim (BT 10%, Investitorë të Huaj 72% dhe Privatë vendorë 18%)	7,5%

Burimi: Ekipi Studimor i JICA-s

(2) Kostot Financiare të Projekti

Kostot financiare të projektit përfshijnë shpenzimet për investime dhe kostot për funksionimin dhe mirëmbajtjen (F&M).

1) Kostot e Investimit

Kostot e investimeve financiare të projekteve janë llogaritur bazuar në kostot gjithsej të investimeve inxhinierike siç paraqiten në seksionet e mëparshëm.

Kostot Fillestare të Investimit

Tabela 12.3.19 Kostot Fillestare të Investimit (milionë lekë)

Toka	1,449
Punimet Civile	2,967
Ndërtesa	443
Makineritë dhe Pajisjet	71
Kapaciteti i Ndërtimit	13,252
Gjithsej	18,182
Shërbimi i Konsulencës (10%)	1,673
TVSH (20%)	3,681
Kostoja Bazë	23,536
Të paparashikuarat (10%)	2,354
Kostoja gjithsej e Investimit Financiar	25,889

*Kostoja e tokës nuk përfshin TVSH ose shërbimet konsultative.

Burimi: Ekipi Studimor i JICA-s

Kostot e Investimit për Zëvendësimet

Kostot e investimit për zëvendësimet, nëse janë të nevojshme, janë të përfshira në vitet përkatëse bazuar në jetëgjatësinë e aseteve, siç tregohet në tabelë:

Tabela 12.3.20 Jetëgjatësia e Pritshme e Aseteve me Kosto Investimi për Zëvendësim

Punimet Civile	50 vjet
Ndërtesat	40 vjet
Makineritë dhe Pajisjet	20 vjet
Makineritë	10 vjet

Burimi: Ekipi Studimor i JICA-s

Vlera e shpëtuar e pasurisë neto është shpërfillur në analizë.

2) Kostot Operative

Kostot financiare të operimit janë treguar në tabelë e janë llogaritur si në seksionet e mëparshme.

Tabela 12.3.21 Kostot Vjetore të Funksionimit & Mirëmbajtjes në 2028-2046

(milionë lekë)

Personeli	43,0
Shërbimet & Dheu Mbulues	8,8
Karburanti	167,4
Mirëmbajtja	603,4
Grumbullimi i Mbetjeve, Ndërmarrja e BT & Stafi i Drejtorisë së MM	1 892,3
Shuma	2 714,9

Burimi: Ekipi Studimor i JICA-s

(3) Të Ardhurat Financiare të Projektit

1) Prodhimi i Mbetjeve

Prodhimi i mbetjeve është vlerësuar të ulet me 10% me zbatimin e projektit.

Tabela 12.3.22 Tabela e Prodhimit të Mbetjeve (ton)

	2017	2022	2027-2046
Familjet	87 679	99 825	115 836
Spektori i Biznesit	169 287	192 737	223 652
Hapësirat Publike (parqet, lagjet, etj.)	14 276	16 253	18 860
Të sjella drejtpërdrejt në Landfill	14 276	16 253	18 860
Prodhimi i përgjithshëm i Mbetjeve	285 518	325 069	377 209

Burimi: Ekipi Studimor i JICA-s

2) Grumbullimi i Mbetjeve

Të gjitha mbetjet e prodhuara do të grumbullohen dhe depozitohen nga projekti.

3) Tarifat e Mbetjes

Tarifa e sotme e mbetjeve për familje është 5000 lekë në vit, pavarësisht vëllimit të mbetjeve. Tarifa për përdoruesit e tjerë luhet, në varësi të grupit të industrisë dhe llojit të biznesit.

Për analizën bazë, tarifat bazë janë vlerësuar të qëndrojnë në shifrën e pandryshuar të inflacionit, përmes periudhës së projektit, vetëm nëse shpjegohet ndryshe.

4) Norma e Mbledhjes së Tarifës

Në janar 2012, UKT-ja filloi mbledhjen e tarifës së mbetjeve nga familjet, në zonën e tij të shërbimit me një normë komisioni prej 5% për BT. Tabela në vijim tregon përqindjen e grumbullimit për familjet e mbuluara me shërbimin e ujësjellës/kanalizimeve nga UKT-ja.

Tabela 12.3.23 Përqindja e Grumbullimit të Tarifës së Mbetjeve nga Familjet në 2012

Muaji/2012	UKT dhe Përdoruesit (Përafërsisht 125,000 Familje)				Përdoruesit e Përgjithshëm të Grumbullimit të Mbetjeve (185,000 Familje*)
	Paguar Familjet	Pa-Paguar Familje	Familjet gjithsej	Përqindja e Grumbullimit	Përqindja e Grumbullimit
Janar	94,274	31,651	125,925	74.9%	51.0%
Shkurt	90,920	33,951	124,871	72.8%	49.1%
Mars	78,107	40,535	118,642	65.8%	42.2%

Burimi: BT dhe Ekipi Studimor i JICA-s

Edhe pse norma e grumbullimit për familjet brenda zonës së mbulimit me shërbim të UKT-së është përafërsisht 70%, shifra mesatare e përqindjes së grumbullimit, përfshirë familjet jashtë zonës së shërbimit nga UKT-ja, është vetëm 50%.

Analiza financiare vlerëson përqindjen e grumbullimit në 50% gjatë gjithë periudhës së projektit dhe supozon se sasia e pagrumbulluar do të kompensohet nga BT (ose organizata e zbatimit). Kjo për shkak të përdoruesit, që paguajnë nuk janë në gjendje të paguajnë para shtesë për të kompensuar për humbjet e shkaktuara nga përdoruesit që nuk paguajnë. Ajo, gjithashtu, duhet të japë një nxitje për BT, për të përmirësuar përqindjen e grumbullimit.

5) Të Ardhurat nga Grumbullimi dhe Depozitimi i Mbetjeve

Tabela në vijim tregon parashikimin e hyrjeve për 12 muajt e 2012, bërë në bazë të gjysmës së parë të vitit 2012.

Tabela 12.3.24 Të Ardhurat nga Tarifa e Mbetjeve për 2012 (Lekë)

Kategoria e Përdoruesve	2010	2011	2012 (Familjet deri në 30 qershor, Bizneset deri në 20 korrik)	2012 Vlerësimi
Familjet	68 837 625	49 004 088	173 560 582	364 477 222
Bizneset	401 670 213	397 815 444	400 000 000	450 000 000
Restorantet	19 302 026	18 579 775		
Gjithsej	489 809 864	465 399 307	573 560 582	814 477 222

Burimi: BT dhe Ekipi Studimor i JICA-s

Të ardhurat nga tarifa e mbetjeve nga 2013 e tutje është parashikuar në linjë me rritjen e popullsisë të kryer nga Ekipi Studimor i JICA-s

6) Të Ardhura të Tjera

Supozohet se projekti do të prodhojë energji dhe kompost, të cilat priten të shiten në treg. Të ardhurat nga shitja e energjisë dhe kompostit janë pasqyruar në tabelën më poshtë, me supozimet e përdorura.

Tabela 12.3.25 të Ardhurat nga Shitjet e Energjisë dhe Kompostit (milionë lekë)

	2017	2019	2022-2046*
Komposti	38	38	74
Energjia Elektrike	0	55	504

*2024-2046 në rastin e kompostit

Burimi: Ekipi Studimor i JICA-s

Tabela 12.3.26 Supozimet për Çmimin e Shitjes së Energjisë dhe Kompostit

	Energjia	Komposti
Sasia e gjenerimit/prodhimit	6,0 Megawatt	102 tonë për ditë
Ditët e punës së funksionimit në vit	330 ditë	–
Rendimenti	-	50%
Çmimi për njësi i shitjes (pa TVSH)	10,6 lekë/kWh	6,9 lekë/kg

Burimi: Ekipi Studimor i JICA-s dhe KESH

(4) Vlerësimi Financiar

1) Rezultati i NBKF

Në bazë të supozimeve të mësipërme një rrjedhë financiare e parave (cashflow) dhe projekti NBKF është llogaritur siç tregohet në tabelën në vijim.

NBKF është negative me tarifën e tanishme prej 417 lekë (Rasti 1). Nuk është e mundur të ftohen investitorët të huaj për projektin, me tarifën e sotme. Gjithsesi, do të përmirësohet me 7,5% (=NBKF e synuar për investitorët përfshirë BT dhe investitorët privatë të huaj/vendorë) nëse tarifa mujore e familjeve është rritur në 951 lekë në Rastin 2.

Tarifat për lloje të tjera përdoruesish janë vlerësuar të rriten me të njëjtën përqindje si ajo e familjeve, duke supozuar se struktura e tarifës aktuale midis gjithë përdoruesve (familjet, subjektet private, institucionet publike) të jetë mjaftueshëm njësoj/e barabartë.

Tabela 12.3.27 NBKF e Përmbledhur e Projektit

	Kostoja e Investimit Gjithsej (MN Lek)				Buxheti i BT për të mbuluar të ardhurat nga tarifat e pagrumbulluara (2017-2046)	Tarifa Mujore e Familjeve (lekë) në 2017	NBKF e synuar për investitorët	NBKF e Projektit (Për Investitorët)
	Gjithsej	BT	Investitorët e Huaj	Investitorët Vendorë				
Rasti 1 (tarifa sot)	25,889	25,889			22,833	417	0%	Deficit
Rasti 2 (tarifë rentabël)	25,889	2,589	18,640	4,660	52,060	951	7.5%	7.5%

Burimi: Ekipi Studimor i JICA-s

Si përfundim, projekti do të jetë fizibël me rritjen e tarifës në Rastin 2. Gjithsesi, është shumë e rëndësishme, nëse BT përmirëson normën e grumbullimit të mbetjeve familjare, pasi në të kundërt ajo duhet të akordojë një sasi të madhe të buxhetit për të kompesuar humbjet.

Rrjedha financiare e parave (cashflow) e projektit nën Rastin 2 të skenarit tregohet si Shtojca 6.

12.1.4 Analiza Ekonomike

Analiza ekonomike e projekteve të menaxhimit të mbetjeve kryhet në seksionet e mëposhtme.

(1) Supozimet për Analizën Ekonomike

Veç supozimeve bazë të përmendura më sipër për analizën financiare, janë përdorur edhe këto supozime.

1) Rregullime për Kostot dhe Përfitimet Financiare

Në parim, kostot dhe përfitimet ekonomike nuk përfshijnë shtrembërimet fiskale si taksat, dhe subvencionet. Kostot e tanishme të projektit dhe përfitimet përjashtojnë Taksën mbi Vlerën e Shtuar (TVSH) prej 20% dhe taksat doganore dhe tarifa të tjera shtetërore si ajo mbi karburantin (66,6%)

2) Norma e Brendshme e Kthimit Ekonomik të synuar (NBKE)

EIRR është një indeks efikasiteti për përdorimin e kapitalit të pakët, duke treguar përqindjen mesatare të kthimit, që mund të pritët çdo vit për ekonominë kombëtare përmes investimeve të planifikuara. Institucionet financiare ndërkombëtare, si Banka Botërore dhe Banka Aziatike e Zhvillimit zbatojnë 10% në 12% normë zbritje sociale në vendet në zhvillim.

Projekti vendos NBKE të synuar në 10%. Kjo nënkupton se, nëse NBKE e projektit është më e madhe se 10%, projekti do të sjellë përfitime neto në ekonominë rajonale, ose është ekonomikisht fizibël.

3) Gatishmëria për të Paguar si Përfitime Ekonomike

Gatishmëria për të Paguar (GPP)

Gatishmëria për të Paguar (GPP) është një masë prokure me një vlerë ekonomike të shprehur si “suficit konsumatorësh” dhe si rrjedhim, është sasia e përfituesve, që janë të gatshëm të paguajnë në këmbim të produktit ose shërbimeve që marrin. Koncepti i GPP është gjerësisht i përdorur si një shprehje numerike e përfitimeve ekonomike në vlerësimin e projekteve. Nëse çmimi, ose tarifa në këtë rast, është vendosur më e lartë se GPP, përdoruesit nuk do të marrin shërbimin dhe mund të përdorin paratë për produkte ose shërbime të tjera. Për këtë arsye, GPP quhet si kënaqësia më e madhe që përdoruesit mund të përfitojnë në forma të ndryshme nga projektet në fjalë. Prandaj, metodologjia “Gatishmëria Për të Paguar” është përdorur për të llogaritur përfitimet ekonomike të projektit të tanishëm.

Banka Botërore dhe Banka Aziatike e Zhvillimit e kanë si pikë referimi në aspektin e përqindjes së të ardhurave si dhe për sa përdoruesit janë të gatshëm të paguajnë për shërbimet e infrastrukturës. Sipas tyre, GPP për depozitimin e mbetjeve të ngurta është 2% e të ardhurave të zotërueshme të përdoruesve. Supozohet, se 2,0% e të ardhurave të zotërueshme të familjeve (60 000 lekë në muaj në vitin 2012) është shuma e GPP së përdoruesve familjarë të projektit.

Sasia GPP e përdoruesve të tjerë nga familjet janë vlerësuar të jenë në linjë me atë të familjeve.

Të Ardhurat e Zotërueshme

Të ardhurat mesatare familjare të Prefekturës së Tiranës janë marrë nga Vrojtimi i të Ardhurave Mujore sipas Prefekturave 2006-2007 (Instituti i Statistikave, Shqipëri). Sasia rregullohet për inflacionin dhe taksën e të ardhurave dhe është llogaritur të jetë 60 000 lekë për muaj në 2012.

(2) Vlerësimi Ekonomik

NBKE e projektit është llogaritur bazuar në supozimet e mësipërme dhe është përmbledhur në tabelën në vijim.

NBKE i projektit është 26.3%, më e lartë se norma e synuar prej 10%. Për këtë arsye mund të thuhet se projekti do të jetë ekonomikisht i realizueshëm.

Deklarata ekonomike cashflow e projektit është treguar si Shtojca 7.

Tabela 12.3.28 Përmbledhja e NBKE së Projektit

	Gatishmëria Për të Paguar si Përfitimet Ekonomike (2% e të ardhurave të zotërueshme; 1,290 lekë në 2017)
NBKE e Projektit	26.3%

Burimi: Ekipi Studimor i JICA-s

12.4.3 Përfundime

Projekti do të jetë financiarisht i qëndrueshëm, mjaftueshëm për t'u zbatuar si një PPP, nëse tarifa për familjet është rritur nga ajo e tanishme nga 417 lekë në 951 lekë. (Tarifat për lloje të tjera të përdoruesve janë vlerësuar të rriten me të njëjtin ritëm si ajo e familjeve).

Projekti do të sjellë përfitime ekonomike të mjaftueshme neto në rajon, përse NBKE e saj është 26.3%, duke tejkaluar qetësisht normën e synuar prej 10%.

Në vijim janë dhënë rekomandimet në zbatimin e projektit.

- BT duhet të konfirmojë numrin e përdoruesve;
- BT duhet të përmirësojë normën e grumbullimit të mbetjeve, veçanërisht atë të familjeve (sot 50%), përpara zbatimit të tij si një PPP. Në të kundërt, do t'i duhet të kompensojë një sasi të madhe humbjeje;
- Rekomandohet që tarifa mujore e familjeve të rritet nga 417 lekë në 951 lekë, bazuar në supozimet që struktura tarifore e sotme midis përdoruesve (familjet, subjektet private, institucionet publike) të jetë e barabartë.
- Barazia në tarifë midis grupeve të ndryshme të përdoruesve duhet të analizojë në hollësi fazat në vijim të vërtetimit, në mënyrë që përdoruesve t'u faturohet tarifa në bazë të parimit "Ndotësi Pagan"
- Analiza ekonomike e projektit duhet të studiohet më tej, duke përfshirë ndikimet mjedisore si pakësimin e emetimeve të metanit.

12.5 Vlerësimet Mjedisore

12.5.1 Masat Zbutëse në Fazën Parandërtimore

Lista e masave zbutëse në fazën para-ndërtimore tregohet në Tabelën 12.5.1.

Çështjet e Tokës/Zhvendosjet

Projektet e propozuara lidhen me punën ndërtimore të impianteve qendrore të rikuperimit të materialeve, impiantet e kompostimit dhe/ose biogazifikimit, impiantin e kthimit të mbetjeve në energji dhe impiantet e depozitimit të mbetjeve. Vendi i ndërtimit të këtyre impianteve propozohen në zonat ngjitur impianteve ekzistuese të Sharrës. Këto vende lokalizohen brenda zonës administrative të Komunës Vaqarr dhe BT do të prokurojë/blejë vendin në konsulencë/negociata me Komunën Vaqarr. Nuk ka shtëpi banimi brenda vendit të propozuar për ndërtim. Gjithsesi, gjatë prokurimit të tokës, BT duhet të marrë parasysh masat për kompensimin, për shtëpitë fqinje dhe pronarët e tokës.

Tabela 12.5.1 Lista e Masave Zbutëse në Fazën Parandërtimore

Sektori	Plani / Projekti	Parametrat	Ndikimi Potencial Negativ	Masat Zbutëse të Rekomanduara	Organi Përgjegjës
Sektori i Menaxhimit të Mbetjeve të Ngurta					
1.1 Trajtimi i Ndërmjetëm					
	1.1.1	Çështjet e Tokës/Zhvendosjet	Ndikime të shtëpitë fqinje dhe për pronarin(ët) e tokës të shkaktuara nga blerja e tokës për vendin e projektit	Përgatitja e PVZh (Plani i Veprimit të Zhvendosjes) Njoftim Paraprak për pronarin(ët) e tokës dhe banorët fqinje dhe institucionet Mbajtja e takimeve konsultative me banorët e prekur dhe Institucionet përkatëse. Marrëveshja ndërmjet propozuesit të projektit dhe banorët e prekur, struktura dhe pronari(ët) i/e tokës. Përgatitja e planit të menaxhimit mjedisor dhe monitorimit dhe marrëveshje me banorët e prekur dhe institucionet përkatëse.	Ministria e Punëve Publike dhe Transportit, BT
1.2 Zhvillimi i Impiantit të Depozitimit Përfundimtar					
	1.2.1	Çështjet e Tokës/Zhvendosjet	Kopje/Njësoj	Kopje/Njësoj	Kopje/Njësoj

Burimi: Ekipi Studimor i JICA-s

12.5.2 Masat Zbutëse të Rekomanduara në Fazën Para-Ndërtimore

Elementet mjedisore, të cilat mund të shkaktojnë ndikime negative në ajër, ujë, zhurma, erë etj. duhet të zbuten me anë të projektimit inxhinierik dhe metodës së ndërtimit. Masat duhet të merren përmes shqyrtimit të metodave alternative për projektimin inxhinierik dhe mënyrën e ndërtimit të kontrolluar në mënyrë të rreptë kundër këtyre ndikimeve. Përveç kësaj, duhet të përgatitet Plani i Monitorimit dhe Menaxhimit Mjedisore dhe duhet të ndërmerren masat zbutëse në përputhje me procedurat e miratuara në bazë të sistemit ligjvënës shqiptar të VNM.

Lista e masave lehtësuese në fazën e ndërtimit tregohet në Tabelën 12.5.2 dhe hollësitë janë përshkruar në paragrafët e mëposhtëm.

Çështjet e tokës / Zhvendosjes

Zbatimi i tanishëm i PVZh-së duhet të konfirmohet në mënyrë që të qartësojë objektet, që mund të ndërhyjnë në fillimin e punimeve të ndërtimit dhe monitorimi i tij do të jetë i nevojshëm.

Shëndeti Publik, HIV / AIDS

Kontraktori duhet të përgatisë një program për sigurinë dhe menaxhimin shëndetësor, që do të thotë që punonjësit të kryejnë një kontroll të rregullt shëndetësor dhe të raportojë rezultatet në qendrën e kujdesit shëndetësor e cila ka juridiksion mbi vendin e projektit. Përveç kësaj, Kontraktori duhet të caktojë një mbikëqyrës shëndetësor dhe të punojë në vijimësi me edukimin shëndetësor të punonjësve për të rritur ndërgjegjësimin e punëtorëve për higjienën e tyre.

Rreziqet

Kjo çështje mbulon fatkeqësitë dhe aksidentet e shkaktuara nga punimet e ndërtimit. Kontraktori duhet të vlerësojë rreziqet e mundshme të punimeve të ndërtimit dhe të përcaktojë masa për të shmangur këto rreziqe gjatë fazës së ndërtimit. Kontraktori duhet të përgatisë edhe një program për menaxhimin e sigurisë dhe gatishmërisë të ngutshme. Programi duhet të ndahet mes të gjitha shtabeve të angazhuara në punimet e ndërtimit. Për aksidentet e trafikut të shkaktuara nga punimet e ndërtimit, Kontraktori gjithashtu, merr masa duke vendosur kontrolluesit e trafikut për të kontrolluar automjetet e ndërtimit dhe makinat për të shmangur shqetësime të trafikeve të tjera në vendet e projektit.

Ujërat nëntokësore

Zhvillimi i objekteve të depozitimit përfundimtar mund të ndikojnë ujërat nëntokësore për shkak të infiltrimit të mundshëm të shllamit në nëntokë. Kontraktori duhet të përgatisë një plan ndërtimi për të shmangur ndikimin negativ kundër ujërave nëntokësore dhe të monitorojë tabelën e ujërave nëntokësore si dhe cilësinë e ujit në pusët fqinje.

Ndotja e ajrit

Prodhimi i pluhurit dhe ndotësve të ajrit, si NO_x, SO_x, dhe PM₁₀ vijnë për shkak të punimeve të ndërtimit dhe funksionimit të makinave të rënda, pajisjeve dhe automjeteve të ndërtimit. Rreziku i ndotjes së ajrit nga puna e ndërtimit është i vogël, por kontraktori duhet të përgatisë një plan ndërtimi për zbutjen e ndotjes së ajrit gjatë ndërtimit, duke përfshirë masat për të përdorur automjete sa më miqësore me mjedisin, makineri dhe pajisje të veçanta për larjen e rregullt të vendit të ndërtimit për të shmangur retë e pluhurit. Monitorimi periodik i ndotësve të ajrit dhe pluhurit është i rekomanduar për të shmangur ndotjen e ajrit gjatë fazës së ndërtimit.

Ndotja e ujit

Ndotja e ujit supozohet në punët ndërtimore nga prodhimi i ujit të turbullt ose ujë me baltë gjatë punimeve të tokës. Kontraktori duhet të përgatisë një plan ndërtimi për të marrë masa për ujin e turbullt nga puna e ndërtimit dhe të trajtimit të ujërave të zeza për ndërtimin e kampit.

Gjithashtu duhet të kryhen:

- Duhet të shmangët shkarkimi i drejtpërdrejtë i mbetjeve të ndërtimit në trupat ujorë përreth.
- Mirëmbajtja e mirë e kampit për të ulur prodhimin e mbetjeve të ndërtimit
- Duhet të sigurohen perdet për baltën/dherat për të kufizuar përhapjen e shtëllungave të sedimenteve

- Kanalet e kullimit duhet të sigurohen për të përcjellë ujërat e shiut në vendet e rërës / baltës.
- Punimet e ndërtimit duhet të programohen siç duhet për të pakësuar gërmimet e tokës në stinët me shi për të parandaluar gërryerjen e tokës
- Këshillohet ripërdorimi i ujit rrjedhës i përpunuar nga automjetet e pastrimit, makinat, pajisje etj.,

Monitorimi i rregullt është e rekomanduar gjatë fazës së ndërtimit.

Mbetjet e ngurta

Prodhimi i mbetjeve të ngurta dhe mbetjeve të ndërtimit është supozuar në zyrat e ndërtimit, punishtet dhe kantieret e ndërtimit

Kontraktori, gjithashtu duhet të përgatisë një program për sigurinë dhe menaxhimin shëndetësor, që mbulon këto masa lehtësuese për prodhimin e supozuar të mbetjeve të ngurta dhe mbetjeve të ndërtimit gjatë fazës së ndërtimit. Në thelb, mbetjet e ndërtimit do të mblidhen, rikuperohen, ripërdoren dhe riciklohen sa më shumë të jetë e mundur për të ulur sasinë e mbetjeve të prodhuara.

Për mbetjet e përgjithshme të krijuara në zyrat e ndërtimit dhe seminare;

- Mbetjet duhet të grumbullohen nga grumbulluesit e caktuar të mbetjeve dhe të hidhen në impiantet e caktuara të trajtimit/depozitimit të mbetjeve

Për mbetjet e ndërtimit dhe të mbetjeve nga punishtet;

- Nafta e përdorur dhe vendet e llumrave të grasove duhet të mblidhen dhe ruhen në një rezervuar(ë) dhe transportohen me transportues të licencuar në një strukturë të licencuar,
- Dheu i tepërt duhet të rimbushet, hidhet ose ripërdoret duke ndjekur veçoritë e punës ndërtimore.

Rekomandohet monitorim i rregullt gjatë fazës së ndërtimit.

Zhurma dhe Dridhjet

Prodhimi i zhurmës dhe dridhjeve është supozuar nga funksionimi i pajisjeve të rënda dhe lëvizjeve të automjeteve të ndërtimit. Kontraktori duhet të përgatisë një plan ndërtimi për uljen e zhurmës dhe nivelet e dridhjeve sipas këtyre masave:

- Kontrollë Inxhinierike, si: 1) shfrytëzimin i automjeteve, makinave dhe pajisjeve të tipit të ulët të zhurmës; 2) përdorimi i aparatit për pakësimin e zhurmës, 3) Rrethimi i shesheve të ndërtimit dhe 4) montimi i pengesave
- Kontrolli administrativ, si 1) marrëveshja e rotacionit të punës, 2) shmangien e punimeve gjatë natës veçanërisht në afërsi të zonës të ndjeshme ndaj zhurmës, p.sh. spitalet, shkollat)

Monitorimi i rregullt rekomandohet gjatë fazës së ndërtimit.

Tabela 12.5.2 Lista e Masave Zbutëse të Rekomanduara në Fazën Parandërtimore

Sektori	Plani / Projekti	Parametrat	Ndikimi i Mundshëm Negativ	Masat Zbutëse të Rekomanduara	Organi Përgjegjës
Sektori i Menaxhimit të Mbetjeve					
1.1 Trajtimi i Ndërmjetëm					
	1.1.1	Çështjet e tokës / Zhvendosjes	Ndikime në shtëpitë fqinje dhe pronar(ët) e tokës për sigurimin e DERr (E drejta e rrugës) për punimet e ndërtimit	Zbatimi i Monitorimit	Ministria e Punëve Publike dhe Transportit BT
	1.1.2	Shëndeti Publik, HIV / AIDS	Ndikime nga punëtorët e ndërtimit gjatë ndërtimit	Njësoj si 1.1.1	Kontraktorë
	1.1.3	Rreziqet	Aksidentet nga punimet e ndërtimit	Njësoj si 1.1.1	Kontraktorë
	1.1.4	Ndotja e ajrit	Ndikimi nga prodhimi i pluhurit dhe ndotësve të ajrit nga punimet e ndërtimit	Njësoj si 1.1.1	Kontraktorë
	1.1.5	Ujërat nëntokësore	Ndikimi për shkak të ujërave të zeza, që përmbajnë shkarkime të baltës dhe ujërave me vaj nga puna e ndërtimit	Përgatitje e detyrueshme e planit të ndërtimit për trajtimin e ujërave të zeza Mbikëqyrja e planit të dërgimit të automjeteve e të ndërtimit, e Kontraktorit Zbatimi i Monitorimit	
	1.1.6	Mbetjet e ngurta	Ndikimi nga mbetjet e ngurta të krijuara në kampin e ndërtimit dhe zyrat	Njësoj si 1.1.1	Kontraktorë
	1.1.7	Zhurma dhe Vibrimet	Ndikimi nga prodhimi i zhurmës dhe vibrimeve nga veprat e ndërtimit	Njësoj si 1.1.1	Kontraktorë
1.2 Zhvillimi i Impianteve të Depozitimit Përfundimtar					
	1.2.1	Çështjet e tokës / Zhvendosjes	Ndikime në shtëpitë fqinje dhe pronar(ët) e tokës për sigurimin e DERr (E drejta e Rrugës) për punimet e ndërtimit	Zbatimi i Monitorimit	Ministria e Punëve Publike dhe Transportit (Palë e Tretë)
	1.2.2	Shëndeti Publik, HIV / AIDS	Ndikime nga punëtorët e ndërtimit gjatë ndërtimit	Njësoj si 1.2.1	Kontraktorë
	1.2.3	Rreziqet	Aksidentet nga punimet e ndërtimit	Njësoj si 1.2.1	Kopje/Njësoj -
	1.2.4	Topografia & Gjeografia	Ndikimet nga rrëshqitja e tokës në vendet e ndërtimit	Përgatitje e detyrueshme e menaxhimit të sigurisë dhe programit të Gatishmërisë së menjëhershme nga Kontraktori	Kopje/Njësoj -
	1.2.5	Ujërat nëntokësore	Ndikimet në ujërat nëntokësore për shkak të punimeve nëntokësore	Njësoj si 1.2.1	Kopje/Njësoj -
	1.2.6	Gërryerja e Tokës	Ndikimet në gërryerjen e tokës për shkak të punimeve të gërmimit.	Përgatitje e detyrueshme e planit të ndërtimit	Kopje/Njësoj -
	1.2.7	Ndotja e ajrit	Ndikimi nga prodhimi i pluhurit dhe ndotësve të ajrit nga punimet e ndërtimit	Njësoj si 1.2.1	Kopje/Njësoj -
	1.2.8	Ndotja e Ujit	Ndikimi për shkak të ujërave të zeza, që përmbajnë shkarkime të baltës dhe ujërave me vaj nga puna e ndërtimit	Njësoj si 1.2.1	Kopje/Njësoj -
	1.2.9	Mbetjet e ngurta	Ndikimi nga mbetjet e	Njësoj si 1.2.1	Kopje/Njësoj -

			ngurta të krijuara në kampin e ndërtimit, zyra, punishtet dhe faqet e ndërtimit		
	1.2.10	Zhurma dhe Vibrimet	Ndikimi nga prodhimi i zhurmës dhe vibrimeve nga veprat e ndërtimit	Njësoj si 1.2.1	Kopje/Njësoj -

Burimi: Ekipi Studimor i JICA-s

12.5.3 Masat Zbutëse të Rekomanduara në Fazën e Operimit

Ashtu si masat zbutëse të rekomanduara për fazën e ndërtimit, masa zbutëse do të merren edhe në fazën e funksionimit dhe mirëmbajtjes. Operatorët do të ndjekin procedurat e parashikuara në manualin e funksionimit dhe mirëmbajtjes, jo vetëm për të vepruar dhe ruajtur objektet, por edhe për të ndërmarrë veprime për zbutjen e ndikimeve mjedisore. Përveç kësaj, operatorët dhe personeli administrativ duhet të marrë masat zbutëse të parashikuara në Planin e Menaxhimit Mjedisor dhe Monitorimit.

Lista e masave lehtësuese në fazën e funksionimit është treguar në tabelën 12.5.3 dhe të dhënat e tyre janë treguar si më poshtë.

Pakicat me të ardhura të ulëta ose Etnike

Në sektorin e menaxhimit të mbetjeve të ngurta, nxitja e 3R, grumbullimit të ndarë dhe zhvillimin e impianteve të trajtimit të ndërmjetëm, si FRrM, Kthimi i Mbetjeve në Energji, Biogazifikimit dhe Kompostimit mund të shkaktojë ndikim negativ në një farë mase të mbledhësive të mbetjeve, të cilët sigurojnë jetesën duke mbledhur mbetjet në vendin ekzistues të landfillit të Sharrës. Shumica e mbledhësive të mbetjeve janë romët. Për jetesën e tyre janë supozuar disa humbje të fitimeve nga planet e propozuara në sektorin e menaxhimit të mbetjeve të ngurta.

Prandaj, masat zbutëse në vijim rekomandohen;

- Formulimi i programeve mbështetëse për jetesën për mbledhësit e mbetjeve,
- Mbajtjen e takimeve konsultative me mbledhësit e mbetjeve (grupet e prekura)
- Nxitja për punësimin e mbledhësve të mbetjeve FRrM në qytet, FRrM qendrore, impiantet e trajtimit të ndërmjetëm dhe të impianteve të depozitimit përfundimtar

Shëndeti Publik, HIV / AIDS

Në sektorin e menaxhimit të mbetjeve të ngurta (zhvillimi i trajtimit të ndërmjetëm dhe i impianteve të depozitimit përfundimtar), të punësuarit në këto objekte do të ekspozohen ndaj mjedisit të rëndë të punës me pluhur dhe erë të rëndë. Disa kushte të pashëndetshme supozohen në këto objekte për shkak të prodhimit të mundshëm të parazitëve të tillë, si minjtë, mizat, dhe mushkonjat.

Prandaj, duhet të ndërmerren këto masa zbutëse;

- Përgatitja e manualit të sigurisë dhe mjedisit të punës për funksionimin e impianteve të trajtimit të mbetjeve të ngurta, duke përfshirë trajtimin e ndërmjetëm dhe impianteve të depozitimit përfundimtar.
- Zbatimi i kontrollit të rregullt të insekteve,
- Zbatimi i edukimit dhe trajnimit për higjienën

- Menaxhimi i cilësisë së ujit, të ujit rrjedhës të trajtuar
- Zbatimi i monitorimit dhe inspektimit

Vlera Vizive apo e Peizazhit

Në peizazhin përreth mund të ketë disa ndikime negative për shkak të paraqitjes së peizazhit të ri të implantit të kthimit të mbetjeve në energji me një oxhak/strukturë.

Prandaj, duhet të ndërmerren këto masa zbutëse;

- Lartësia, forma dhe ngjyrat e oxhakut/strukturës duhet të merren parasysh në fazën e projektimit për të ulur ndikimin e pamjes;
- Takimet konsultative me banorët e prekur nga kjo veprimtari.

Rreziqet

Në sektorin e të menaxhimit të mbetjeve të ngurta, shkëputja e energjisë supozohet të shkaktojë rreziqe në implantet e mbetjeve-në-energjisë, implantit të kompostimit dhe biogazifikimit në varësi të gjendjes së funksionimit. Gjithashtu, prodhimi i gazrave të rrezikshme, si: metani, hidrogjeni sulfide, amoniaku etj, janë të mundshëm në vendin të landfillit dhe paraqesin rrezik shpërthimi dhe rrezik për shëndetin e punëtorëve.

Prandaj, në vijim janë rekomanduar masat lehtësuese:

- Identifikimi më parë i rreziqeve të mundshme për funksionimin e të gjitha objekteve të menaxhimit të mbetjeve,
- Paraqitja e sistemit avari-siguri, instalimi i gjeneratorit(ëve) të ngutshmërisë, sistemin automatik të ngutshmërisë së ndërprerjes së funksionimit etj.;
- Përgatitja e manualeve të funksionimit, mirëmbajtjes dhe vendosjen e masave parandaluese,
- Përgatitja e masave të ngutshmërisë, duke përfshirë masat fillestare të reagimit, masat e reagimit të menjëhershëm, rivendosjen e sistemit,
- Manuali i funksionimit në landfill përfshirë planin e menjëhershëm, i cili do të përpilohet për të marrë masa për gazrat e landfillit për të shmangur rrezikun e shpërthimit dhe të shëndetit të punëtorëve,
- Praktikimi i trajnimit të rregullt të funksionimit gjatë rasteve të emergjencës,
- Krijimi i organizatës për të përballuar reagimin e menjëhershëm, për rreziqet e mësipërme.

Ujërat nëntokësore

Ndikimi në ujërat nëntokësore përreth supozohet nga filtrimet e rrjedhave nga vendi i landfillit. Kontrolli i kullimit/filtrimit i masave, si astar shtrimi të padepërtueshëm dhe/ose strukturave të padepërtueshëm murale duhet të merren parasysh për projektimin e impianteve të depozitimit të mbetjeve të kontrollit. Monitorimi i rregullt i cilësisë së ujërave të pusit(ëve) të monitoruar dhe puseve përreth është gjithashtu i nevojshëm.

Ngrohja Globale

Rritja e GHG të tilla, si gazi CO₂ dhe gazit metan supozohet që do prodhohen nga implantet e menaxhimit të mbetjeve të ngurta, veçanërisht nga implantet e depozitimit përfundimtar. Trajtimi i mbetjeve organike do të jetë një nga masat lehtësuese në këtë sektor.

Për këtë rekomandohen masat e mëposhtme ;

- Ndërtimi i impianteve të trajtimit të mbetjeve organike, si impiantet e kompostimit dhe biogazifikimit për të ulur sasinë e mbetjeve organike në landfill për të pakësuar prodhimin e gazrave të landfillit,
- Shqyrtimi për të miratuar projektimin dhe funksionimin për të ruajtur kushtet aerobe në masën më të lartë për të ulur prodhimin e gazit metan nga vendi i landfillit.

Ndotja e ajrit

Puna e impiantit të mbetjeve-në-energji mund të shkaktojë emetimin e ndotësve të ajrit të tilla si NO_x, SO_x, CO, HCL, SPM dhe dioksinat.

Masat lehtësuese që rekomandohen janë;

- Studim për instalimin e pajisjeve të trajtimit të gazit të shkarkimit për NO_x, SO_x, HCL, SPM dhe dioksinat në fazën e projektimit;
- Kontrolli i temperaturës së përshtatshme për djegien e mbetjeve të ngurta për të ulur prodhimin e dioksinave
- Shmangia e pranimit të mbetjeve të polivinil klorurit dhe mbetjeve familjare të rrezikshme si bateri, përmes zbatimit të grumbullimit të ndarë të mbetjeve për të shmangur rritjen e ndotësve të ajrit, si HCL, dioksinat dhe metalet e rënda
- Zbatimi i monitorimit të shkarkimeve të gazrave në oxhaqet dhe atmosferën e zonave përreth të banuara

Aromat e këqija

Aromat e këqija do të krijohen gjatë trajtimit të ndërmjetëm dhe nga impiantet e depozitimit përfundimtar.

Për të zbutur aromën e keqe rekomandohen masat e mëposhtme;

- Shqyrtimi për hartimin e instalimit të impianteve të largimit të erës së keqe;
- Shqyrtimi i masave për të parandaluar rrjedhjen e erës së keqe nga ndërtesat e impianteve gjatë projektimit të tyre;
- Shqyrtimi i vendndodhjes së objekteve dhe drejtimi i erës mbizotëruese drejt zonave rezidenciale përreth;
- Shqyrtimi për përdorimin e deodorantit në gropat e pritjes së mbetjeve dhe në landfill;
- Mbulim ditor me dhe për mbetjet në landfill;
- Kryerja e monitorimit dhe inspektimit.

Tabela 12.5.3 Lista e Masave Zbutëse në Fazën e Funksionimit

Spektori	Plani / Projekti	Parametrat	Ndikimi i Mundshëm Negativ	Masat Zbutëse të Rekomanduara	Organi Përgjegjës
Spektori i Menaxhimit të Mbetjeve					
1.1 Trajtimi i Ndërmjetëm					
	1.1.1	Pakicat në nevojë ose Etnike	Ndikimi mbi pakicat etnike (Rome) që është shkaktuar nga zhvillimi i Impianteve të Rikuperimit	Formulimi i programit të mbështetës për jetesën Takime publike konsultative me	Operatori të impianteve të trajtimit të ndërmjetëm

			të Materialeve) FRrM	mbledhësit e mbetjeve Punësimi i mbledhësve të mbetjeve për personelin e funksionimit të impianteve të trajtimit të ndërmjetëm/, përfshirë FRrM, kthimit të mbetjeve në energji, impianteve të biogazifikimit, kompostimit, dhe objektet e depozitimit përfundimtar	
	1.1.2	Shëndeti Publik, HIV / AIDS	Ndikimi në mjedisin e punës për funksionimin e trajtimit të ndërmjetëm	Përgatitja e manualit të sigurisë dhe të operimit dhe mjedisit të punës Kontrolli për insekte, minj etj. Zbatimi i kontrollit mjekësor	Kopje/Njësoj -
	1.1.3	Rreziqet	Ndikimi në rreziqet që do shkaktohen nga mosfunksionimi i impianteve të trajtimit të ndërmjetëm/ të sistemit	Përgatitje e detyrueshme e programit të menaxhimit të sigurisë dhe gatishmërisë së ngutshme	Kopje/Njësoj -
	1.1.4	Vlera Vizive apo e Peizazhit	Ndikimi në ndryshimin vizual i shkaktuar nga pamja e impianteve të ndërmjetëm p.sh. një oxhak/turrë)	Pasqyrimi i projektimit të peizazhit për objektet dhe oxhakun	Ministria e Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit
	1.1.5	Ndotja e ajrit	Ndikimi në ndotjen e ajrit që do shkaktohet nga prodhimi i ndotësve të ajrit në impiantet e mbetjeve në energji-(kremetor), biogazifikimit dhe lëvizjeve të automjeteve të grumbullimit	Reflektimi për projektimin për parandalimin e emetimit të ndotësve të ajrit Instalimi i pajisjes së trajtimit të gazit që shkarkohet; Zbatimi i Monitorimit	Ministria e Punëve Publike dhe Transportit, Operatori të impianteve të trajtimit të ndërmjetëm
	1.1.6	Ndotja e Ujit	Ndikimi në ndotjen e ujit që do shkaktohet nga impiantet e ujërave të zeza	Reflektim për projektimin për parandalimin e ujërave të zeza Instalimi i impianteve për trajtimin e ujërave të zeza Zbatimi i Monitorimit	Kopje/Njësoj -
	1.1.7	Zhurmat dhe Vibrimet	Ndikimi në zhurmën që do shkaktohet nga funksionimi i objekteve	Reflektim për projektimin për parandalimin e zhurmës Zbatimi i Monitorimit	Kopje/Njësoj -
	1.1.8	Aromat e këqija	Prodhimi i aromës nga përpunimi i mbetjeve për trajtim	Reflektim për projektimin për parandalimin e aromës Kontrolli për insekte, minj, etj. Zbatimi i Monitorimit	Kopje/Njësoj -
1.2 Zhvillimi i Impianteve të Depozitimit Përfundimtar					
	1.2.1	Rreziqet	Prodhimi i rreziqeve që do shkaktohet nga depozitimi i mbetjeve në landfill që tejkalon kapacitetin e depozitimit	Përgatitja e detyrueshme e programeve të menaxhimit të sigurisë dhe gatishmërisë emergjente, në manualin e operimit	Operatorët e trajtimit të ndërmjetëm dhe depozitimit përfundimtar
	1.2.2	Ujërat Nëntokësor	Ndikimi në ujërat nëntokësore të shkaktuar nga filtrimet e rrjedhave në nëntokë	Reflektimi në projektimin për parandalimin e infiltrimit nënujor të shllamit Hedhjen e astarit ose strukturave të padepërtueshme për parandalimin e infiltrimit të shllamit Zbatimi i Monitorimit të puseve përreth	Ministria e Punëve Publike, dhe Transportit, Operatori i impiantit të depozitimit përfundimtar

	1.2.3	Ngrohja Globale	Ndikimi mbi ngrohjen globale që do shkaktohet nga gazrat e GHG (p.sh. gazit metan)	Reflektimi në projektimin për uljen e sasisë së prodhimit të GHG. Zbatimi i Monitorimit	Kopje/Njësoj
	1.2.4	Ndotja e Ajrit	Ndikimi në ajër nga zjarret spontane në vendin e landfillit	Reflektimi në projektim për ventilim të gazit metan për të shmangur shkaktimin e zjarreve spontane Zbatimi i Monitorimit	Kopje/Njësoj
	1.2.5	Uji i Ndotur	Ndikimi mbi trupat ujorë, nga prodhimi i ujërave të zeza	Reflektimi në projektimin e impianteve të trajtimit të shllamit Zbatimi i Monitorimit	Kopje/Njësoj
	1.2.6	Zhurmat dhe Dridhjet	Ndikimi prej zhurmës nga funksionimi i makinave të rënda dhe lëvizjeve prej automjeteve të grumbullimit	Reflektimi në projektim për ventilim të gazit metan për të shmangur shkaktimin e zjarreve spontane Zbatimi i Monitorimit	Kopje/Njësoj
	1.2.7	Aromat e këqija	Ndikimi në aromë nga puna në landfill	Përdorimi i deodorantit në vendin e landfillit, Mbulimin e rregullt me dhë. Zbatimi i Monitorimit	Kopje/Njësoj -

Burimi: Ekipi Studimor i JICA-s

12.5.4 Plan i Menaxhimit dhe Monitorimit Mjedisor

(1) Plan i Menaxhimit Mjedisor

Çështjet sociale për lehtësimin e të pambrojturve socialë shkaktuar nga zbatimi i projekteve janë parashikuar në të gjithë sektorët. Propozuesit e projektit duhet të përgatisin programe për lehtësimin e njerëzve të cënueshëm nga aspekti social, si programet për mbështetjen e programit të jetesës, veçanërisht për romët siç tregohet në Tabelën 12.5.4. Rritja e tarifës së mbetjeve në të ardhmen do të ndikojë në buxhetin e familjes. Masat janë të nevojshme për vendosjen e një tarife të mirëstudiuar të mbetjeve dhe mendimin e njerëzve të cënueshëm nga aspekti social, të cilët nuk e përballojnë pagesën.

Zhvillimi i impianteve të MMN supozohet të shkaktojë përkeqësimin e mjedisit nëse masat mbrojtëse/lehtësuese nuk janë marrë si duhet. Ndotja e ajrit dhe ndotja e ujit do të jenë çështje të rëndësishme midis disa elementëve ndaj ndikimeve mjedisore shkaktuar nga impiantet e trajtimit të ndërmjetëm dhe impianteve të depozitimit të mbetjeve. Tabela 12.5.4 gjithashtu tregon rekomandimet për përgatitjen e planit të menaxhimit mjedisor për t'u përballur me ndotjen e ajrit dhe të ujit.

Tabela 12.5.4 Plan i Rekomanduar i Menaxhimit Mjedisor

Elementet Mjedisore/Sociale	Çështjet	Veprimet e Rekomanduara	Përmbytja që duhet të Mbulojë	Organet Përgjegjëse
Çështjet e tokës / Zhvendosjes	Ndikimet të pronarët e tokës	Përgatitja e manualit PVZh (të Planin e Veprimit të Zhvendosjes)	Përshkrimi i projektit Kudri ligjor Kudri institucional Vlerësimi i kompensimit të humbjeve Procedura e kompensimit në vlerë të plotë të zëvendësimit	BT, Ministria e Punëve Publike dhe Transportit
Njerëzit e cënueshëm nga	Ndikimet të njerëzit e cënueshëm nga	Formulimi dhe zbatimi i programit të	Trajnimi drejt punës me aftësi të lartë Mbështetje për punësim	BT

aspekti social/ Minoritetet Etnike	aspekti social të prekur nga zhvillimi i impianteve të MMN	mbështetjes së jetesës	Plani i punësimit të mbledhësve të mbetjeve për funksionimin e impianteve përkatëse të MMN (p.sh. FRrM, fshirja e rrugëve, etj.)	
Standardi i jetesës	Ndikimi në jetën qytetare për shkak të rritjes së tarifave të shërbimit	Krijimi i tarifës të duhur Për të bërë të kuptojnë gjerësisht publikun	Ofrimi i informacionit për publikun nëpërmjet TV, radios, broshurave, billboard, etj. Krijimi i tarifave të veçanta për grupin me të ardhura të ulëta/pakta.	BT
Ndotja e ajrit, Aromat e këqija dhe Ngrohja globale	Ndotja e ajrit dhe era e rëndë, e keqe e shkaktuar nga impiantet e trajtimit të mbetjeve	Reflektoni në hartimin e impianteve Përgatitja e manualit të veprimit dhe zbatimit	Instalimi i impianteve të largimit të gazit të rrezikshme, Instalimi i impianteve të mbledhjes dhe largimit të aromës, Kontrolli i Temperaturës së djegies Funksionimi dhe mirëmbajtja e rregullt e impianteve duke iu përgjigjur manualit të funksionimit	BT, Ministria e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Pyjeve
Ndotja e ajrit, Aromat e këqija dhe Ngrohja globale	Ndotja e ajrit dhe era e rëndë, e keqe shkaktuar nga impiantet e trajtimit të mbetjeve	Reflekton në hartimin e impianteve Përgatitja e manualit të operimit dhe zbatimit	Ndërtimi i landfillit sanitar pothuaj- aerobik, Instalimi i impianteve të ventilimit të gazit, Zbatimi i mbulimit të rregullt me dhë. Instalimi i impianteve / sistem zjarrfikësve Operimi dhe mirëmbajtja e rregullt e impianteve duke iu përgjigjur manualit të veprimit	Kopje/Njësoj
Ndotja e Ujit	Ndotje e Ujit e shkaktuar nga impiantet e trajtimit të ndërmjetëm	Reflekton në hartimin e impianteve Përgatitja e manualit të operimit dhe zbatimit	Ndërtimi i impianteve të trajtimit të mbetjeve, Operimi dhe mirëmbajtja e rregullt e impianteve duke iu përgjigjur manualit të funksionimit	Kopje/Njësoj
Ndotja e Ujit	Ndotje e Ujit e shkaktuar nga prodhimi i shllamit nga vendi i landfillit	Reflekton në hartimin e impianteve Përgatitja e manualit të veprimit dhe zbatimit	Ndërtimi i impianteve të trajtimit të shllamit, Ndërtimi i pusit(eve) të monitorimit Funksionimi dhe mirëmbajtja e rregullt e impianteve duke iu përgjigjur manualit të funksionimit	Kopje/Njësoj

Burimi: Ekipi Studimor i JICA-s

(2) Plani i Monitorimit Mjedisor

Plani i rekomanduar i monitorimit social dhe mjedisor është paraqitur në Tabelën 12.5.5. Në fazën, parandërtimit monitorimi duhet të kryhet për prokurimin e vendit të projektit dhe kompensimin për banorët e zonave të prekura dhe pronarët e tokës. Në fazën e ndërtimit, rezultati i masave zbutëse për kontrollin e ndotjes, që lidhet me ajrin, ujërat sipërfaqësore, ujërat nëntokësore dhe zhurmën duhet të monitorohet. Në fazën e funksionimit duhet të monitorohet mjedisi i punës për funksionimin e impianteve të menaxhimit të mbetjeve të ngurta. Kjo duhet të bëhet për shkarkimin e gazrave nga impianti i mbetjeve në energji, ujërat e zeza dhe zhurmat nga impiantet e trajtimit të ndërmjetëm, si dhe kontrollit të gazit të landfillit, impiantet e trajtimit të shllamit dhe erë së keqe veçanërisht në objektin e depozitimit përfundimtar.

Tabela 12.5.5 Plani i Rekomanduar i Monitorimit Mjedisor

Faza e Projektit	Elementët Mjedisor/Social	Parametrat	Vendndodhja e Projektit	Dendësia	Organi Përgjegjës
Para-ndërtimit	Çështjet e tokës / Zhvendosjes	Përparimi për rregullimin e kompensimit Numri i ankesave të regjistruara dhe prirjet e tyre Pagesa e kompensimit	Toka Private e prekur nga DERr (E drejta e Rrugës) së Projektit	Një herë në 3 muaj	Ministria e Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit (Palë e Tretë)
Faza e Ndërtimit					
	Shëndeti Publik, HIV / AIDS	Numri i pacientit Lloji i sëmundjes Prania ose mungesa e HIV / AIDS Veprimet e marra	Punonjësit/Personeli i Kontraktorit	Një herë në muaj	Kontraktorë
	Gjendja Hidrologjike	Gjendja e punës së kullimit	Vendi i Ndërtimit	Një herë në muaj	Kontraktorë
	Cilësia e Ajrit	PM ₁₀	Zonat e banuara pranë vendeve të projektit	Një herë në muaj	Ministria e Punëve Publike dhe Transportit, Kontraktorë
	Uji i Ndotur	pH, BOD, Materiet e ngurta pezulluar, (SS), n-Hexane extracts	Zonat e ujit në rrjedhat e poshtme tek vendet e ndërtimit	Një herë në muaj	Ministria e Punëve Publike dhe Transportit, Kontraktorë
	Mbetjet e Ngurta	Burim i prodhimit Sasia e shkarkimit Metodat e grumbullimit Kushtet e mbetjeve Lloji i mbetjeve Sasia e Prodhimit	Zonat e shkarkimit të mbetjeve	Një herë në muaj	Ministria e Punëve Publike dhe Transportit, Kontraktorë
	Zhurmat dhe Dridhjet	Niveli i Zhurmës (dB)	Zonat e banuara pranë vendeve të projektit	Një herë në muaj	Ministria e Punëve Publike dhe Transportit, Kontraktorë
Faza e Funksionimit					
	Shëndeti Publik, HIV / AIDS	Orët e Punës Pyetësor për punonjësit Pluhuri Era Prania ose mungesa e rreziqeve Kushtet e kontrollit të insekteve, minjve, etj.	Impiantet e Brendshme	Dy herë në vit	Operatori i impianteve të trajtimit të ndërmjetëm dhe të depozitimit përfundimtar
	Ujërat Nëntokësore	Parametrat për mjedisin jetësor (pH, Temperatura, fenoli, Cu, Zn, Fe, BOD, SS, ekstrakte HEXANE, etj) Substancat e rrezikshme (Hg, Pb, Cyanide, etj)	Shllami në zonën e landfillit, Pusi i monitorimi mirë rrjedhën e poshtme të zonës së landfillit.	Në çdo 3 muaj	Operatori i impianteve të trajtimit të ndërmjetëm dhe të depozitimit përfundimtar
	Ngrohja globale	Gazi Metan	Vendi i Landfillit Zonat periferike të impianteve të depozitimit	Në çdo 3 muaj	Ministria e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave

	Cilësia e Ajrit	NO _x , SO _x , CO, PM ₁₀ , HCl, Dioksinat, etj.	Shkarkimi i gazit në oxhaku Zonat e banuara pranë vendeve të projektit	Në çdo 3 muaj	Operatori i impiantit të trajtimit të ndërmjetëm
	Uji i Ndotur	Parametrat për mjedisin jetësor (pH, Temperatura, fenoli, Cu, Zn, Fe, BOD, SS, ekstrakte HEXANE, etj) Substancat e rrezikshme (Hg, Pb, Cyanide, etj)	Impiantet e trajtimit të ujërave të zeza Impiantet e trajtimit të shllamit Trupat ujqorë përreth (Lumi i Erzenit)	Në çdo 3 muaj	Operatori i impiantit të trajtimit të ndërmjetëm
	Zhurmat dhe Dridhjet	Niveli i Zhurmës (dB)	Zonat e banuara pranë vendeve të projektit	Një herë në vit	Operatori i impiantit të trajtimit të ndërmjetëm
	Erërat e Këqija	Amoniaku Methyl mercaptan H ₂ S Metil sulfide Metil disulfide Trimethylamine	Kufiri i Impianteve	Një herë në vit	Operatori i impiantit të trajtimit të ndërmjetëm dhe depozitimit përfundimtar

Burimi: Ekipi Studimor i JICA-s

12.5.5 TeR të Rekomanduar për Procesin Mjedisor për Planet e Propozuara

(1) Kërkesat e përgjithshme në Sistemin shqiptar të VNM

Projektet e propozuara përfshijnë zhvillimin e impiantit të kthimit të mbeturinave në energji, që tejkalon kapacitetin e 50 tonë/ditë dhe zhvillimin e impianteve të reja të depozitimit të mbetjeve me sasinë e mbetjeve hyrëse, që tejkalojnë 50 t/ditë. Në sistemin ligjvënës shqiptar, mjedisor të VNM, VNM e Thelluar është e nevojshme për impiantin e kthimit të mbetjeve në energji, ndërkohë, që VNM paraprake është e nevojshme për impiantet e depozitimit të mbetjeve.

TeR për përgatitjen e VNM së Thelluar është propozuar në paragrafin vijues.

(2) Kërkesat themelore të Dokumentit të VNM të Thelluar

Informacioni i mëposhtëm duhet të mbulohet në përmbajtjen e dokumentit të VNM së Thelluar.

- Objektivi i projektit dhe përshkrimi i hollësishëm i tij;
- Të dhënat themelore shoqërore dhe mjedisore në vendin e projektit dhe zonën në afërsi të saj;
- Përshkrimi i hollësishëm i përbërës të projektit (impianteve dhe pajisjet);
- Plani i ndërtimit dhe afati;
- Përshkrimi i punimeve të ndërtimit;
- Ndikimet e mundshme sociale dhe mjedisore si dhe masat e tyre lehtësuese për të parandaluar efektet jo të mira;
- Programi i Monitorimit;
- Përputhshmëria me planet kombëtare dhe planin e zhvillimit ekonomik;
- Të dhënat e konsultimit me palët e interesuara;
- Masat rehabilituese për ndotjen e mjedisit ose dëmtimin, dhe kostoja e tyre;
- Procedurat dhe arsyet e përzgjedhjes së vendit të projektit;
- Ndikimi i drejtpërdrejtë dhe jo i drejtpërdrejtë në mjedis;

- Opsionet e projektit dhe ndikimi i tyre;
- Mundësia e rrezeve për shëndetin dhe mjedisin dhe masat lehtësuese;
- Ndikimet Ndërkufitare në mjedis, nëse ka ndonjë;
- Përshkrimi i hollësishëm për planin e kursimit të energjisë dhe burimeve natyrore

(3) Konsultimi me Palët e Interesuara

Palët e Interesuara duhet të përfshihen në procesin e formulimit të VNM-së dhe përgatitjes së dokumenteve të VNM-së

Spektori i Menaxhimit të Mbetjeve të Ngurta

- Propozuesi i Projektit: Ministria e Punëve Publike dhe Transportit, BT
- Agjencia Mbikëqyrëse për VNM-në: Ministria e Mjedisit
- Bashkitë: Komuna, Minibashkitë
- Përfituesit: Qytetarët
- Banorët e Prekur: Banorët Vendorë, grumbulluesit e mbetjeve (komuniteti Romë)
- Të tjerë: Universitetet, shoqatat e ricikluesve, grupet e OJQ-ve

(4) Konsideratat e Qëllimit të Punës për Dokumentet e VNM-së së Thelluar

Projekti i propozuar zbatohet bazuar në sistemin ligjor shqiptar, të VNM. Në rast se burimi financiar është marrë nga donatorë ndërkombëtarë, si Banka Botërore, JICA apo KFW, dokumentet e VNM duhet të përgatiten sipas udhëzimeve të donatorëve për shqyrtimin dhe trajtimin mjedisor dhe shoqëror.

Për përgatitjen e dokumenteve të VNM-së, duhet të studiohen së paku pikat e paraqitura në Tabelën 12.5.6.

Tabela 12.5.6 Konsideratat e Rekomanduara për Përgatitjen e Dokumenteve të VNM-së

Emërtimi	Çështjet	Veprimi i Kërkuar
Gjendja Sociale dhe Mjedisore	Toka / Zhvendosjet Grupet në nevojë, minoritetet etnike Ujërat nëntokësore Ndotja e ajrit ; Ngrohja globale Ndotja e ujit Zhurma	Përgatitja e PVZh Identifikimi i aktiviteteve të mbledhësve të mbetjeve Përgatitja e planit të rindërtimit të jetesës dhe punësimit për mbledhësit e mbetjeve Konsultim me palët e interesuara Identifikimi i mjedisit ekzistues shoqëror Identifikimi i mjedisit ekzistues natyror Monitorimi i ujërave nëntokësore në vendin e depozitimit përfundimtar Monitorimi i cilësisë së ajrit Monitorimi i cilësisë së ujit Monitorimi i nivelit të zhurmës
Konsultim me Palët e Interesit	Publikimi i Informacionit	Takime konsultative me publikun Përfshirja e mendimit të publik Regjistrimi i rezultateve të takimit
Plani i Ndërtimit	Problemet mjedisore gjatë fazës së ndërtimit	Përgatitja e dokumenteve të tenderit duke mbuluar dhe masat lehtësuese të kërkuara gjatë ndërtimit Kërkesa e përgatitjes së një plani të ndërtimit & programit ndërtimor me masa të hollësishme lehtësuese dhe planin e monitorimit

Ndikimet e Mundshme	Të gjitha çështjet mjedisore	Vlerësimi i ndikimeve të mundshme të drejtpërdrejta dhe të tërthorta
Masat Lehtësuese	Toka / Zhvendosjet Rreziqet Ujërat Nëntokësor Ndotja e ajrit/ngrohja globale Ndotja e Ujit Zhurmat Erërat e Këqija	Informacion shpjegues për banorët e prekur dhe marrëveshjet Kompensimi për banorët e prekur Njoftimi i autoriteteve përkatëse dhe miratimi i tyre Përgatitja e planit të sigurisë dhe menaxhimit shëndetësor për rreziqet gjatë ndërtimit dhe funksionimit Shqyrtimi i pajisjeve të trajtimit të gazit të shkarkuar për projektimin e impiantit të kthimit të mbetjeve në energji. Shqyrtimi i sistemit të trajtimit të shllamit për projektimin e impiantit të depozitimit përfundimtar Parandalimi i ndotjes gjatë ndërtimit Përgatitja e planit të monitorimit të mjedisit
Plani i Monitorimit të Mjedisit	Toka / Zhvendosjet Grupet në nevojë, minoritetet etnike Trashëgimia kulturore Infrastruktura Sociale Rreziqet Shëndeti Publik Ndotja e ajrit/ngrohja globale Ndotja e Ujit Zhurma	Përgatitja e Planit të Monitorimit Zbatimi i Monitorimit përpara, gjatë ndërtimit dhe në fazën e funksionimit.

Burimi: Ekipi Studimor i JICA-s

12.6 Rekomandime dhe Përfundime

Paragrafët në vijim përmbledhin rekomandimet dhe përfundimet për zbatimin e Planit të MIMN të Bashkisë së Tiranës dhe projekteve parësore. Për të modernizuar kryeqytetin e Shqipërisë, për BT është një mundësi e mirë të fillojë planet e menaxhimit të mbetjeve të ngurta dhe projektet në përputhje me arsyetimet, rekomandimet dhe përfundimet e dhëna në vijim

Rëndësia për Zbatimin e Planeve dhe Projekteve

Në vitet e fundit, përmirësimi apo ndryshimi i veprimtarive të menaxhimit të mbetjeve të ngurta ka qenë një çështje e rëndësishme. Përballja e organeve administrative me këto shqetësime janë krijuar nga pasojat e jetës së përditshme. Zbatimi i një menaxhimi të integruar të mbetjeve të ngurta me përfshirjen e palëve të interesuara është quajtur si një nga zgjidhjet për përmirësimin e gjendjes dhe qeveritë vendore në të gjithë botën po fillojnë përpjekjet për të përballuar këtë detyrë sfiduese. Në Shqipëri, kushtet për zbatimin janë duke u përgatitur për fillimin e planit të menaxhimit të integruar të mbetjeve të ngurta. Rëndësia apo arsyetimi për zbatimin e Planit të MIMN të Bashkisë Tiranë dhe projekteve parësore janë përmbledhur si më poshtë.

- Pajtueshmëria në nivelin e kërkuar të synuar përcaktuar në Ligjin për “Menaxhimin e Integruar të Mbetjeve të Ngurta”, Strategjinë Kombëtare të Mbetjeve, Planin Kombëtar të Menaxhimit të Mbetjeve, Planin e Menaxhimit të Zonës së Mbetjeve Tiranë dhe direktivat e BE.
- Modernizimi i infrastrukturës urbane për kryeqytetin e Shqipërisë dhe për anëtarësim në BE.
- Rënia e trashëgimisë pozitive për ruajtjen e mjedisit dhe burimeve natyrore ndaj brezave të ardhshëm.

Rezultatet e pritshme të Projekteve Parësore

Projektet parësore janë zgjedhur në bazë të kriterëve të shqyrtimit të përcaktuara nga elementet e ngutshmërisë, pajtueshmërisë dhe efektet sa projekti është realizuar siç duhet. Efektet janë rezultat i zbatimit të projekteve parësore dhe përmirësimeve të thella e të rrepta që, priten pasi planet dhe projektet të jenë zbatuar. Këto ndryshime të dukshme dhe përmirësimi themelor në aktivitetet MMN janë sjellë në lidhje me zbatimin e Projekteve Parësore si më poshtë:

- Pastrimi i mbetjeve të depozituara në venddepozitimet e hapura, në mënyrë shumë të ndjeshme ndryshon peizazhin, zbukuron qytetin, dhe përmirëson cilësinë e mjedisit fqinj.
- Zbatimi i grumbullimit të ndarë është një pikënisje për rikuperimin e më shumë materialeve të riciklueshme.
- Zgjerimi i shërbimit të grumbullimit të mbetjeve, në zonat e pambuluara është një kusht themelor për mbajtjen e pastërtisë së qytetit dhe për të shmangur depozitimin e paligjshëm;
- Aktivitetet 3R nga nismat e BT dhe përfshirja e prodhuesve, mbledhësit e mbetjeve, tregtarët, industria e riciklimit dhe aktorëve është zgjidhja e fundit për të ruajtur burimet natyrore për krijimin e një shoqërie të shëndoshë të orientuar drejt burimeve të riciklimit në Tiranë dhe Shqipëri.
- Trajtimi i e mbetjeve bashkiake, që përbëjnë problem (mbetjet organike) është i rëndësishëm për të përmirësuar problemet me erën e rëndë dhe rikuperimin e nënprodukteve të dobishme nga kompostimi dhe biogazi.

- Trajtimi i mbeturinave organike ndihmon për të arritur nivelin e synuar të BE-së, 35% e mbetjeve organike në landfill.
- Impianti i kthimit të mbetjeve në energji është mjeti më i mirë për uljen e madhe të vëllimit të mbetjeve dhe stabilizimin e mbetjeve për në landfill, përveç rikuperimit të energjisë elektrike për uljen e kostos së funksionimit dhe përfitimit të të ardhurave nga shitja e sasive të tepërta të energjisë elektrike për kompaninë elektrike.
- Niveli përfundimtar i synuar prej 75% për rikuperimin dhe riciklimin do të bëhet i arritshëm me funksionimin e “impianit të kthimit të mbetjeve në energji” në një shkallë të duhur.
- Zgjerimi i impianteve të depozitimit të Sharrës është një kusht themelor për të siguruar qëllimin përfundimtar të mbetjeve të mbetura dhe të fillojë funksionimin në fillim të vitit 2017.
- Anëtarët e Ekipit të Punës së Projekteve, të propozuar dhe sektorin shtesë nën Drejtorinë e Menaxhimit të Mbetjeve do të ketë përgjegjësinë kryesore për të nxitur zbatimin e Planit të MIMN të Bashkisë së Tiranës dhe projekteve parësore.
- Grumbullimi dhe analiza e të dhënave bazike të aktiviteteve të MMN, vrojtimi i sasisë së dhe përbërjes së mbetjeve, dhe sondazhi i ndërgjegjësimit janë të nevojshme për vlerësimin e aktiviteteve të MMN.
- Krijimi i sistemit llogaritës të pavarur dhe transparent për aktivitetet e MMN është bazë e rëndësishme për forcimin e kapaciteteve financiare nëpërmjet vendosjes së një sistemi tarifar të drejtë për mbetjet, ndarjen dhe alokimin e buxhetit të përshtatshëm, dhe zbatimin e subvencionit të qeverisë.
- Rritja e vetëdijes publike është kusht i domosdoshëm për futjen e aktiviteteve 3R dhe grumbullimin e ndarë përmes ndarjes së materialeve të riciklueshme në burim, depozitimin e mbetjeve në kontejnerët e caktuar dhe nxitjen e industrisë së riciklimit.

Pjesëmarrja e Sektorit Privat

Sot, shërbimi i mbledhjes së mbetjeve kryhet nga ofruesit të shërbimeve private përmes kontratës me BT. Përveç kësaj, pastrimi i hapësirave publike, si parqet janë kryer nga ndërmarrja në pronësi të BT, e quajtur Drejtoria e Përgjithshme Nr. 1 ose Ndërmarrja e Menaxhimit të Mbetjeve. Përfshirja e sektorit privat në aktivitetet e MMN do të jetë kërkesë e nevojshme edhe në të ardhmen. Ka disa opsione për përfshirjen e sektorit privat për të zbatuar projektet parësore sidomos në shërbimet e grumbullimit dhe të transportit të ndarë të mbetjeve, impianteve të kompostimit dhe biogazifikimit dhe kthimit të mbetjeve në energji, si depozitimin e mbetjeve. Opsionet për kontraktimin e shërbimeve dhe metodat e kontratës duhet të diskutohen dhe studiuar mjaftueshëm në mënyrë të përsëritur për të përcaktuar opsionet më të mira nisur nga propozimet e rekomanduara në seksionet e mëparshme dhe diskutimin e mëposhtëm dhe pikat e studimit.

- Kryerja e pavarur e shërbimit për grumbullimin dhe transportin e ndarë të impiantet e kompostimit dhe biogazifikimit dhe impianteve të mbetjeve në energji dhe depozitimin e mbetjeve, respektivisht nga kontraktuesi individual privat ose të kombinimi i më shumë se një shërbim;
- Integrimi i të gjitha shërbimeve në një kontraktues privat;
- Ndërtuar dhe zotëruar nga BT dhe rekrutimi i personelit të funksionimit dhe mirëmbajtjes;

- Ndërtuar dhe zotëruar nga BT dhe kontraktimi i funksionimit dhe mirëmbajtjes;
- Kontrata e koncensionit sipas Build-Oën-Operate (BOO) or Build-Operate-Transfer (BOT) or Build-Transfer-Operate (BTO);
- Periudha e kontratës për çdo kontratë;
- Metoda e pagesës me çmim fiks ose çmim fiks plus tarifën e përhershme ose koston plus tarifën e përhershme ose kosto plus tarifë fikse;
- Rishikimi i aktiviteteve të caktuara, të Ndërmarrjes së BT për Menaxhimin e Mbetjeve, ristrukturimi i kërkuar, nëse paraqitet i nevojshëm për zbatimin e Planit të MMN të Bashkisë së Tiranës;
- Ofruesit e mundshëm/të interesuar të shërbimit për BT, të jenë teknikisht e financiarisht të besueshëm krahasuar me shkallën e shërbimeve për kontraktim;
- Ofruesit e huaj të mundshëm/të interesuar të shërbimit, të jenë teknikisht e financiarisht të besueshëm krahasuar me shkallën e shërbimeve për kontraktim.

Konceptet e Ndarjes së Kostos

Buxheti i MMN në 2012 u propozua rreth 850 milionë lekë. Sasia e mbetjeve gjithsej në 2012 është vlerësuar në 150 000 t/vit (683 t/ditë x 366 ditë) Nga relacioni më sipër, kostoja e MMN për ton mbetje është vlerësuar 3 400 lekë/ton. Ndërkohë, kostoja njësi për zbatimin e Planit të MMN të Bashkisë së Tiranës është vlerësuar në 10 600 lekë/ton pa përfitim, siç tregohet në Tabelën 3.11.15. Në të ardhmen, kostoja për ton mbetje do të jetë tri më shumë se kostoja e tanishme. Në rrethanat e rritjes së kostos së MMN në të ardhmen, kërkohet që BT të racionalizojë aktivitetet e MMN për të ulur koston dhe rrisë të ardhurat nga konceptet e ndarjes-së kostove, të përmbledhura më poshtë:

- Ngritja e një sistemi llogaritës transparent dhe të pavaruar, të MMN për vlerësimin e gjendjes financiare të aktiviteteve të MMN;
- Vendosja e një sistemi të drejtë tarifor për mbetjet familjare dhe të biznesit, mbetjet tregtare dhe të institucioneve
- Tarifatat e mbetjeve duhet të strukturohen nga llogaritja e kostos së grumbullimit dhe transportimit të mbetjeve, aktiviteteve 3R dhe trajtimit të ndërmjetëm, dhe depozitimit përfundimtar.
- Tarifa e depozitimit ose tarifa e hyrjes së landfill duhet të paraqitet për mjetet e depozitimit/teknologjike drejtpërdrejt në venddepozitimin e mbetjeve;
- Në thelb, parimi “Përfituesi paguan” (PPP) duhet të zbatohet për të vendosur një tarifë mbetjeje dhe taksë.
- Taksa dhe tarifa e mbetjeve duhet të vendoset në nivelin e duhur duke marrë parasysh dëshirën për të paguar, përballueshmërinë për të paguar, nivelin e të ardhurave për prodhuesit e mbetjeve, dhe rritja hap pas hapi e tarifës së mbetjeve;
- Tarifa dhe Taksa e mbetjeve duhet të vendoset në nivelin e duhur duke vlerësuar se shërbimi publik nuk duhet të jetë biznes i orientuar nga përfitimi.

Çështje të rëndësishme për Zbatimin e Projekteve Parësore

Në përmbledhje, janë përcaktuar disa çështje të rëndësishme për të tejkaluar në rrjedhën e zbatimit të Projekteve Parësore siç është treguar më poshtë.

- Ngritja e Ekipit të Punës së Projektit në vitin 2013 për të filluar detyrat fillimisht për studimin e fizibilitetit, planin e zbatimit, vlerësimin e ndikimit mjedisor etj për të nxitur zbatimin e Projekteve Parësore.
- Organizimi i banorëve, grupeve të komunitetit dhe palët e interesuara për ngritjen e vetëdijes publike për të filluar grumbullimin e ndarë dhe aktivitetet 3R në zonën e studimit pilot në vitin 2014.
- Blerja e terrenit për zgjerimin e Sharrës, për të siguruar vendin e ndërtimit për impiantet e menaxhimit të integruar të mbetjeve.
- Ndarja e buxhetit për vitin fiskal 2013 për të nisur zbatimin e Planit të MIMN të Bashkisë së Tiranës dhe Projekteve Parësore.

Përfundime

BT-ës është përgjegjëse për realizimin e Planit të MIMN të Bashkisë së Tiranës në përputhje me kërkesat e përcaktuara në ligjet, strategjitë dhe planet mbizotëruese për këtë problem. Faktori më i rëndësishëm për zbatimin e projekteve të integruara është: pjesëmarrja e banorëve, komunitetit dhe palët e interesuara për nisjen e punës për grumbullimin e ndarë dhe aktivitetet 3R. Prandaj, programet për të rritur ndërgjegjësimin e publikut do të nisin menjëherë duke bërë të njohur planet për publikun dhe/ ose kryerjen e dëgjësive publike për zbatimin e projekteve për të marrë mbështetje nga shoqëria. Duke pasur parasysh gjendjen e sotme, të brishtë financiare, të alokimit të një sasive të ndjeshme, të madhe të buxhetit për punën e ndërtimit, burimet alternative financiare nga burimet e jashtme, si një hua për projektin, subvencion nga qeveria qendrore dhe/ose investime nga sektori privat do të jenë zgjidhja e duhur. Përmirësimi dhe/ose përditësimi i sistemit të MMN do të arrihet nëpërmjet zbatimit të Planit të MIMN të Bashkisë së Tiranës. Rezultatet do të ndihmojnë në modernizimin e infrastrukturës urbane, të cilat janë kërkuara për anëtarësimin e Shqipërisë në BE.

13. Planet e Veprimit për Zhvillimin e Sistemit të Furnizimit me Ujë

13.1 Të Përgjithshme (Përzgjedhja e Projekteve Parësore, Hamendësimet dhe Kushtet)

(1) Politika Bazë për Përzgjedhjen e Projektit Parësor

Krijimi i sistemit të qëndrueshëm të furnizimit me ujë është çështje e domosdoshme dhe e ngutshme për zhvillimin e qëndrueshëm të territorit nën administrimin e Bashkisë së Tiranës. Sistemi i furnizimit me ujë është i nevojshëm për të siguruar ujë të vazhdueshëm për 24 orë. Këtu janë propozuar projektet parësore për të zgjidhur çështjet e tanishme të sistemit të furnizimit me ujë të UKT, agjencisë së zbatimit për furnizim me ujë në Bashkinë e Tiranës dhe zonat përreth. Më poshtë është treguar politika bazë për përparësitë.

- Përzgjedhja e projekteve me ndikim të shpejtë, efektet e të cilave shfaqen në afat të shkurtër si projekte parësore.
- Përfshirja e projekteve, që UKT-ja është duke zbatuar aktualisht ose është duke planifikuar ti zbatojë në të ardhmen e afërt.

(2) Përzgjedhje e Projekteve Parësore

Projektet parësore përfshijnë: (1) Zgjerimin e ITU së Bovillës dhe shtrirjen e linjës së ujit shtesë të patrajtuar për të shfrytëzuar tepricën e ujit, që del nga Diga e Bovillës, (2) Planin e kursimit të energjisë elektrike për të ulur koston e energjisë elektrike, e cila zë një të katërtën e kostos së përgjithshme të F&M së UKT, (3) Planin e pakësimit të Ujit Pa të Ardhura, (4) Futja e sistemit të hartës së tubacioneve për të ndihmuar punën e F&M për shpërndarjen e rrjetit dhe (5) Zhvillimin e kapaciteteve për forcimin e organizimit të UKT.

Ndërtimi i rezervuarëve të shpërndarjes së ujit, montimi i tubacioneve kryesore të transmetimit/shpërndarjes dhe instalimi/zëvendësimi i matësve të ujit janë përjashtuar nga projektet parësore meqë UKT-ja ka nisur tashmë këto projekte si projekte të ngutshme.

13.2 Zërat e Projektit të Menaxhimit të Integruar të Ujit

Në Tabelën 13.2.1 janë paraqitur zërat kryesorë të projekteve parësore.

Tabela 13.2.1 Zërat Kryesorë të Projekteve Parësore (1/3)








Nr.	Emri	Koncepti/Figura	Zëri Kryesor	Afati
FU-1	Shfrytëzimi i ujit të tepërt, që del nga Diga e Bovillës (Rritja e sasisë në hyrje të impiantit të Bovillës)		Degëzimi shtesë i tubacionit me presion për linjën kryesore të ujit të pa trajtuar me dia. 800 mm përgjatë linjës ekzistuese kryesore me dia. 900 mm	2018-2019
FU 1-2	Shtrimi i linjës kryesore së ujit të patrajtuar nga Diga e Bovillës tek ITU së Bovillës		Shtrimi i tubacionit shtesë me dia.800mm dhe gjatësi 10,5 km në aksin ekzistues të linjës kryesore të ujit të patrajtuar	2018-2021
FU 2-1	Zgjerimi i kapaciteteve të pastrimit të ITU së Bovillës		Rritja e kapacitetit të pastrimit i ITU të Bovillës me 50 000 m³/d. Kapaciteti gjithsej i pastrimit do të shkojë në 206 000 m³/d nga 156.000 m³/d ekzistuese pas përfundimit të projektit.	2020-2022

Tabela 13.2.1 Zërat Kryesore të Projekteve Parësore (2/3)

Nr.	Emri	Koncepti/Figura	Zëri Kryesor	Afati
FU4-7	Futja e sistemit të hartës së tubacioneve		Për përgatitjen zgjerimit të zonës së furnizimit me ujë është rekomanduar sistemi i hartës së tubacioneve duke përdorur të dhënat e GIS-it, plani i riparimit dhe zëvendësimit, që përkon me rritjen e kërkesës për ujë dhe urbanizimin e zonës. Personeli i UKT duhet të zotërojnë njohuritë profesionale të sistemit përmes trajnimit gjatë punës	2020-2021
FU5-1	Zvogëlimi i ujit pa të ardhura		Projekti i asistencës teknike për zbulimin dhe riparimin e humbjeve nga personeli i JICA-s. Ekspertët do të kryejnë anketim në terren dhe do të hartojnë Planin Afatgjatë të Zvogëlimit të Ujit Pa të Ardhura.	2016
FU6-1	Instalimi i sistemit të mini-hidrogeneratorit në linjën kryesore të ujit të patrajtuar		Instalimi i pajisjeve të mini-hidrogeneratorit me kapacitet 200kW në linjën kryesore të ujit të patrajtuar nga Diga e Bovillës në ITU e Bovillës për të ulur koston e energjisë së UKT.	2013-2014

Burimi: Ekipi Studimor i JICA-s

Tabela 13.2.1 Zërat Kryesorë të Projekteve Parësore (3/3)

Nr.	Emri	Koncepti/Figura	Zëri Kryesor	Afati
FU6-2	Instalimi i paneleve diellore ne ITU e Bovillës		Instalimi i paneleve diellore në hapësirë të hapur të ITU së Bovillës për shembull mbi rezervuarin e ujit të pastër për të ulur koston e energjisë së UKT.	2015-2016
FU7-1	Rritja e kapacitetit të ndërtesës së UKT		Pjesëmarrja në Kursin e Trajnimit të JICA në Japoni për të rritur ngritjen e kapaciteteve të personelit të UKT.	2017

Burimi: Ekipi Studimor i JICA-s

13.3 Përmbledhje dhe Propozime Teknike të Projektit

(1) Përmbledhjet e Projekteve

Një përmbledhje e 8 projekteve parësore të përzgjedhura jepet në Tabelën 13.3.1.

Tabela 13.3.1 Objektivat dhe Përmbajtja e Projekteve Parësore

Kodi	Titulli i Projektit	Objektivi dhe Përmbajtja
FU 1-1	Shfrytëzimi i Tepricës së Ujit të Digës së Bovillës	Rritja e prurjes në hyrje të ITU nga Diga e Bovillës bazuar në prurjen prej 20 milionë metër ³ në vit. Ndërtimi i linjës së re kryesore të ujit të patrajtuar me dia. 800 mm nga linja ekzistuese e ujit të patrajtuar me dia. 900 mm në dalje nga Diga.
FU 1-2	Shtrimi i Linjës Kryesore shtesë të Ujit të pa Trajtuar nga Diga e Bovillës në ITU të Bovillës	Instalimi i linjave kryesore të ujit të pa trajtuar me dia. 800 mm dhe 10,5 km e gjatë së bashku me linjën kryesore ekzistuese të ujit të pa trajtuar për të përcjellë prurjen shtesë prej 20 milion m ³ /vit ose 0,63 m ³ /sek nga Diga e Bovillës në ITU e Bovillës.
FU 2-1	Zgjerimi i Kapacitetit të Pastrimit të ITU së Bovillës	Rritja e kapacitetit të pastrimit të ITU së Bovillës për të trajtuar prurjen shtesë prej 0,63 m ³ /sek. Ndërtimi i një serie filtrash të pastrimit të ujit, duke përfshirë procesin e sedimentimit kimik të pellgut dhe filtrat e shpejtë të rërës.
FU 4-7	Futja e Sistemit të Hartës së Tubacioneve	Informacioni mbi tubacionet do të jetë i integruar për të bërë të mundur përdorimin e informacionit për qëllime riparimi, zëvendësimi dhe mirëmbajtje. Për të instaluar sistemin e hartës GIS të tubacioneve në ITU Bovillës ose në zyrën qendrore të UKT.
FU 5-1	Zvogëlimi i Ujit Pa të Ardhura	Për të zvogëluar sasinë e ujit pa të ardhura për të rritur të ardhurat për stabilizimin e gjendjes financiare të ujësjellësit. Plani do të përgatitet nga ekipi i menaxhimit të propozuar Ujit Pa të Ardhura për të kryer vrojtimin dhe studimin në zonën e caktuar të projektit pilot dhe zbatojnë modelin në tërë zonën e shërbimit të ujit.
FU 6-1	Instalimi i Pajisjes së Mini-Hidrogjeneratorit në Linjën Kryesore të Ujit të Patrajtuar.	Për të ulur koston e energjisë elektrike të paguar te kompania elektrike nga instalimi i objekteve vetë gjeneruese të energjisë elektrike Instalimi i pajisjeve për mini-hidrogjeneratorin e energjisë për kapacitet prej 200 kE në linjën kryesore të ujit të patrajtuar nga Diga Bovillës.
FU 6-2	Instalimi i Paneleve Diellore në ITU e Bovillës	Për të ulur koston e energjisë elektrike të paguar tek kompania elektrike nga instalimi i objekteve vetë prodhuese të energjisë elektrike. Instalimi i paneleve diellore në hapësirën e ITU të Bovillës për shembull mbi rezervuarin e ujit të pastër, etj.
FU 7-1	Ngritja e Kapacitetit të Personelit të UKT	Për të rritur aftësitë e personelit për përmirësimin e shërbimeve të përgjithshme të ujësjellësit. Dërgimi i personelit të Departamentit të Inxhinierëve, Financës etj. me kursin e trajnimit të JICA-s për të mësuar teknologjinë moderne dhe praktikat e menaxhimit dhe ti zbatojnë njohuritë e mësuara për shërbimin e ujit.

Burimi: Ekipi Studimor i JICA-s

(2) Kostoja e Projektit

Kostoja e planveprimit të furnizimit me ujë është vlerësuar në 3 480,0 milionë lekë siç tregohet së bashku me zërat në Tabelën 13.3.2.

Tabela 13.3.2 Kostoja e Projekteve Parësore

Kodi	Titulli i Projektit	Kostoja e Projektit (milionë lekë)
FU 1-1	Shfrytëzimi i Tepricës së Ujit të Digës së Bovillës	84,0
FU 1-2	Shtrimi i linjës së re të Ujit të Patrajtuar nga Diga e Bovillës në ITU të Bovillës	1 080,0
FU 2-1	Zgjerimi i Kapacitetit të Pastrimit të ITU së Bovillës	1 890,0
FU 4-7	Futja e Sistemit të Hartës së Tubacioneve	3,0

Kodi	Titulli i Projektit	Kostoja e Projektit (milionë lekë)
FU 5-1	Zvogëlimi i Ujit Pa të Ardhura	83,0
FU 6-1	Instalimi i Pajisjes së Mini Hidrogjeneratorit në Linjave Kryesore të Ujit të Patrajtuar	262,0
FU 6-2	Instalimi i Paneleve Diellore në ITU e Bovillës	76,0
FU 7-1	Zhvillimi i Kapacitetit të Personelit të UKT	2,0
Gjithsej		3 480,0

Burimi: Ekipi Studimor i JICA-s

13.4 Analiza Financiare dhe Ekonomike

13.4.1 Analiza Financiare

Vlerësimi financiar i projektit të menaxhimit të ujit është kryer duke krahasuar kostot financiare dhe të ardhurat ndërmjet Rastit Me Projekt dhe Rastit Pa Projekt. Rritja e fluksit të financimit (ndryshesa ndërmjet Rastit Me Projekt dhe Rastit Pa Projekt) është përgatitur mbështetur në supozimet e mëposhtme. Norma e Brendshme e Rikthimit të Financimit (NBRF në Rastin e Projektit (ndryshesa ndërmjet Rastit Me Projekt dhe Rastit Pa Projekt) është llogaritur për vlerësim.

(1) Hamendësimet Kryesore

Hamendësimet kryesore të përdorura për analizën financiare të projektit të menaxhimit të ujit, janë dhënë në vijim. Kjo vlen edhe për analizën ekonomike të projektit, përveç rasteve kur thuhet ndryshe.

- Periudha e Projektit

Periudha e projektit është 39 vjet nga 2013-2051, duke përfshirë periudhën e ndërtimit nga 2014-2022 dhe periudhën e vlerësimit nga 2017-2051.

- Çmimet Bazë dhe Kursi i Ndërrimit

Viti bazë i projektit është 2012. Të gjitha shpenzimet dhe të ardhurat janë shprehur në nivelin e çmimeve të vitit 2012. Studimi e hamendëson normën vjetore të inflacionit përgjatë projektit 3,0%, shkallë inflacioni e përcaktuar nga Banka e Shqipërisë për vitin 2012.

Kurset e ndërrimit të përdorura janë 1 lek = JPY 0,788 = Euro 0,007 = USD 0,009, të cilat janë normat mbizotëruese në kohën e studimit.

- Kontigjencat

Në analiza janë përfshirë edhe punime të paparashikuara prej 10%. Çmimi nuk është përfshirë.

- Taksat

Tatimi mbi vlerën e shtuar (TVSH) prej 20% është i përfshirë, ndërsa taksa e korporatave është përjashtuar.

- Norma e Brendshme e Rikthimit të Financimit (NBRF) e Synuar për Projektin

Është supozuar se UKT-ja ose do të përfitoj kredi bankare dhe/ose do të përdorë paratë e saj për të paguar për projektin e menaxhimit të ujit. Normat mbizotëruese afatgjata të kreditimit të korporatave nga bankat tregtare në Shqipëri shkojnë deri në 13,0% në kohën e Studimit. Norma

reale e interesit është llogaritur në 9,7%, duke zbritur normën e pritur të inflacionit prej 3,0% për vitin 2012 (1,13/1,03 (norma e inflacionit) - 1 = 0,097).

NBRF e synuar e projektit të menaxhimit të ujit, duhet të ndryshojnë në varësi të peshës së burimeve financiare ndërmjet parave të vetë UKT dhe kredisë bankare. Megjithatë, NBRF më e lartë e synuar është 9,7%.

(2) Kostoja Financiare e Projektit

Kostot financiare të projektit përfshijnë shpenzimet për investime dhe kostot e funksionimit dhe mirëmbajtjes (F&M).

- Kostot e Investimit

Kostot financiare të investimeve e projekteve janë llogaritur në bazë të kostos inxhinierike të investimit të paraqitura në nënkapitujt e mëparshëm.

Kostot Fillestare të Investimit

Tabela 13.4.1 Kostot Fillestare Financiare të Investimit të Projekteve

(milionë lekë)

Punët Civile	1 521
Ndërtesë	218
Makineri & Pajisje	1 090
Ngritja e Kapaciteteve	69
Shuma	2 898
Shërbimi i Konsulencës (10%)	96
TVSH (20%)	599
Kostot Bazë	3 594
Kontigjenca (10%)	359
Kostoja e Përgjithshme Financiare e Investimit	3 953

Burimi: Ekipi Studimor i JICA-s

Kostot e Amortizimit

Kostot e amortizimit, nëse është e nevojshme, janë të përfshira në vitet përkatëse bazuar në jetëgjatësinë ose amortizimin e aseteve përkatëse, siç jepet në Tabelën 13.4.2.

Tabela 13.4.2 Jetëgjatësia e Pritshme e Aseteve

Punët Civile	50 vjet
Makineri & Pajisje	15 vjet

Burimi: Ekipi Studimor i JICA-s

Në analizë nuk është marrë parasysh vlera e rikuperimit nga shitja e aseteve në fund të jetës.

- Kostot e Funksionimit

Në Tabelën 13.4.3 janë paraqitur kostot financiare të funksionimit të Rastit të Projektit, si llogaritet më sipër.

Tabela13.4.3 Kostot Vjetore të Funksionimit & Mirëmbajtjes së Projektit në 2030-2046

(milionë lekë)

Kostot e Personelit	298,4
Shërbime	5,5
Lënda e Djegshme dhe Kostot e Energjisë	117,4
Kostot e Mirëmbajtjes	60,9
Kostot e Materialeve (përfshirë kimikatet)	50,3
Gjithsej	532,5

Burimi: Ekipi Studimor i JICA-s

(3) Të Ardhurat Financiare të Projektit

- Vëllimi i Shitjes së Ujit

Vëllimi i shitjes së ujit është llogaritur bazuar në të dhënat e sotme të UKT-së të vitit 2011 dhe është treguar në Tabelën13.4.4.

Tabela13.4.4 Vëllimi i Ujit të Shitur i Rastit të Projektit (000 m³)

Vitet	2017	2020	2023	2030-2051
Vëllimi i Shitjes së Ujit	920	3 580	13 230	17 630

Burimi: Ekipi Studimor i JICA-s

- Numri i Përdoruesve

Numri në rritje i përdoruesve nga projekti është llogaritur në bazë të vëllimit të mësipërm të shitjes së ujit dhe nga numri i përdoruesve në vitin 2012 të ofruara nga ERRU (Enti Rregullator i Sektorit të Furnizimit me Ujë dhe Largimit e Përpunimit të Ujërave të Ndotur). Supozohet se norma e përdorimit të ujit për përdoruesit do të mbetet e pandryshueshme nga viti 2012 e në vijim.

Tabela13.4.5 Numri i Rritur i Përdoruesve sipas Rastit të Projektit

	2017	2020	2023	2030
Familje	3 539	13 770	50 887	67 811
Përdorues të Tjerë	521	2 026	7 486	9 976

Burimi: Ekipi Studimor i JICA-s

- Tarifa e Ujit

Në Tabëlën13.4.6 është treguar ecuria e tarifës.

Tabela13.4.6 Historiku i Ecurisë së Tarifës*

(lekë/m³)

	2008-2009	2010-2011	2012
Familje	20	33	45
Ndërmarrjet Private	95	120	135
Institucionet Publike	75	110	120

*Shifrat janë në çmimet e tanishme.

Burimi: ERRU

Në vitin 2014 është planifikuar që UKT do të rrisë tarifën, siç tregohet në Tabelën 13.4.7

Tabela 13.4.7 Faktorët e Strukturës së Tarifës për Blloqe të Ndryshme të Konsumimit dhe të Përdoruesve

Kategoria e Përdoruesit	Blloqet e Strukturës së Tarifës (metër kub/muaj)			
	< 4,5	4.5 to 20	20 to 30	> 30
Familje	1,0*	1,0 deri në 3,0	1,5 deri në 4,0	2,5 deri në 6,0
Institucionet Publike	1,0 deri në 2,0	1,0 deri në 3,0	1,5 deri në 5,0	2,5 deri në 10,0
Ndërmarrjet Private	1,0 deri në 2,0	1,5 deri në 4,0	2,0 deri në 6,0	3,0 deri në 12,0

* faktori = shumëzim me tarifën e sotme
Burimi: ERRU

- Normat e Mbledhjes së Tarifës sipas Projektit të Menaxhimit të Ujit

Norma e mbledhjes e përmirësuar është llogaritur si në Tabelën 13.4.8.

Tabela 13.4.8 Norma Mesatare e Mbledhjes së Tarifës

2011	2012	2022	2026	2030
90,0%	92,0%	94,7%	95,9%	97,0%

Burimi: ERRU dhe Ekipi Studimor

Megjithatë, analiza financiare përdor normën e mbledhjes prej 100% dhe supozon se shuma e pambledhur do të kompensohet nga UKT-ja dhe jo duke u paguar nga përdoruesit.

- Të Ardhurat e Rastit të Projektit

Të ardhurat e rastit të projektit janë llogaritur bazuar në supozimet e mësipërme dhe janë pasqyruar në Tabelën 13.4.9.

Tabela 13.4.9 Të Ardhurat e Rastit të Projektit

	(milionë lekë)	
	2022	2030-2051
Tarifa e Ujit nga Familjet	312	1 076
Tarifa e Ujit nga Përdorues të Tjerë	491	1 652
Të Ardhura të Tjera	12	42
Gjithsej	815	2 770

Burimi: Ekipi Studimor i JICA-s

(4) Vlerësimi Financiar

NBRF e projektit të menaxhimit të ujit për dy tarifatat e ndryshme të mëposhtme është llogaritur bazuar në supozimet sa më sipër dhe jepen në Tabelën 13.4.10. NBRF është shumë më e lartë se norma e synuar më e lartë prej 9,7%, si për Rastin 1 (tarifa sot) ashtu edhe Rastin 2 (tarifa e rritur në vitin 2014).

Lidhur me këtë, UKT-ja duhet të jetë në gjendje të përfitojë shumë.

Tabela 13.4.10 Përmbledhja e NBRF të Projektit të Menaxhimit të Ujit

	Shuma Fillestare e Investimit (MN Lekë)	Tarifa Mujore sipas Familjeve në 2022 (Lekë)	NBKF
Rasti 1 (Tarifa e sotme)	3 953	745	20,4%
Rasti 2 (rritja e planifikuar në 2014)	3 953	1 188	65,6%

Burimi: Ekipi Studimor i JICA-s

Grafiku i lëvizjes së financimit të projektit të menaxhimit të ujit nën skenarin e Rastit 2 është bashkangjitur në Shtojca 4.

13.4.2 Analiza Ekonomike

Në këtë nënkapitull është kryer analiza ekonomike e projektit të menaxhimit të ujit.

(1) Hamendësimet për Analizën Ekonomike

Përveç hamendësimeve bazë të përmendura më sipër për analizën financiare, në analizën ekonomike janë përdorur edhe hamendësimet e mëposhtme.

- Përllogaritja e Kostove Financiare dhe Përfitimet

Në parim, detyrimet fiskale si taksat dhe subvencionet duhen përjashtuar nga kostot ekonomike dhe përfitimet. Në projekt, është përjashtuar tatimi mbi vlerën e shtuar (TVSH) prej 20% mbi kostot dhe përfitimet.

- Norma e Brendshme e Rikthimit Ekonomik e Synuar (NBRE)

NBRE është një indeks i frytshmërisë së përdorimit të kapitalit të pamjaftueshëm, duke treguar përqindjen mesatare të kthimit, që mund të pritët çdo vit për ekonominë kombëtare përmes investimeve të planifikuara. Institucionet financiare ndërkombëtare, si Banka Botërore dhe Banka Aziatike e Zhvillimit zbatojnë normën e zbritjes sociale prej 10% deri në 12% në vendet në zhvillim.

Projekti përcakton NBRE e synuar në 10%. Kjo do të thotë, nëse NBRE e projektit është më e madhe se 10%, projekti është ekonomikisht i mundshëm dhe duhet të sjellë përfitime neto për ekonominë rajonale.

- Gatishmëria për të Paguar si Përfitim Ekonomik.

Gatishmëria për të Paguar (GPP)

Gatishmëria për të Paguar (GPP) është matja zëvendësuese e vlerës ekonomike e shprehur si “teprica e konsumatorëve” dhe për këtë arsye është shuma, që përfituesit janë të gatshëm të paguajnë në këmbim të produktit apo shërbimeve që marrin. Koncepti GPP është përdorur gjerësisht si shprehje numerike e përfitimeve ekonomike në projektin e vlerësimit. Nëse çmimi, ose tarifa në këtë rast, është më e lartë se GPP, përdoruesit nuk do ta marrin shërbimin dhe do të përdorin paratë për produkte apo shërbime të tjera. Prandaj, GPP është quajtur si kënaqësia më e madhe, që përdoruesit mund të arrijnë në forma të ndryshme nga projekti në fjalë. Kështu që, metodologjia e “Gatishmërisë për të Paguar” është përdorur për të llogaritur përfitimet ekonomike të projektit.

Banka Botërore dhe Banka Aziatike e Zhvillimit kanë një nivel për përqindjen e të ardhurave

që janë të gatshme të paguajnë përdoruesit për shërbimet e infrastrukturës. Sipas tyre, GPP për ujin është 4% e të ardhurave të zotërueshme të përdoruesve.

Pra, supozohet se 4,0% e të ardhurave të zotërueshme të familjeve (60 000 lekë në muaj në vitin 2012), të jetë GPP e klientëve familjarë të projektit të tanishëm të furnizimit me ujë.

Të Ardhurat në Zotërim

Të dhënat e të ardhurave mesatare të familjeve të Prefekturës Tiranë është marrë nga Vrojtimi i të Ardhurave Mjore sipas Prefekturës, 2006-2007 (Instituti i Statistikave, Shqipëri). Shuma është korrigjuar me inflacionin dhe tatimin mbi të ardhurat dhe është llogaritur të jetë 60 000 lekë në muaj në vitin 2012.

(2) Vlerësimi Ekonomik

Gjendja e lëvizjes ekonomike (Economic Cashflow Statement) për projektin e menaxhimit të ujit është përgatitur dhe është bashkangjitur si Shtojca 5. Megjithatë, NBRE e projektit të menaxhimit të ujit është e pallogaritshme për shkak të përfitimit jashtëzakonisht të lartë. Vlera e tanishme ekonomike neto (VTEN) dhe raporti përfitim-kosto (P/K) duke pranuar normën e zbritjes prej 10%, janë 11 704 milionë lekë dhe 4,7. Të dyja bashkë, e kalojnë shumë objektivin e synuar, respektivisht "0" dhe "1".

Mbi këtë bazë, arrihet në përfundimin se projekti është i realizueshëm.

13.4.3 Përfundim

Projekti i menaxhimit të ujit, me rritjen e tarifës së programuar të vitit 2014, pritet të ketë një NBRF shumë të lartë prej 65,6% dhe në këtë mënyrë UKT-ja duhet të jetë në gjendje ta vetëfinancojë atë.

Meqenëse VTEN dhe P/K e projektit janë të mëdha, përkatësisht 11 704 000 lekë dhe 4,7, ajo duhet të sjellë përfitime neto shumë të larta në rajon.

Sa më sipër, arrihet në përfundimin se zbatimi i projektit është i vlershëm.

13.5 Vlerësimet Mjedisore

13.5.1 Masat Lehtësuese të Këshilluara

Masat e mëposhtme lehtësuese janë të këshilluara për secilën fazë të projektit të planit të zhvillimit në çdo sektor.

13.5.2 Masat Lehtësuese në Fazën e Përgatitore

Në Tabelën 13.5.1 është treguar lista e masave lehtësuese në fazën përgatitore.

Çështja e Truallit / Plan Zhvendosja

Projektet e propozuara do të kërkojnë sheshin për ndërtimin e tubacioneve të ujit dhe rezervuarët e shpërndarjes. Projektet do të kërkojnë blerjen e truallit për të siguruar këto zona të projektit. Blerja e truallit duhet të përfshijë edhe masat e kërkuara për kompensimin e pronarëve të tokës.

Infrastruktura Sociale

Sektori i furnizimit me ujë do të përfshijë punët nëntokësore të ndërtimit. Këto punime mund të ndikojnë në objektet nëntokësore, si: energjia elektrike, linjat telefonike, tubacionet e furnizimit me ujë dhe të kanalizimeve. Identifikimi i këtyre shërbimeve përpara ndërtimit do të jetë i nevojshëm për t'u pasqyruar në dokumentet e tenderit ose dokumentet e kontratës së këtyre punimeve.

Tabela13.5.1 Lista e Masave Lehtësuese në Fazën Përgatitore

Spektori	Plani / Projekti	Parametrat	Ndikimi Negativ i Mundshëm	Masat Lehtësuese të Rekomanduara	Strukturat Përgjegjëse
Sektori i Furnizimit me Ujë					
	1.1	Çështja e Truallit/Plan Zhvendosja (Në rastin e ndërtimit të Digës)	Ndikimet të pronarët e truallit, shkaktuar nga blerja e tokës së sheshit të projektit	Njoftim paraprak tek pronarët e truallit, qiradhënësi dhe pronari i objekteve Mbajtja e takimeve konsultative me banorët e prekur Marrëveshja ndërmjet propozuesit të projektit dhe banorëve të prekur Përgatitja e planit të monitorimit Zbatimi i Monitorimit	Ministria e Punëve Publike e Transportit
	1.2	Infrastruktura Sociale	Ndikimet në objektet ekzistuese (linjat telefonike, tubacionet e kanalizimeve, tubacionet e furnizimit me ujë, etj.)	Vrojtimi bazë i objekteve ekzistuese sociale Përgatitja e dokumentit të tenderit ose kontratës në lidhje me dëmshpërblimin për rastin e dëmtimit të objekteve sociale Përgatitja e planit të monitorimit	Ministria e Punëve Publike e Transportit

Burimi: Ekipi Studimor i JICA-s

13.5.3 Masat Lehtësuese të Rekomanduara në Fazën e Ndërtimit

Në Tabelën13.5.2 tregohet lista e masave lehtësuese në fazën e ndërtimit dhe në vijim po japim hollësitë e tyre.

Çështja e Truallit / Plan Zhvendosja

Zbatimi i PVPZh sot duhet të rishikohet në mënyrë që të saktësohen objektet, që mund të ndërhyjnë në fillimin e punimeve të ndërtimit do të jetë i nevojshëm dhe monitorimi i tij.

Infrastruktura Social

Kontraktuesi duhet të marrë miratimin për punimet e ndërtimit nga autoritetet përkatëse (furnizimi me ujë, kanalizime, linjat telefonike dhe të energjisë elektrike), duke paraqitur planin e ndërhyrjes së punimeve të ndërtimit në objektet e cituara dhe mënyrën si do të bëhet dëmshpërblimi për dëmet e paparashikuara. Për këtë, një monitorim i rregullt do të jetë i nevojshëm.

Shëndeti Publik, HIV / SIDA

Kontraktori duhet të përgatisë një program të sigurisë dhe menaxhimit shëndetësor për punëtorët,

të kryejë kontroll të rregullt shëndetësor dhe të raportojë rezultatet në një qendër të kujdesit shëndetësor, e cila ka juridiksion në vendin e projektit. Përveç kësaj, kontraktori duhet të caktojë një mbikëqyrës shëndetësor dhe të kryejë një edukim shëndetësor për të rritur ndërgjegjësimin e punëtorëve për higjienën e tyre në mënyrë që të mos ndikojë në mjedisin përreth.

Rreziqet

Kjo çështje mbulon fatkeqësitë dhe aksidentet e shkaktuara nga punimet e ndërtimit. Kontraktori duhet të vlerësojnë rreziqet e mundshme gjatë ndërtimit, të vendosë masat, që do të merren për shmangien e rreziqeve gjatë ndërtimit dhe të përgatisë një program për menaxhimin e sigurisë dhe gatishmërisë në rast ngutshmërie. Programi duhet ti bëhet i ditur të gjithë personelit duke përfshirë punëtorët e ndërtimit. Për aksidentet e shkaktuara nga punimet e ndërtimit, kontraktori merr masa për të caktuar personat, që drejtojnë dhe kontrollojnë automjetet e ndërtimit dhe pajisjet në mënyrë që të mos të pengojnë trafikun e automjeteve të tjera në vendin e projektit.

Ujërat Nëntokësore

Punimet e shtrirjes së tubacionit të furnizimit me ujë do të përfshijë edhe punimet nëntokësore, të cilat mund të ndikojnë në ujërat ekzistues të nivelit nëntokësor. Kontraktori duhet të përgatisë një plan ndërtimi për të shmangur ndikimin negativ në ujërat nëntokësore ekzistuese. Gjithashtu, rekomandohet monitorimi nga kontraktori i ujërave nëntokësore nëpërmjet puseve përreth zonës së ndërtimit.

Ndotja e Ajrit

Nga punimet e ndërtimit dhe funksionimi i pajisjeve të rënda dhe automjeteve të ndërtimit, është vlerësuar, prodhimi i pluhuri dhe ndotësve të ajrit si NO_x, SO_x dhe SPM. Kontraktuesi duhet të përgatisë një plan ndërtimi, duke patur parasysh zvogëlimin e ndotjes së ajrit gjatë punimeve të ndërtimit. Ai duhet të monitorojë orarin e lëvizjes së automjeteve, pajisjeve të rënda si dhe të kryejë spërkatjen e rregullt me ujë në vendet e ndërtimit. Për të shmangur ndotjen e ajrit gjatë fazës së ndërtimit rekomandohet edhe monitorimi periodik i ndotësve të ajrit të mësipërm.

Ndotja e Ujit

Ndotja e ujit ndodh nga krijimi i ujit të turbullt ose me baltë gjatë punimeve tokësore. Kontraktuesi duhet të përgatisë edhe një plan ndërtimi, që ka të bëjë me trajtimin e ujërave të zeza.

Duhet të merren parasysh:

- Shmangia e hedhjes së drejtpërdrejtë të mbetjeve të ndërtimit në ujë;
- Zvogëlimi i mbetjeve të ndërtimit duke shmangur rikonstruksionin e shtëpive;
- Të sigurohet shtresë zhavorri për të ndaluar shpërndarjen e sedimenteve;
- Të parashikohen kanale për largimin e ujërave të shiut
- Punimet e ndërtimit duhet të programohen në mënyrë të tillë që të shmangin gërmimet në kohë shiu për të parandaluar shkarjen e dherave
- Ripërdorimi i ujit të larjes së mjeteve dhe largimi i pluhurit

Gjatë fazës së ndërtimit rekomandohet monitorimi i rregullt.

Mbetjet e Ngurta

Në përgjithësi, mbetjet e ngurta dhe mbetjet e ndërtimit vlerësohen në zyrat e ndërtimit, seminarët dhe vendet e ndërtimit. Kontraktuesi duhet të përgatisë një program për sigurinë dhe menaxhimin shëndetësor gjatë fazës së ndërtimit, që mbulon lehtësimet në vijim për vlerësimin e prodhimit të mbetjeve të ngurta dhe atyre të ndërtimit.

Përgjithësisht, për prodhimin e mbetjeve në zyrat e ndërtimit dhe seminare;

- Mbetjet duhet të mblidhen nga grumbulluesit e përcaktuar dhe të vendosen në vendet e caktuara.
- Për mbetjet nga ndërtimi dhe nga seminarët.
- Vaji i përdorur dhe graso duhet të mblidhen dhe të ruhen në një depozitë të veçantë dhe të transportohen nga transportues të autorizuar, në një impiant të licencuar
- Uji me vaj duhet të ndahet nga uji pa vaj dhe të transportohet në një impiant të licencuar;
- Mbetjet e gërmimit duhet të rimbushen në punimet e argjinaturës;
- Prodhimi i betonit duhet të jetë vetëm në sasinë më të vogël të kërkuar.

Gjatë fazës së ndërtimit rekomandohet monitorimi i rregullt.

Zhurmat & Dridhjet

Zhurmat dhe dridhjet vijnë nga funksionimi i pajisjeve të rënda dhe lëvizjet e automjeteve të ndërtimit.

Kontraktuesi duhet të përgatisë një plan për pakësimin e zhurmës dhe dridhjeve gjatë fazës së ndërtimit, i cili të përmbajë këto masa :

- Kontrolli inxhinierik, si: 1) përdorimi i pajisjeve të tipit me zhurmë të ulët, 2) përdorimi i zhurmëmbytësve, 3) mbyllja e shesheve të ndërtimit, dhe 4) montimi i barrierave;
- Kontrolli administrativ, si: 1) marrëveshja për përcaktimin dhe miratimin e numrit të ndërresave të punës dhe 2) shmangia e punës gjatë natës, veçanërisht pranë zonave të ndjeshme ndaj zhurmës (P.sh., spitaleve dhe shkollave).

Gjatë fazës së ndërtimit rekomandohet monitorim i rregullt.

Tabela13.5.2 Lista e Masave Lehtësuese në Fazën e Ndërtimit

Sektori	Plani / Projekti	Parametrat	Ndikimi Negativ i Mundshëm	Masat Lehtësuese të Rekomanduara	Struktura Përgjegjëse
Furnizimi me Ujë					
	1.1	Çështja e Truallit / Plan Zhvendosja	Ndikimi i shkaktuar nga blerja e tokës	Zbatimi i monitorimit	Ministria e Punëve Publike e Transportit
	1.2	Infrastruktura Sociale	Ndikimet në objektet ekzistuese sociale (linjat telefonike, tubacionet e kanalizimeve, tubacionet e furnizimit me ujë, etj.)	Njoftim paraprak tek agjencitë ose autoritetet përkatëse Aplikimi për leje nga autoritetet përkatëse Zbatimi i monitorimit	Ministria e Punëve Publike e Transportit Drejtoria e Projekteve dhe e Rrjetit Inxhinierik, BT

Sektori	Plani / Projekti	Parametrat	Ndikimi Negativ i Mundshëm	Masat Lehtësuese të Rekomanduara	Struktura Përgjegjëse
	1.3	Përdorimi i Ujit ose e Drejta për Furnizim me Ujë	Ndikimet në të drejtën e tanishme për të pasur ujë për ujin shtesë	Konsultimi me autoritetet përkatëse Marra e të drejtës së ujit	Ministria e Punëve Publike e Transportit MMPAU
	1.4	Shëndeti Publik, HIV/SIDA	Ndikimet mbi punëtorët e ndërtimit gjatë ndërtimit	Përgatitja e detyrueshme e sigurisë dhe e programit të menaxhimit të shëndetit nga kontraktuesi Caktimi i një mbikëqyrësi shëndetësor Zbatimi i edukimit shëndetësor Zbatimi i monitorimit	Kontraktuesi
	1.5	Rreziqet	Aksidente nga punët ndërtimore duke përfshirë aksidentet e trafikut	Përgatitja e detyrueshme e programit të sigurisë dhe të menaxhimit të shëndetit nga kontraktuesi Vendosja e personave ,që kontrollojnë trafikun në vendet e ndërtimit	Kontraktuesi
	1.6	Topografia dhe Gjeografia	Ndikimet e shkaktuara nga shkarjet e dheut gjatë punimeve të ndërtimit (sipërfaqja, nëntokë)	Përgatitja e detyrueshme e programit të sigurisë dhe të gatishmërisë për emergjenca nga kontraktuesi	Kontraktuesi
	1.7	Ujërat Nëntokësore	Ndikimi në ujërat nëntokësore të shkaktuara nga nxjerrja e ujit nëntokësor	Studimin bazë i ujërave ekzistuese nëntokësore dhe i puseve përreth Pasqyrimi në projektimin e sasisë të ujërave nëntokësore për të shmangur uljen e kësaj sasive Zbatimi i monitorimit	Ministria e Punëve Publike e Transportit
	1.8	Gjendja Hidrologjike (Në rastin e Digës së Rezervuarit)	Ndikimi në regjimin e rrjedhjes së poshtme e shkaktuar nga diga	Vlerësimi mbi përdornin e ujit për mirëmbajtjen e rrjedhës së poshtme	Ministria e Punëve Publike e Transportit
	1.9	Flora & Fauna (-E njëjta gjë-)	Ndikimi në florën dhe faunën, shkaktuar nga prerja e pemëve	Studimi bazë i florës, bimësisë dhe faunës ekzistuese Transplantimi i specieve të rëndësishme	Ministria e Punëve Publike e Transportit
	1.10	Ndotja e Ajrit	Ndikimi i shkaktuar nga prodhimi i pluhurave dhe i ndotësve të ajrit nga punimet ndërtimore	Përgatitja e detyrueshme e një plani për parandalimin e ndotjes së ajrit nga kontraktuesi Spërkatje e detyrueshme me ujë në sheshet e ndërtimit Përgatitja e detyrueshme e planit të alokimit të duhur të mjeteve të ndërtimit Mbikëqyrja e planit të kontraktuesit për alokimin e mjeteve të ndërtimit Zbatimi i monitorimit	Kontraktuesi
	1.11	Ndotja e Ujit	Ndikimi i shkaktuar nga ujërat e zeza që përmbajnë llumra dhe vajra	Përgatitja e detyrueshme e një plani për trajtimin e ujërave të zeza Zbatimi i monitorimit	Kontraktuesi

Sektori	Plani / Projekti	Parametrat	Ndikimi Negativ i Mundshëm	Masat Lehtësuese të Rekomanduara	Struktura Përgjegjëse
	1.12	Zhurmat dhe Dridhjet	Ndikimi i shkaktuar nga krijimi i zhurmës dhe dridhjeve nga punët ndërtimore	Përgatitja e detyrueshme e një plani për zvogëlimin e zhurmës dhe dridhjeve Përshtatja e makinerive të ndërtimit dhe pajisjeve për parandalimin e zhurmës dhe dridhjeve Zbatimi i monitorimit	Kontraktuesi
	1.13	Rrëshqitja e Terrenit	Fundosja e terrenit për shkak të largimit të ujërave nëntokësorë	Përgatitja e detyrueshme e një plani të ndërtimit Mbikëqyrja e punimeve të ndërtimit të kontraktuesit Zbatimi i monitorimit	Kontraktuesi

Burimi: Ekipi Studimor i JICA-s

13.5.4 Masat Lehtësuese të Rekomanduara në Fazën e Funksionimit

Në Tabelën 13.5.3 tregohet lista e masave lehtësuese në fazën e funksionimit dhe hollësitë e tyre janë paraqitur në vijim.

Shëndeti Publik, HIV / SIDA

Në sektorin e furnizimit me ujë, rreziqet e ndotjes nga bakteret dhe metalet e rënda gjatë procesit të trajtimit dhe shpërndarjes së ujit priten dhe mund të shkaktojnë ndikim negativ për qytetarët.

Prandaj, duhet të merren këto masa lehtësuese;

- Zbatimi i edukimit dhe i trajtimit
- Menaxhimi i cilësisë së ujit të trajtuar në sektorin e furnizimit me ujë
- Zbatimi i monitorimit

Rreziqet

Në sektorin e furnizimit me ujë, mund të ketë aksidente të mosfunksionimit të sistemit, që ndodhin nga ngjarje të papritura, si: ndërprerja e energjisë elektrike apo fatkeqësitë natyrore.

Prandaj, rekomandohen këto lehtësimet e mëposhtme lidhur me mosfunksionimin e sistemit,

- Identifikimi paraprak i rreziqeve të mundshme
- Krijimi i një organizmi për përgjigje të menjëhershme për rreziqet e mësipërme
- Marrja e masave parandaluese dhe krijimi i strukturës për zbatimin e tyre (organizimi i strukturës, përgatitja e manualeve për masat e ngutshmërisë, bashkëpunimi me autoritetet përkatëse, zbatimi i edukimit / trajnimit, instalimi i pajisjeve rezervë, si gjenerator të energjisë)
- Përgatitja e masave të reagimit të menjëhershëm (masa fillestare reaguese, masat e përgjigjes së menjëhershme, rivendosja e sistemit)

Ujërat Nëntokësorë

Në këtë sektor ndikimi mbi ujërat nëntokësorë përreth vlerësohet nga ndryshimi i nivelit të ujërave nëntokësore. Në përgatitjen e planit të furnizimit me ujë, rekomandohet trajtimi i përshtatshëm i ujërave nëntokësorë dhe monitorimi i vazhdueshëm për të shmangur ndikimin në ujërat nëntokësore përreth.

Mbetjet e Ngurta

Procesi i flokulimit vlerësohet se mund të prodhojë llumra, që vijnë nga përdorimi i preparateve shtesë.

Duhet marrë këto masa lehtësuese:

- Trajtimi i duhur dhe asgjësimi i llumit të trajtuar
- Mbrojtja e vendeve të asgjësimit përfundimtar të llumit të trajtuar

Zhurma dhe Dridhjet

Në këtë sektor, në fazën e funksionimit mund të krijohen zhurma nga puna e pompave dhe ventilatorëve.

Për këtë, rekomandohen këto masa:

Për sektorin e furnizimit me ujë dhe kanalizimeve, në anën tjetër;

- Realizimi i punimeve të ndërtimit bazuar në një studim të mbrojtjes nga zhurmat nëpërmjet pengesave zanore
- Zbatimi i monitorimit në zonat e banimit përreth

Të tjera

Në sektorin e furnizimit me ujë dhe kanalizimeve, kostoja e funksionimit dhe mirëmbajtjes do të rritet për shkak të numrit në rritje të personelit dhe mirëmbajtjes së objekteve, që kërkojnë lëndë të djegshme dhe energji elektrike.

Rritja e koston për funksionimin dhe mirëmbajtjen mund të shkaktojë ndikim negativ mbi gjendjen psikologjike në kushtet e jetesës.

Rekomandohen këto masa:

- Identifikimi i dëshirës së qytetarëve dhe i mundësisë për të paguar shërbimin
- Realizimi i aktiviteteve të ndjeshmërisë përmes mediave
- Përmirësimi i shërbimit të përputhet me rritjen e tarifave

Tabela13.5.3 Lista e Masave Lehtësuese në Fazën e Funksionimit

Sektori	Plani / Projekti	Parametrat	Ndikimi Negativ i Mundshëm	Masat Lehtësuese të Rekomanduara	Struktura Përgjegjëse
Furnizimi me Ujë					
	1.1	E drejta e Ujit ose e Drejta e Përdorimit të Ujit	Ndikimet në të drejtën ekzistuese të ujit për ujin shtesë	Konsultimi me autoritetet përkatëse Marrja e një të drejte të ujit	Ministria e Punëve Publike dhe Transportit UKT

	1.2	Shëndeti Publik	Ndikimi në cilësinë e ujit nga uji i trajtuar në procesin e trajtimit	Pasqyrimi i dezinfektimit të ujit të patrajtuar në projektimin e objektit Mirëmbajtja e tubacioneve të ujit për parandalimit e ndotjes Monitorimi dhe analiza e cilësisë së ujit në përputhje me standardet e cilësisë së ujit	Ministria e Punëve Publike e Transportit UKT
	1.3	Rreziku	Ndikimi i shkaktuar nga mos funksionimi i furnizimit me ujë dhe sistemit të trajtimit	Përgatitja e detyrueshme e një programi menaxhimit të sigurisë dhe të gatishmërisë së ngutshme në manualin e funksionimit	UKT
	1.4	Topografia dhe Gjeografia	Ndikimi i ndryshimit topografik ose gjeografik	Pasqyrimi i uljes së ndryshimit të topografisë dhe gjeografisë në projektimin e objektit	Ministria e Punëve Publike e Transportit
	1.5	Ujërat Nëntokësore	Ndikimi i pakësimit të ujërave nëntokësore i shkaktuar nga largimi i ujit nëntokësor	Zbatimi i monitorimit	UKT
	1.6	Gjendja Hidrologjike	Ndikimi në regjimin e rrjedhjes së poshtme e shkaktuar nga diga	Pasqyrimi i mirëmbajtjes së prurjeve në planifikimin e objektit ose të projektit	Ministria e Punëve Publike e Transportit
	1.7	Flora dhe Fauna	Ndikimi në ekosistem shkaktuar nga ulja e rrjedhës së lumit	Pasqyrimi gjatë projektimit të mirëmbajtjes së florës dhe faunës në rrjedhën e poshtme të lumit	Ministria e Punëve Publike e Transportit
	1.8	Vlera Pamore dhe Peizazhi	Ndikimi në ndryshimin pamor i shkaktuar nga paraqitja e rezervuarit	Pasqyrimi në projektin e peizazhit	Ministria e Punëve Publike e Transportit
	1.9	Ndotja e Ujit	Ndotja e ujit e shkaktuar nga bimët parazite (eutrofikimi)	Kontrolli i aktiviteteve të njeriut, si përdorimi i plehrave në rrjedhën e sipërme Zbatimi i monitorimit	Ministria e Punëve Publike dhe Transportit UKT
	1.10	Mbetjet e Ngurta	Ndikimi, që do të shkatohet nga krijimi i llumit të trajtuar dhe asgjësimi i tyre	Trajtimi i duhur dhe asgjësimi i llumit të trajtuar Sigurimi i vendeve të asgjësimit të llumit të trajtuar	Ministria e Punëve Publike dhe Transportit UKT
	1.11	Zhurma e Dridhje	Ndikimi i zhurmës që do të shkatohet nga	Pasqyrimi në projekt i papërshkueshmërisë nga zëri për ndërtesat dhe pajisjet	Ministria e Punëve Publike e

			puna e pompave dhe ventilatorëve	Përputhshmëria me standardet mjedisore Zbatimi i monitorimit	Transportit UKT
	1.12	Rrëshqitja e Terrenit	Rrëshqitjet për shkak të ujit nëntokësor	Pasqyrimi në projekt i sasisë së ujit të larguar për të shmangur rrëshqitjen e terrenit Zbatimi i monitorimit	Ministria e Punëve Publike e Transportit UKT
	1.13	Sedimentet e Lumit	Gërryerja e prurjes së poshtme për shkak të largimit të ujit të lumit me pompa	Pasqyrimi në projektin e kanalizimit të sedimenteve të rrjedhës së poshtme	Ministria e Punëve Publike e Transportit

Burimi: Ekipi Studimor i JICA-s

13.5.5 Plani i Menaxhimit Mjedisor dhe i Monitorimit

(1) Plani i Menaxhimit Mjedisor

Rritja në të ardhmen e tarifave për shërbimin e furnizimit me ujë dhe kanalizimeve do të ndikojë në buxhetin e familjes. Programi i menaxhimit në drejtim të vendosjes së tarifës përkatëse dhe marrja parasysh e shtresave në nevojë, të cilat nuk do të kenë mundësi për të paguar. Plani i menaxhimit mjedisor është treguar në Tabelën 13.5.4.

Tabela 13.5.4 Plani i Rekomanduar i Menaxhimit Mjedisor

Elemente Mjedisore / Sociale	Çështja	Veprimi i Rekomanduar	Duhet Mbuluar	Struktura Përgjegjëse
Jetesa	Ndikimi në jetën civile që do të shkaktohet nga rritja e shërbimit të tarifës	Vendosja e tarifës përkatëse Për ta bërë plotësisht të kuptueshëm për publikun	Ofrimi i informacionit për publikun nëpërmjet TV, radios, broshurave dhe fletëpalosjeve Vendosja e tarifës së veçantë për shtresat në nevojë	Bashkia e Tiranës

Burimi: Ekipi Studimor i JICA-s

(2) Plani i Monitorimit Mjedisor

Në Tabelën 13.5.5 është treguar plani i rekomanduar i monitorimit social dhe mjedisor.

Në fazën e parandërtimit, duhet të kryhet monitorimi për sigurimin e trullit për zbatimin e projektit dhe kompensimin e pronarit të tokës. Në fazën e ndërtimit, objektet sociale, (shërbimet) si linjat elektrike, rrugët, linjat telefonike që do të preken nga ndërtimi duhet të monitorohen për fillimin e punimeve të ndërtimit. Duhet të monitorohet gjithashtu edhe ndotja e ujit nëntokësor në rrjedhën e poshtme dhe ndotja nga zhurmat. Në fazën e funksionimit duhet të monitorohet cilësia e ujit pas trajtimit, si dhe zhurma e krijuar nga funksionimi i pompave.

Tabela13.5.5 Plan i Monitorimit Mjedisor i Rekomanduar

Faza e Projektit	Elementë Mjedisor / Social	Parametrat	Vendndodhja ose Objekti	Dendësia	Struktura Përgjegjëse
Parandërtimi	Çështja e Truallit / Plan Zhvendosja	Përparimi për marrëveshjen e kompensimit Numri i ankesave të regjistruara dhe pritjet e tyre Pagesa e kompensimit	Tokat private të prekura nga DeK e projektit	Një herë çdo 3 muaj	Ministria e Punëve Publike dhe Transportit
Faza e Ndërtimit					
	Infrastruktura Sociale	Shkalla ose zona e objektit që preket Përparimi në kërkesën ndaj autoriteteve përkatëse për fillimin e punimeve ndërtimore Progresi në miratimin nga autoritetet përkatëse	Objektet sociale të prekura nga projekti	Një herë çdo 3 muaj	Ministria e Punëve Publike dhe Transportit Kontraktuesi
	Shëndeti Publik, HIV / SIDA	Numri i të sëmurëve Tipi i sëmundjes Prania ose mungesa e veprimeve të marra për HIV / SIDA Veprimet e marra	Punonjësit e kontraktuesit	Një herë në muaj	Kontraktuesi
	Ujërat Nëntokësore	Tabela e ujit	Puset përreth	Një herë në vit	Kontraktuesi
	Cilësia e Ajrit	NO _x , SO ₂ , CO, PM, PM ₁₀	Zonat e banuara pranë sheshit të ndërtimit	Një herë në muaj	Kontraktuesi
	Ndotja e ujit	pH, Mbetjet BOD, ekstraktet n-Hexane	Zona e rrjedhës së poshtme të ujit e sheshit të ndërtimit	Një herë në muaj	Kontraktuesi
	Mbetjet e ngurta	Burimet e krijimit Sasia e shkarkimit Metodat e mbledhjes Kushtet e hedhjes së mbetjeve Lloji i mbetjeve të krijuara Sasia e krijuar	Zonat e shkarkimit të mbetjeve	Një herë në muaj	Kontraktuesi
	Zhurma dhe Dridhjet	Niveli i zhurmës (dB)	Zonat e banuara pranë sheshit të ndërtimit	Një herë në muaj	Kontraktuesi
	Rrëshqitja e terrenit	Niveli i ujit Kuotat e tokës	Sheshi i ndërtimit	Një herë në muaj	Kontraktuesi
Faza e Funksionimit					
	Shëndeti Publik, HIV / SIDA	Parametrat për ujin e patrajtuar dhe të trajtuar, që rekomandohen për ujin	Uji i pa trajtuar Uji pas trajtimit	Një herë në muaj	UKT

		e pishëm nga manuali i WHO	Uji në dalje të tubacionit		
	Ujërat nëntokësore	Niveli i ujit	Puset përreth	Një herë në vit	UKT
	Ndotja e ujit	Parametrat e mëposhtëm të rezervuarit: Niveli i ujit Temperatura Turbullira DO Klorofili i një COD Shuma e Azotit Shuma e Fosforit Sedimentet në fund	Rezervuar	Një herë në vit	UKT
	Zhurma dhe dridhjet	Niveli i zhurmës (dB)	Zonat e banuara pranë sheshit të ndërtimit	Një herë në vit	Operatorët e impianteve

Burimi: Ekipi Studimor i JICA-s

13.5.6 TeR të Rekomanduara për Planet e Propozuara

(1) Kërkesa e Përgjithshme në Sistemin Shqiptar të VNM

Projektet e propozuara në këtë sektor do të zhvillojnë objektet e furnizimit me ujë me kapacitetin e tyre duke tejkaluar me 100 milionë m³/vit, e cila kërkon VNM e Thelluar në bazë të sistemit ligjvënës shqiptar. Megjithatë, impianti i pastrimit të ujit do të zgjerohet në impiantin ekzistues të Bovillës dhe mund të ketë ndikim më të vogël në mjedis. Vendimi i lejes mjedisore, nëse VNM e Thelluar ose IEE është e nevojshme varet nga autoriteti shqiptar i mjedisit. Në këtë seksion, TeR për kryerjen e një VNM të thelluar duhet të përgatiten në supozimin se kjo është e nevojshme

(2) Kërkesat Bazë e Dokumentit të VNM së Thelluar

Të njëjtat kërkesa, që tashmë janë përmendur në sektorët të mëparshëm duhet të përfshihen edhe në dokumentet e VNM-së.

(3) Konsultimi me Palët e Interesuara

Palët e interesuara në vijim duhet të përfshihen në procesin e hartimit të miratimit të VNM dhe përgatitjen e dokumenteve të VNM në këtë sektor.

- Propozuesi i Projektit: Ministria e Punëve Publike dhe Transportit, UKT(DPUK)
- Agjencia mbikëqyrëse për VNM: Ministria e Mjedisit
- Bashkitë: Bashkitë, minibashkitë
- Përfituesit: Qytetarët
- Banorët e prekur: Banorët vendas
- Të tjera: Universiteti ose grupet e OJQ-ve

(4) Shqyrtimi i Qëllimit të Punës së Vlerësuar në Dokumentet e VNM së Thelluar

Projekti i propozuar është bazuar kryesisht në sistemin ligjor shqiptar të VNM do të zbatohet duke shfrytëzuar fondet e donatorëve ndërkombëtarë, si: Banka Botërore apo JICA. Prandaj, dokumentet e VNM duhet të ndjekin manualin operacional të donatorëve apo udhëzimet për shqyrtimin mjedisor dhe social.

Për përgatitjen e dokumenteve të VNM për secilin sektor duhet të merren këto konsiderata, siç tregohet në Tabelën 13.5.6 .

Tabela 13.5.6 Çështjet e Rekomanduara për Përgatitjen e Dokumentit të VNM

Tema	Çështja	Veprimi që do të Kërkohej
Situata Sociale & Mjedisore Bazë	Infrastruktura Sociale Ujërat nëntokësore Ndotja e Ajrit / Ngrohja Globale Ndotja e ujit Zhurma	Konsultimi me palët e interesuara Identifikimi i shërbimeve sociale të prekura (psh. uji, energjia elektrike, linjat telefonike) Identifikimi i mjedisit ekzistues shoqëror Identifikimi i mjedisit ekzistues natyror Monitorimi i ujërave nëntokësore Monitorimi i cilësisë së ajrit Monitorimi i cilësisë së ujit Monitorimi i nivelit të zhurmës
Konsultimi me palët e interesuara	Shpërndarja e informacionit	Takimet konsultative me publikun Përfshirja e opinionit publik Regjistrimi i rezultateve të takimit
Plani i ndërtimit	Problemet mjedisore gjatë fazës së ndërtimit	Përgatitja e dokumenteve të tenderit, që mbulojnë masat zbutëse gjatë ndërtimit Kërkesë për të përgatitur një plan ndërtimi & afatin e përcaktuar të masave lehtësuese dhe plani i monitorimit
Ndikimet e mundshme	Të gjitha çështjet mjedisore	Vlerësimi i ndikimeve të mundshme të drejtpërdrejta dhe të tërthorta
Masat lehtësuese	Infrastruktura sociale Rreziku Ujërat nëntokësore Mbetjet e ngurta Ndotja e Ajrit / Ngrohja Globale Ndotja e ujit Zhurma	Njoftimi i autoriteteve përkatëse dhe miratimi i tyre Përgatitja e sigurisë dhe planit të menaxhimit shëndetësor Përgatitja e trajtimit dhe asgjësimit të llumrave të trajtuar Parandalimi i ndotjes gjatë ndërtimit Përgatitja e planit të monitorimit të mjedisit
Plani i monitorimit mjedisor	Toka / Plan Zhvendosja Minoritetet etnike në nevojë Trashëgimia kulturore Infrastruktura Sociale Rreziku Shëndeti Publik Ndotja e Ajrit / Ngrohja Globale Ndotja e ujit Zhurma	Përgatitja e planit të monitorimit Zbatimi i monitorimit të para, gjatë ndërtimit dhe në fazën e funksionimit

Burimi: Ekipi Studimor i JICA-s

13.6 Rekomandimet për Veprime

(1) Çështjet që do të merren parasysh në zbatim

Përpara se të vazhdohet me zbatimin e projekteve parësore duhet të merren parasysh këto çështje:

- Vëllimi vjetor, që del nga Diga e Bovillës, sipas personelit të UKT është 20 000 000 m³. Ky vëllim uji duhet të riverifikohet përpara fillimit të projektit. Përmasat e linjës kryesore të ujit të patrajtuar dhe zgjerimi i Digës së Bovillës duhet të përcaktohen saktësisht.
- Para futjes së sistemit të hartës, UKT duhet të kryejë hulumtime të hollësishme dhe analizimin e veçorive të tubacioneve (materiali, diametri, koha e përdorimit, vendndodhja dhe të dhënat e prurjeve) duke përfshirë valvulat dhe hidrantët e zjarrit.
- Sistemi i mini-hidrogjeneratorit të energjisë për shkak të efektit të tij të shpejtë është propozuar si projekti i parë parësor. Përveç sistemit të propozuar në ITU e Bovillës, e cila prodhon 200 kW energji elektrike, instalimi shtesë i të njëjtit sistem të ri në tubacionin e transportimit të ujit me diametër 800mm, mund të prodhojë edhe 70kË më shumë energji elektrike, duke bërë të mundur edhe më tepër uljen e kostos.
- Meqë monitorimi dhe menaxhimi i të dhënave të cilësisë së ujit si, psh: mbetjet e klorit, turbullira dhe trysnia e ujit në qendrën e kontrollit të UKT ose ITU së Bovillës është e dobishme për kontrollin e saktë të shpërndarjes së ujit dhe përmirësimin e nivelit të shërbimit, futja e sistemit automatik të monitorimit të cilësisë së ujit duhet të merret parasysh për tu realizuar në një të ardhme të afërt.

14. Planveprimi për Zhvillimin e Sistemit të Kanalizimit dhe Largimit të Ujërave të Shiut

14.1 Të përgjithshme

(1) Rëndësia e Plan Veprimit të Zgjedhur

Një plan veprimi për zhvillimin e sistemit të largimit të ujërave të shiut nuk është propozuar duke pasur parasysh se sistemi ekzistues i largimit të ujërave të shiut është në fakt pjesë e kombinuar e sistemit të kanalizimeve dhe do të jetë e vështirë që të ketë një diskutim të veçantë të saj.

Në listën e projekteve që përbëjnë projektin parësor në Pjesën I të këtij raporti, ekzistojnë dy projekte të njëpasnjëshme si për Zonën e Rajonit të Kanalizimit, nga e cila Faza I është në punë e sipër dhe zona e shërbimit të Fazës II është përcaktuar si vijon:

- 1) Zona qendrore dhe veriore e Bashkisë së Tiranës, tani të mbuluara nga dy kolektorë të mëdhenj, kolektori i Tiranës dhe ai i rrugës së Dibrës;
- 2) Zona përfundimtare strategjike e rëndësishme e Bashkisë së Tiranës; dhe
- 3) Komuna e Paskuqanit, e cila pritet të zhvillohet së bashku me Bashkinë e Tiranës përgjatë bulevardit qendror dhe lumit të Tiranës.

Këto zona ndodhen në qendër të Zonës së Tiranës së Madhe dhe përmirësimi i mjedisit të zonës është një përparësi e lartë.

(2) Përmirësimet e Projektit

Nga karakteristikat e punimeve të kanalizimeve, trajtimi i ujërave të zeza është një projekt i përmirësimit të mjedisit nga i cili do të përfitojnë një numër i madh banorësh, që jetojnë rreth aksit pritës të ujit, ndërsa projekti i mbledhjes së ujërave të zeza, kryesisht punimet e montimit të tubacioneve të kanalizimeve, ndikon drejtpërdrejt tek banorët vendas dhe ky Projekt mund të identifikojë lehtë përfituesit për mbledhjen e tarifës së ujërave të zeza. Në analizën ekonomike dhe financiare, projekti parësor është i ndarë në dy projekte, që janë, projekti i trajtimit të ujërave të zeza dhe ai i grumbullimit të ujërave të zeza i bazuar në karakteret e tyre të ndryshme. Edhe kostoja e projektit është e ndarë në këto dy projekte para analizës.

14.2 Zërat e Projekteve Parësore

(1) Përmbledhje e Përbërësve të Projektit Parësor

Përbërësit e projektit Parësor janë përshkruar në Tabelën 14.2.1 respektivisht sipas fazës.

Periudha e ndërtimit për Fazën II të projektit të Kasharit pritet të jetë nga 2016 - 2021 (6 vjet) dhe projekti i zgjerimit është 2024-2026 (3 vjet).

Impianti i Trajtimit të Ujërave të Zeza (ITUZ) për Fazën II të projektit nuk ka asnjë dhomë rëre meqë ujërat e zeza pompohen nga SP Kashar dhe në stacionin e pompimit është hequr tashmë një pjesë e madhe e zhavorrit. Në figurën 14.2.1 është treguar një organigramë e procesit të trajtimit në ITUZ.


Projekti parësor i hartës së zonës dhe vendit të ITUZ janë paraqitur në Figurën 14.2.2 dhe 14.2.3. Në figurën 14.2.4 është treguar konfigurimi i linjës kryesore të kanalizimeve.

Zgjerimi i vëllimit përfshin vëllimin e tepërt nga ITUZ i Fazës I, kapaciteti i të cilit është projektuar për vitin e synuar të 2013.

Tabela 14.2.1 Përbërësit e Projektit Parësor


Projekti	Faza II e Projektit RK Kashar	Projekti i Zgjerimit RK Kashar
Periodha e Ndërtimit	2016 deri në 2021	2024 deri në 2026
Impianti i Trajtimt të Ujërave të Zeza Kashar	Zgjerimi i vëllimit: 159 200 m ³ /d (Maksimumi ditor) Metoda dytësore e trajtimit është Filtri Rrjedhës Metoda e trajtimit të llumit Trashësia, Tretja, Shtrati i tharjes së llumit dhe Procesi i largimit të ujit.	Zgjerimi i vëllimit: 67 400 m ³ /d (Maksimumi ditor) Metoda e trajtimit është e njëjtë si në planin e Fazës II
Stacioni i Pompimit Kashar	SP Kashar: 141 m ³ /min (Maksimumi i orës)	Zgjerimi i stacionit të pompimit Kashar 65m ³ /min (Maksimumi i orës)
Kolektori kryesor	Kolektori kryesor 250 mm – 2 000 mm 10,3 km (përfshirë 2,9 km x 2 prej 1 000 mm tubacion nën presion)	Kolektori kryesor (Tubacion nën presion) 1 000 mm 2,9 km
Linja Kryesore dhe Degëzimi	Kanalizime kryesore & degëzime 200 mm – 600 mm 79,6 km	-
Sipërfaqja e Zonës	18,0 ha (për zgjerimin e ITUZ) 0,7 ha (për SP Kashar)	11,3 ha (për zgjerimin në të ardhmen)

Burimi: Ekipi Studimor i JICA-s




Burimi: Ekipi Studimor i JICA-s

Figura 14.2.1 Skema e Procesit të Trajtimt në ITUZ




Burimi: Ekipi Studimor i JICA-s

Figura 14.2.2 Harta e Zonës së Projektit Parësor



Burimi: Ekipi Studimor i JICA-s

Figura 14.2.3 Zona e Ndërtimit të ITUZ



Burimi: Ekipi Studimor i JICA-s

Figura 14.2.4 Konfigurimi Linjës Kryesore në Zonën e Projektit Parësor

Në Tabelën 14.2.2 është përmbledhur kostoja e ndërtimit të projektit parësor. Përfshihet vetëm kostoja e drejtpërdrejtë e ndërtimit, ndryshe nga analiza ekonomike dhe financiare e përshkruar në nënkapitullin 14.5, i cili përfshin shpenzimet indirekte. Plani vjetor i investimeve për secilin objekt të projektit parësor është treguar në Tabelën 14.2.3.

Tabela 14.2.2 Kostoja e Projektit Parësor

								Unit: Million Lek		
Component		Kashar 2nd Phase			Kashar Expansion project			Project Total		
		FC	LC	Total	FC	LC	Total	FC	LC	Total
Direct Construction Cost										
	Trunk Sewer	2167	272	2,439	101	13	114	2,268	285	2,553
	Main Sewer		1748	1,748			0	0	1,748	1,748
	Kashar PS	328	298	626	299	26	325	627	324	951
	Kashar STP	2626	2598	5,224	1,114	911	2,025	3,740	3,509	7,249
	Total of Direct Construction Cost	5,121	4,916	10,037	1,514	950	2,464	6,635	5,866	12,501

Burimi: Ekipi Studimor i JICA-s

Tabela 14.2.3 Kostoja Vjetore e Investimit

Item	Year	2016	2017	2018	2019	2020	2021	2022	2023	2024	2025	2026
Kasahar STP	C&A	232.7	698.1	698.1	465.4	232.7				91.1	546.6	273.3
	M&E			289.7	579.4	869.1	1,158.8				557.0	557.0
Kashar PS	C&A			134.5	134.5							
	M&E					178.5	178.5				162.5	162.5
Trunk Main Sewer	C&A	677.3	704.4	487.8	487.8	54.4	27.2					114.0
Main&Branch Sewer	C&A	174.8	524.4	349.6	349.6	174.8	174.8					
Land Acquisition		90.0								57.0		
Capacity Building							109.1					

Burimi: Ekipi Studimor i JICA-s

(2) Hapat e Zhvillimit në Zonën e Fazës II

Hapat e zhvillimit për zonën e Fazës II rekomandohen siç është treguar në Tabelën 14.2.4.

Shmangia e ujërave të zeza të kolektorit të Tiranës në linjën kryesore të kanalizimeve është hapi i parë i Fazës II të projektit, meqë shkarkimi i ujërave të zeza të papërpunuara nga kjo derdhje ka një potencial të lartë për ndotjen e rrjedhës së poshtme të lumit Lana.

Shtrimi i tubacionit të kanalizimit në pjesën perëndimore të Bashkisë së Tiranës dhe Komunës së Kasharit ka më shumë përparësi se në zonat e Komunës së Paskuqanit dhe të Kodër-Kamzës, meqë ato janë si ish zona strategjike për zhvillimin e zonës së Tiranës së Madhe.

Tabela 14.2.4 Hapat e Planit të Zhvillimit për Zonën e Fazës II RK Kashar

Fazë	Përmbledhje e Zhvillimit	Objektet Kryesore që do të Zhvillohen	Zona e Zhvillimit
1	Ujërat e zeza derdhen në lumin e Lanës nëpërmjet kolektorit të Tiranës i cili mbledhet në SP të Kasharit nëpërmjet tubacionit kryesor me rrjedhje të lirë dhe pastaj pompohet deri në Fazën II ITUZ Kashar.	- Strukturë kapërderdhëse në kolektorin e Tiranës - Linja Kryesore nga pika e Devijimit për në Sp të Kasharit - Linja kryesore (Forca Kryesore) nga SP të Kasharit në Fazën II të ITUZ Kashar - SP Kashar - Faza II ITUZ Kashar	
2	Rrjeti i kanalizimeve është zhvilluar në zonën përgjatë kolektorit kryesor, në veri-perëndim të Bashkisë së Tiranës dhe në qendër të zonës së Komunës Kashar, meqë tashmë këto zona janë banuar dendur dhe të urbanizuara. Zona e Zhvillimit Kashar me popullsi 225.000 banorë do të ketë shërbim kanalizimesh, i cili është në proces.	- Linja Kryesore e kanalizimit nga Lumi i Tiranës për në Linjën Kryesore - Dega e kanalizimit është instaluar brenda zonës me ngjyrë vjollcë të treguar në figurë.	
3	Rrjeti i kanalizimeve është zhvilluar në pjesën e jashtme përtej Lumit të Tiranës, Paskuqan dhe Kodër-Kamëz. Zona e Fazës II në pjesën lindore do të ketë kanalizime në këtë fazë.	- Kanalizimi kryesor nga Paskuqani dhe Kodër-Kamza duke kaluar lumin e Tiranës - Zhvillimit i degës së kanalizimit në zonën e caktuar më sipër dhe gjithashtu në zonën lindore të Fazës II të projektit. Shih Figurën në të djathtë.	

Burimi: Ekipi Studimor i JICA-s

(3) Transformimi në “Projektin e Mbledhjes së Ujërave të Zeza” dhe “Projektin e Trajtimit të Ujërave të Zeza”


Për analizën ekonomike dhe financiare, 1) Projektin e Mbledhjes së Ujërave të Zeza dhe 2) Projektin e Trajtimit të Ujërave të Zeza janë krijuar për tu përqendruar, përkatësisht në "mbledhje" dhe "trajtim".

Kostoja e ndërtimit, duke përfshirë koston e truallit dhe koston e rritjes së kapaciteteve është alokuar për secilin projekt, siç tregohet në Tabelën 14.2.5. Në Tabelë, një pjesë e koston së linjës kryesore të kanalizimit dhe Stacionit të Pompimit Kashar është ndarë për çdo projekt në përputhje me numrin e përfituesve. Koncepti për ndarjen është paraqitur në Figurën 14.2.4 dhe raporti i alokimit është treguar në Tabelën 14.2.6.

Tabela 14.2.5 Alokimi i Koston për Analizën Ekonomike/Financiare

		Grumbullimi i Ujërave të Zeza	Trajtimi i Ujërave të Zeza	Gjithsej	Shënime
ITUZ Kashar	Faza II e Projektit	0	5,224	5,224	
	Projekti Zgjerimit	0	2,025	2,025	
Stacioni i Pompimit Kashar	Faza II e Projektit	213	413	626	Grumbullim : Trajtim = 0.34 : 0.66
	Projekti Zgjerimit	325		325	
Kolektori Kryesor i Kanalizimeve	Faza II e Projektit	829	1,610	2,439	Grumbullim : Trajtim = 0.34 : 0.66
	Projekti Zgjerimit	114		114	
Kanalizimet Kryesore & Degëzimet	Faza II e Projektit	1,748	0	1,748	
	Projekti Zgjerimit			0	
Shuma	Faza II e Projektit	2,790	7,247	10,037	
	Projekti Zgjerimit	439	2,025	2,464	
	Gjithsej	3,229	9,272	12,501	
Vendi i ITUZ	Faza II e Projektit	0	90	90	
	Projekti Zgjerimit	0	57	57	
Ngritja e Kapaciteteve	Faza II e Projektit	21.8	87.3	109.1	Grumbullim : Trajtim = 0.2 : 0.8
	Projekti Zgjerimit				
Shuma	Faza II e Projektit	2,812	7,424	10,236	
	Projekti Zgjerimit	439	2,082	2,521	
	Gjithsej	3,251	9,506	12,757	

Burimi: Ekipi Studimor i JICA-s



Burimi: Ekipi Studimor i JICA-s

Figura 14.2.5 Koncepti për Alokimin


Tabela 14.2.6 Alokimi i Kostos për Analizën Ekonomike dhe Financiare

Klasifikimi	Përmbajtja	Popullsia	Përqindja
Projekti mbledhjes	Numri i klientëve të rinj të lidhur me kanalizimet në 2022 (tarifa e ujërave të zeza mund të mbledhet prej tyre.)	156 369	34%
Projekti Trajtimit	Numri i klientëve ekzistues brenda zonës së kanalizimeve në 2022 (nuk do të ngarkohet tarifë shtesë)	302 558	66%
Punimet e Linjave Kryesore dhe SP të Kasharit kontribuojnë në të dy projektet dhe kështu kostoja është e ndarë midis tyre me normën e alokimit lart			

Burimi: Ekipi Studimor i JICA-s

14.3 Projekti i Mbledhjes së Ujërave të Zeza


Ky projekt konsiston kryesisht punimet e ndërtimit të tubacionit në zonën e kuqe, e paraqitur më poshtë në Figurë 14.3.1.



Burimi: Ekipi Studimor i JICA-s

Figura 14.3.1 Zona e Mbledhjes së Ujërave të Zeza

Zona e mbledhjes është 2 464 ha dhe popullsia e shërbyer rritet nga 2022-2030 siç është paraqitur në Figurën 14.3.2.



Burimi: Ekipi Studimor i JICA-s

Figura 14.3.2 Rritja e Popullsisë së Shërbyer

Kostoja e ndërtimit dhe kostoja e rritjes së kapaciteteve të ndërtimit për këtë projekt janë përmbledhur siç tregohet në Tabelën 14.3.1. Pjesë e kostonë së linjës kryesore të kanalizimit dhe kostoja e stacionit të pompimit është përfshirë në këtë projekt të sistemit të mbledhjes.

Tabela 14.3.1 Kostoja e Investimit

(Milionë lekë)


	Investimi Fillestar (2016 deri në 2021)	Faza e Zgjerimit (2024 deri në 2026)	Totali
Kanalizimi Kryesor dhe Degëzimi 0,3 m to 0,6 m L=79,6 km	1 748	-	1 748
<u>Pjesë e</u> Kanalizimit Kryesor 0,25 m to 2,0 m L=10,3 km	829	114	943
<u>Pjesë e</u> SP Kashar Q=141 m ³ /min(Faza fillestare) Q=206 m ³ /min (Faza fillestare)	213	325	538
(Totali)	(2 790)	(439)	(3 229)
Kapaciteti i Ndërtesës	21,8	-	21,8
(Totali)	2 811,8	439	3 250,8

Burimi: Ekipi Studimor i JICA-s

*Kostoja F&M në 2022 është 42,9 milionë lekë dhe duke u rritur gradualisht deri në vitin 2030..


14.4 Projekti i Trajtimit të Ujërave të Zeza

Ky projekt përbëhet kryesisht prej punimeve të ndërtimit të ITUZ. Ujërat e zeza që do të trajtohen në ITUZ do të vijnë nga jo vetëm nga zona e projektit të mbledhjes së ujërave të zeza, por edhe të zonës ekzistuese ku nuk do të vendoset tarifë e re. Zona e shërbimit është e tërë zona e Fazës II Kashar, e paraqitur në Figurën 14.4.1, që mbulon 3 885 ha. Rritja në popullsinë e shërbyer është paraqitur në Figurën 14.4.2.



Burimi: Ekipi Studimor i JICA-s

Figura 14.4.1 Zona e Shërbimit për Impiantet e Fazës II të ITUZ Kashar



Burimi: Ekipi Studimor i JICA-s

Figura 14.4.2 Rritja e Numrit të Popullsisë që do të Trajtohet

Kostoja e ndërtimit dhe e rritjes së kapaciteteve të ndërtimit për këtë projekt janë përmbledhur siç tregohet në Tabelën 14.4.1. Pjesë e kostonë së linjës kryesore të kanalizimit dhe kostoja e stacionit të pompimit është përfshirë në këtë projekt të sistemit të mbledhjes

Tabela 14.4.1 Kostoja e Investimit

(Milionë lekë)

	Investimi Fillestar (2016 deri në 2021)	Faza e Zgjerimit (2024 deri në 2026)	Totali
Kapaciteti i ITUZ Kashar Faza II : 159 200 m ³ /d Zgjerimi : 226 600 m ³ /d	5 224	2 025	7 249
<u>Pjesë e</u> Kanalizimit Kryesor 0,25 m to 2,0 m L=10,3 km	1,610	-	1 610
<u>Pjesë e</u> SP Kashar Q=141m ³ /min (Faza fillestare) Q=206m ³ /min (Faza fillestare)	413	-	413
(Gjithsej)	(7 247)	(2 025)	(9 272)
Kapaciteti i Ndërtësës	87,3	-	87,3
Kostoja e Tokës	90	57	
Gjithsej	7 424,3	2 082	9 506,3

Burimi: Ekipi Studimor i JICA-s

*Kostoja F&M në 2022 është 137 milionë lekë dhe duke u rritur gradualisht deri në vitin 2030..

14.5 Analiza Financiare dhe Ekonomike

14.5.1 Analiza Financiare

Në këtë seksion është kryer një vlerësim financiar i mbledhjes së ujërave të zeza duke krahasuar shpenzimet dhe të ardhurat. Grafiku i lëvizjes së parasë është përgatitur bazuar në supozimet e paragrafëve të mëposhtëm dhe Norma e Brendshme e Rikthimit Financiar (NBRF) në projekt është llogaritur për vlerësim.

Nuk është bërë një vlerësim financiar i projektit të trajtimit të ujërave të zeza. Është hamendësuar se projekti duhet të financohet nga publiku meqë ai nuk pritet të krijojë të ardhura në kohën e studimit.

(1) Hamendësimet Bazë

Në vijim janë dhënë hamendësimet bazë që përdoren për analizën financiare të projektit të mbledhjes së ujërave të zeza. Kjo vlen edhe për analizën ekonomike të projektit të trajtimit të ujërave të zeza, vetëm nëse nuk është përmendur ndryshe.

1) Periudha e Projektit

Periudha e projektit është 35 vjet nga viti 2016 deri në 2051, duke përfshirë edhe periudhën e ndërtimit 2016-2021 dhe 2024-2026, dhe periudha e vlerësimit 2022-2051.

2) Çmimet Bazë dhe Kursi i Këmbimit

Viti bazë i këtij projekti është 2012. Të gjitha shpenzimet dhe të ardhurat janë shprehur sipas çmimeve të vitit 2012. Studimi hamendëson 3,0% normën vjetore të inflacionit gjatë kohëzgjatjes së projektit, e cila është shkalla e synuar e inflacionit e përcaktuar nga Banka e Shqipërisë për vitin 2012.

Kurset e këmbimit të përdorura janë 1 lekë = JPY 0,788 = Euro 0,007 = USD 0,009, të cilat janë normat mbizotëruese në kohën e studimit.

3) Kontigjenca

Në analiza janë përfshirë punime të paparashikuara prej 10%. Çmimi nuk është përfshirë.

4) Taksat

Për analizën financiare, tatimi mbi vlerën e shtuar (TVSH) prej 20% është i përfshirë, ndërsa taksa e korporatave është përjashtuar.

5) NBRF e Synuar e Projektit

Është hamendësuar se UKT, do të kenë mundësi për të marrë kredi bankare dhe/ose do të vërë në dispozicion të ardhurat e saj për të paguar për projektin e grumbullimit të ujërave të zeza Normat mbizotëruese afatgjata të kreditimit të korporatave e bankave tregtare në Shqipëri janë deri në 13,0% në kohën e Studimit. Norma reale e interesit është llogaritur në 9,7%, duke zbritur normën e prituri të inflacionit prej 3,0% për vitin 2012 ($1,13/1,03$ (norma e inflacionit) - 1 = 0,097).

Për këtë arsye, NBRF e synuar e projektit të grumbullimit të ujërave të zeza, duhet të ndryshojë në varësi të peshës së burimeve financiare ndërmjet parave kesh të vetë UKT dhe kredisë bankare.

(2) Kostot Financiare të Projektit

Kostot financiare përfshijnë koston e investimit të projektit dhe kostot e funksionimit e mirëmbajtjes (F&M).

1) Kostot e Investimit

Kostot financiare të investimit të projekteve janë llogaritur në bazë të koston totale inxhinierike të investimit të paraqitura si në nënkapitujt e mëparshëm.

Kostot e Investimit Fillestar

Tabela 14.5.1 tregon kostot e investimit deri në 2021, Faza II e projektit, por analiza financiare dhe ekonomike përfshin investimin e projektit të zgjerimit. Kostoja financiare e investimit fillestar është konvertuar në çmimet e tregut.

Tabela 14.5.1 Kostot Financiare e Investimit Fillestar

(Milionë lekë)

	Grumbullimi i Ujërave të Zeza	Trajtimi i Ujërave të Zeza
Trualli	-	96,5
Punët Civile	2 223,9	3 428,6
Makineri dhe Pajisje	101,2	2 610,5
Ngjitja e Kapaciteteve	18,2	72,8
Gjithsej	2 343,3	6 201,8
Shërbimi i Konsulencës (10%)	234,3	611,2
TVSH (20%)	515,5	1 344,6
Kosto Bazë	3 093,1	8 157,6
Kontigjenca Fizike (10%)	309,3	815,8
Kosto e Përgjithshme Financiare e Investimit	3 402,4	8 973,4

*Kostot e tokës nuk përfshijnë TVSH apo shërbimin e konsulencës.

Burimi: Ekipi Studimor i JICA-s

Kostot e Amortizimit

Kostot e amortizimit, nëse është e nevojshme, janë të përfshira në vitet përkatëse bazuar në jetëgjatësinë ose amortizimin e aseteve përkatëse, siç jepet në Tabelën 14.5.2.

Tabela 14.5.2 Jetëgjatësia e Pritur e Aseteve

	Mbledhja e Ujërave të Zeza	Trajtimi i Ujërave të Zeza
Punët Civile	50 vjet	50 vjet
Makineri & Pajisje	15 vjet	15 vjet

Burimi: Ekipi Studimor i JICA-s

Në analizë nuk është marrë parasysh vlera e rikuperimit nga shitja e aseteve në fund të jetës.

2) Kostot e Funksionimit

Kostot financiare të funksionimit të Rastit të Projektit janë paraqitur në Tabelën më poshtë, siç llogaritet në nënkapitujt e mëparshëm.

Tabela 14.5.3 Kostot Vjetore të Funksionimit dhe Mirëmbajtjes në 2030-2051

(Milionë lekë)

	Mbledhja e Ujërave të Zeza	Trajtimi i Ujërave të Zeza
Personeli	10,8	12,0
Shërbime/kimikate		28,0
Energji	27,9	113,5
Mirëmbajtje/riparim	14,0	19,8
Asgjësimi i Llumit	-	13,7
Totali	52,7	187,0

Burimi: Ekipi Studimor i JICA-s

(3) Të Ardhurat Financiare të Projektit

1) Projekti i Grumbullimit të Ujërave të Zeza

Numri i Përdoruesve

Numri i përdoruesve sipas kategorive, dmth, familjet dhe përdoruesit e tjerë (ndërmarrjet private dhe institucionet publike) është vlerësuar në bazë të të dhënave të vitit 2012 të siguruar nga ERRU (Enti Rregullator i Sektorit të Furnizimit me Ujë dhe Largimit e Përpunimit të Ujërave të Ndotur).

Tabela 14.5.4 Përdoruesit e Mbledhjes së Ujërave të Zeza

	2022	2023	2024	2025	2026	2027	2028	2029	2030-2051
Popullsia	156 369	183 167	209 965	236 763	263 561	290 359	317 157	343 955	370 753
Familje	26 962	31 583	36 204	40 824	45 445	50 066	54 687	59 307	63 928
Te tjerë*	3 596	4 212	4 828	5 444	6 060	6 677	7 293	7 909	8 525

*Të tjerë, përfshin ndërmarrjet private dhe institucionet publike.

Burimi: Ekipi Studimor i JICA-s

Tarifa e Grumbullimit të Ujërave të Zeza

Ecuria e tarifës është treguar më poshtë.

Tabela 14.5.5 Ecuria Historike e Tarifës*

(lekë/m³)

Kategoria e Përdoruesit	2002-2009	2010-2011	2012
Familje	5	10	11
Ndërmarrje Private	10	25	35
Institucion Publik	6	25	30

*Shifrat tregojnë çmimet aktuale.

Burimi: ARSH

Është planifikuar që në vitin 2014 UKT do të rrisë tarifën, siç është paraqitur më poshtë. Për më tepër, vëllimi i ujërave të zeza, që është vlerësuar tani në 80% të vëllimit të ujit, pas vitit 2013 do të llogaritet si 100% e vëllimit të ujit.

Tabela 14.5.6 Faktorët e Strukturës së Tarifës për Blloqe të Ndryshme Konsumi dhe Përdoruesish

Kategoria e Përdoruesit	Blloqet e Strukturës së Tarifës (metër kub/muaj)			
	< 4 ,5	4 ,5 deri në 20	20 deri në 30	> 30
Familje	1 ,0*	1 ,0 deri në 3 ,0	1 ,5 deri në 4 ,0	2 ,5 deri në 6 ,0
Institucion Publik	1 ,0 deri në 2 ,0	1 ,0 deri në 3 ,0	1 ,5 deri në 5 ,0	2 ,5 deri në 10 ,0
Ndërmarrje Private	1 ,0 deri në 2 ,0	1 ,5 deri në 4 ,0	2 ,0 deri në 6 ,0	3 ,0 deri në 12 ,0

* Faktori = shumëzuar me tarifën aktuale
Burimi: ERRU

Shkalla e Mbledhjes së Tarifës së Projektit të Grumbullimit të Ujërave të Zeza

Shkalla e mbledhjes është llogaritur për tu përmirësuar si më poshtë.

Tabela 14.5.7 Shkalla Mesatare e Mbledhjes së Tarifës

2011	2012	2022	2026	2030
90,0%	92,0%	94,7%	95,9%	97,0%

Burimi: ERRU dhe Ekipi Studimor i JICA-s

Megjithatë, analiza financiare përdor normën e mbledhjes prej 100% dhe supozon se shuma e pambledhur do të kompensohet nga UKT-ja dhe jo duke u paguar nga përdoruesit.

Ta Ardhurat e Projektit të Grumbullimit të Ujërave të Zeza

Të ardhurat e projektit të grumbullimit të ujërave të zeza janë llogaritur bazuar në supozimet e mësipërme dhe janë pasqyruar në Tabelën që vijon. Supozohet se vëllimi mesatar i ujërave të zeza për çdo përfitues do të mbetet i qëndrueshëm nga viti 2012 e tutje.

Tabela 14.5.8 Ta Ardhurat e Tarifës së Ujërave të Zeza

	(Milionë lekë)	
	2022	2030-2051
Familje	73	173
Përdorues të tjerë	149	354
Totali	222	527

Burimi: Ekipi Studimor i JICA-s

2) Projekti i Trajtimit të Ujërave të Zeza

Popullsia e mbuluar me shërbimin e trajtimit të ujërave të zeza, siç tregohet në Tabelën më poshtë, tregon një rritje graduale nga 2022-2030 dhe pastaj një prirje të qëndrueshme deri në vitin 2051.

Tabela 14.5.9 Përdoruesit e Trajtimit të Ujërave të Zeza (Popullsia)

2022	2023	2024	2025	2026	2027	2028	2029	2030-2051
458 927	485 725	512 523	539 321	566 119	592 917	619 715	646 513	673 311

Burimi: Ekipi Studimor i JICA-s

Për projektin e trajtimit të ujërave të zeza është supozuar se nuk ka të ardhura financiare.

(4) Vlerësimi Financiar

NBRF-të e projektit të grumbullimit të ujërave të zeza për tre tarifat e ndryshme të mëposhtme janë llogaritur bazuar në supozimet e mësipërme dhe janë pasqyruar në Tabelën në vijim. NBRF është minus 2,0% në tarifën e tanishme (Rasti 1) dhe është 7,4% në tarifën e rritur të planifikuar të vitit 2014 (Rasti 2).

UKT duhet të jetë në gjendje për të financuar projektin me fonde, që përfshijnë financimet e saj dhe një kredi bankare. UKT duhet të rrisë tarifën siç është planifikuar në vitin 2014.

Për hir të krahasimit, Rasti 3 (tarifa e përballueshme) është përfshirë në Tabelë. Tarifa e përballueshme e mbledhjes së ujërave të zeza është supozuar të jetë e njëjtë me shumën e atyre që “dëshirojnë për të paguar”, ose 1% e ardhurave të disponueshme të përdoruesit bazuar në analizën e Bankës Botërore¹. NBRF e projektit në tarifën e përballueshme është 13,6%.

Tabela 14.5.10 Përmbledhja e NBRF e Projektit të Mbledhjes së Ujërave të Zeza

	Kostoja e Investimit Fillestar (mil. lekë)	Tarifa Mujore sipas Familjeve në 2022 (lekë)	NBRF e Projektit
Rasti 1 (Tarifa aktuale)	3 402	110,2	-2,0%
Rasti 2 (rritja e planifikuar në 2014)	3 402	225,9	7,4%
Rasti 3 (tarifa e përballueshme)	3 402	692,3	13,6%

Burimi: Ekipi Studimor i JICA-s

Grafiku i lëvizjes së financimit të projektit të grumbullimit të ujërave të zeza sipas skenarit të Rastit 2 është bashkangjitur në shtojcë.

14.5.2 Analiza Ekonomike

Në këtë nënkapitull është kryer analiza ekonomike për (1) projektin e grumbullimit të ujërave të zeza dhe (2) projektin e trajtimit të ujërave të zeza.

(1) Hamendësimet për Analizën Ekonomike

Përveç hamendësimeve bazë të përmendura më sipër për analizën financiare, në analizën ekonomike janë zbatuar hamendësimet e mëposhtme.

1) Rregullimet e Kostove Financiare dhe Përfitimet

Në parim, kostot dhe përfitimet ekonomike janë të përjashtuara nga detyrimet fiskale, si: taksat, dhe subvencionet. Shpenzimet e projektit dhe përfitimet janë përjashtuar nga TVSH-ja prej 20%.

2) Norma e Brendshme e Rikthimit Ekonomik (NBRE) e Synuar

NBRE është një indeks i frytshmërisë së përdorimit të kapitalit të pamjaftueshëm, duke treguar përqindjen mesatare të kthimit, që mund të pritët çdo vit për ekonominë kombëtare përmes investimeve të planifikuara. Institucionet financiare ndërkombëtare, si Banka Botërore dhe Banka Aziatike e Zhvillimit zbatojnë normën e zbritjes sociale prej 10% deri në 12% në vendet në zhvillim.

Projekti përcakton NBRE e synuar në 10%. Kjo do të thotë, nëse NBRE e projektit është më e madhe se 10%, projekti është ekonomikisht i mundshëm dhe duhet të sjellë përfitime neto për ekonominë rajonale.

¹ Banka Botërore, Programi i Zhvillimit i Kombeve të Bashkuara, Qeveria e Indonezisë, *Project Appraisal Manual*, draft, 1994, p.8.

3) Gatishmëria për të Paguar si Përfitim Ekonomik

Gatishmëria për të Paguar

Projekti i Mbledhjes së Ujërave të Zeza:

Gatishmëria për të Paguar (GPP) është matja zëvendësuese e vlerës ekonomike e shprehur si “teprica e konsumatorëve” dhe për këtë arsye është shuma, që përfituesit janë të gatshëm të paguajnë në këmbim të produktit apo shërbimeve që marrin. Koncepti GPP është përdorur gjerësisht si shprehje numerike e përfitimeve ekonomike në projektin e vlerësimit. Nëse çmimi, ose tarifa në këtë rast, është më e lartë se GPP, përdoruesit nuk do ta marrin shërbimin dhe do ti përdorin paratë për produkte apo shërbime të tjera. Prandaj, GPP është quajtur si kënaqësia më e madhe, që përdoruesit mund të arrijnë në forma të ndryshme nga projekti në fjalë. Kështu që, metodologjia e “Gatishmërisë për të Paguar” është përdorur për të llogaritur përfitimet ekonomike të projektit.

Banka Botërore dhe Banka Aziatike e Zhvillimit kanë një nivel për përqindjen e të ardhurave që janë të gatshëm të paguajnë përdoruesit për shërbimet e infrastrukturës. Sipas tyre, GPP për kanalizimet është 1% e të ardhurave të zotërueshme të përdoruesve. Pra, supozohet se 1,0% e të ardhurave të zotërueshme të familjeve (60 000 lekë në muaj në vitin 2012), të jetë GPP e përfituesve familjarë për grumbullimin e ujërave të zeza.

Projekti i Trajtimit të Ujërave të Zeza:

Studimi supozon se Gatishmëria për të Paguar e projektit të trajtimit të ujërave të zeza është gjithashtu 1,0% e të ardhurave të zotërueshme të përfituesve familjarë.

Gatishmëria për të Paguar e përdoruesve të tjerë (ndërmarrjet private dhe institucionet publike) vlerësohet të jenë në përputhje me atë të familjeve për të dy projektet.

Të Ardhurat në Zotërim

Të dhënat e të ardhurave mesatare të familjeve të Prefekturës Tiranë është marrë nga Vrojtimi i të Ardhurave Mujore sipas Prefekturës, 2006-2007 (Instituti i Statistikave, Shqipëri). Shuma është korrigjuar me inflacionin dhe tatimin mbi të ardhurat dhe është llogaritur të jetë 60 000 lekë në muaj në vitin 2012.

(2) Vlerësimi Ekonomik

NBRE e projektit të grumbullimit të ujërave të zeza dhe e projektit të trajtimit të ujërave të zeza është llogaritur bazuar në supozimet e mësipërme dhe është përmbledhur në Tabelën 14.5.11.

NBRE e mbledhjes së ujërave të zeza dhe trajtimit të ujërave të zeza është përkatësisht 15,4% dhe 12,4%, të cilat janë më të larta se norma e synuar prej 10,0%. Për këtë arsye mund të dilet në përfundimin se të dy projektet janë ekonomikisht të realizueshme.

Grafiku i lëvizjes së parave për projektet e grumbullimit të ujërave të zeza dhe trajtimit të tyre janë bashkangjitur në shtojcë.

Tabela 14.5.11 Përmbledhje e NBRE së Projekteve të Mbledhjes dhe Trajtimit të Ujërave të Zeza

	Projekti i Mbledhjes së Ujërave të Zeza	Projekti i Trajtimit të Ujërave të Zeza
NBRE	15,4%	12,4%

Burimi: Ekipi Studimor i JICA-s

14.5.3 Përfundim

Projekti i grumbullimit të ujërave të zeza, me rritjen e tarifave të programuara të vitit 2014, pritet të ketë një NBRF prej 7,4% dhe në këtë mënyrë UKT-ja duhet të jetë në gjendje të financojë projektin pa ndonjë subvencion publik. Megjithatë, projekti i trajtimit të ujërave të zeza duhet të financohet nga publiku meqë ai nuk pritet të prodhojë të ardhura në kohën e studimit.

Të dy projektet, ai i grumbullimit dhe ai i trajtimit të ujërave të zeza kanë NBRE të mjaftueshme (respektivisht 15,4% dhe 12,4%) dhe duhet të sjellin përfitim ekonomik neto në rajon.

Sa më sipër, arrihet në përfundimin se projekti është i zbatueshëm.

14.6 Vlerësimi Mjedisor

14.6.1 Masat Lehtësuese të Rekomanduara

Në çdo fazë të projektit është supozuar ndikimi negativ, përkatësisht, në fazën e parandërtimit, të ndërtimit dhe të funksionimit, sipas zhvillimit të planeve të propozuar nga çdo sektor. Për ndikimin negativ duhet të merren masat e duhura zbutëse në çdo fazë të projektit si më poshtë.

14.6.2 Masat Lehtësuese në Fazën e Parapërgatitore

Në Tabelën 14.6.1 është treguar lista e masave lehtësuese në fazën e parandërtimit.

Çështje e Tokës / Plan Zhvendosja

Projektet e propozuara do të kërkojnë truall për kanalizimet kryesore dhe stacionet e pompave. Projektet do të kërkojnë blerjen e truallit për të siguruar këto zona të projektit. Blerja e truallit duhet të përfshijë edhe masat e duhura për kompensimit e pronarëve të tokës.

Infrastruktura Sociale

Ky sektor do të përfshijë punimet nëntokësore të ndërtimit. Këto punime mund të ndikojnë në objektet nëntokësore, si: energjia elektrike, linjat telefonike, tubacioni i furnizimit me ujë dhe kanalizimeve. Identifikimi i këtyre shërbimeve përpara ndërtimit do të jetë i nevojshëm për t'u pasqyruar në dokumentet e tenderit ose dokumentet e kontratës të këtyre punimeve.

Tabela 14.6.1 Lista e Masave Lehtësuese në Fazën e Parapërgatitore

Sektori	Plani / Projekti	Parametrat	Ndikimi Negativ i Mundshëm	Masat Lehtësuese të Rekomanduara	Strukturat Përgjegjëse
Kanalizime / Kullim					
	1.1	Çështja e Truallit/Plan Zhvendosja (Në rastin e ndërtimit të Digës)	Ndikimet të pronarët e truallit, shkaktuar nga blerja e tokës së sheshit të projektit	Njoftim paraprak tek pronarët e truallit, qiradhënësi dhe pronari i objekteve Mbajtja e takimeve konsultative me banorët e prekur Marrëveshja ndërmjet propozuesit të projektit dhe banorëve të prekur Përgatitja e planit të monitorimit Zbatimi i Monitorimit	Ministria e Punëve Publike dhe Transportit
	1.2	Infrastruktura Sociale	Ndikimet në objektet ekzistuese (linjat telefonike, tubacionet e kanalizimeve, tubacionet e furnizimit me ujë, etj.)	Vrojtimi bazë i objekteve ekzistuese sociale Përgatitja e dokumentit të tenderit ose kontratës në lidhje me dëmshpërblimin për rastin e dëmtimit të objekteve sociale Përgatitja e planit të monitorimit	Ministria e Punëve Publike dhe Transportit

Burimi: Ekipi Studimor i JICA-s

14.6.3 Masat Lehtësuese të Rekomanduara në Fazën e Ndërtimit

Në Tabelën 14.6.2 tregohet lista e masave lehtësuese në fazën e ndërtimit dhe hollësitë e tyre.

Tabela 14.6.2 Lista e Masave Lehtësuese në Fazën e Ndërtimit

Sektori	Plani / Projekti	Parametrat	Ndikimi Negativ i Mundshëm	Masat Lehtësuese të Rekomanduara	Struktura Përgjegjëse
Sektori i Kanalizimeve / Kullimit					
	1.1	Çështja e Truallit/Plan Zhvendosja	Ndikimi që do të shkaktohet nga blerja e truallit	Zbatimi i monitorimit	
	1.2	Infrastruktura Sociale	Ndikimet në objektet ekzistuese sociale (linjat telefonike, tubacionet e kanalizimeve, tubacionet e furnizimit me ujë, etj.)	Njoftim paraprak tek agjencitë ose autoritetet përkatëse Aplikimi për leje nga autoritetet përkatëse Zbatimi i monitorimit	Ministria e Punëve Publike dhe Transportit Drejtoria e Projekteve dhe e Rrjetit Inxhinierik, BT
	1.3	Shëndeti Publik, HIV/SIDA	Ndikimet mbi punëtorët e ndërtimit gjatë ndërtimit	Përgatitja e detyrueshme e sigurisë dhe e programit të menaxhimit të shëndetit nga kontraktuesi Caktimi i një mbikëqyrësi shëndetësor Zbatimi i edukimit shëndetësor Zbatimi i monitorimit	Kontraktuesi
	1.4	Rreziqet	Trafik i rënduar dhe aksidente të shkaktuara nga punët ndërtimore duke përfshirë aksidentet e trafikut	Përgatitja e detyrueshme e programit të sigurisë dhe të menaxhimit të shëndetit nga kontraktuesi Vendosja e personave, që kontrollojnë trafikun në vendet e ndërtimit	E njëjta gjë -
	1.5	Topografia dhe Gjeografia	Ndikimet e shkaktuara nga rrëshqitjet e dheut	Përgatitja e detyrueshme e programit të sigurisë dhe të gatishmërisë për emergjencë nga kontraktuesi	E njëjta gjë -
	1.6	Ujërat Nëntokësore	Ndikimi në nivelin e ujit nëntokësor për shkak të punimeve nëntokësore	Studimin bazë i ujërave ekzistuese nëntokësore dhe i puseve përreth Pasqyrimi në projektimin mbi sasinë e ujit në dispozicion të ujërave nëntokësore për të shmangur uljen e kësaj sasive Zbatimi i monitorimit	Ministria e Punëve Publike dhe Transportit
	1.7	Ndotja e Ajrit	Ndikimi i shkaktuar nga prodhimi i pluhurave dhe i ndotësve të ajrit nga punimet ndërtimore	Përgatitja e detyrueshme e një plani për parandalimin e ndotjes së ajrit nga kontraktuesi Spërkatje e detyrueshme me ujë në sheshet e ndërtimit Përgatitja e detyrueshme e planit të alokimit të duhur të mjeteve të ndërtimit Mbikëqyrja e planit të kontraktuesit për alokimin e mjeteve të ndërtimit	Kontraktuesi

Sektori	Plani / Projekti	Parametrat	Ndikimi Negativ i Mundshëm	Masat Lehtësuese të Rekomanduara	Struktura Përgjegjëse
				Zbatimi i monitorimit	
